ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 20 MAJ 2023 | NUMËR 233 | VITI VI I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

Në shënimet gjej diçka për një shkrimtar argjentinas, që ka botuar një shkrim apo thjesht një replikë lidhur me sprovën "Zemërimi i Akilit" Nuk më kujtohet të kem dijeni për këtë shkrimtar, aq më tepër për përmbledhjen "Zemërimi i Akilit", madje as për sprovën me të njëjtin titull, dhe që quhet si e imja. Nuk jam fare i sigurt që e kam shkruar një sprovë të tillë, megjithatë s'mund të them me bindje se s'kam asnjë lidhje me të.

I. Kadare, "Mëngjeset në kafe Rostand"

Ndërkohë që po përgatisnim për botim veprën e plotë në shtatë vëllime të autorit, kjo sprovë e Kadaresë u gjend në një botim spanjisht. Ishte një përmbledhje esesh nga një takim ndërkombëtar poetik (Festival Internacional de Literatura Kosmopolis), në Barcelonë, 2004. Kjo sprovë u botua më vete (2009) në një libër spanjisht, së bashku me një intervistë dhënë shkrimtarit Bashkim Shehu. *(fq. 2-5)*

SHËNIME MBI LIBRAT

Pas leximit të romanit "Liria ime" të Mehmet Krajës

PO TI, DO TË DIJE Ç'TË BËJE ME LIRINË TËNDE?

Nga Anxhela Çikopano-Hoxha *(fq. 3)*

Romani "Ngjizja e papërlyeme" i Agron Tufës"

SKANER RRËQETHËS I SIGURIMIT TË SHTETIT KOMUNIST

Nga Kosta Nake *(fq. 14)*

Persiatje mbi romanin "Asnjëherë të martën", i Bashkim Hoxhës

VDEKJA VJEN PËRTEJ SË MARTËS

Nga Agim Bajrami *(fq. 18)*

PIKËTAKIMET E ROMANIT "HASTA LA VISTA" ME "PORTA E DIELLIT" TË SIMONË TERI

Nga Behar Gjoka *(fq. 12)*

MUZA LIRIKE E POETIT HAMIT ALIAJ

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe *(fq. 7)*

NJË LIBËR PËR SARANDËN NGA JOSIF PAPAGJONI

Nga Ymer Çiraku *(fq. 10)*

NJË SPROVË E KADARESË E PABOTUAR NË SHQIP

Zemërimi i Akilit

RUDOLF MARKU

Fëminija ka një ndikim të madh te shkrimtari i ardhshëm

Intervistë e Angeliki Dimopoulou me poetin Rudolf Marku në shtypin grek, me rastin e botimit të përmbledhjes së tij më të fundit poetike "Rrathët e Brendashkruar" në Greqi (përkthyer në greqisht nga Petros Tserkezis, botim Bakhikon). *(fq. 10)*

FIGURA MITOLOGJIKE E ZANËS, HYJNESHË E BLEGTORISË DHE E VALLEVE

Prof. As. Dr. Anton Papleka *(fq. 6)*

SALVADOR DALÍ:

Pse e sulmojnë *Mona Lizën*

(fq.23)

BIBLIOTEKË

Francesco Petrarca *(fq. 23)*
Këngëtorja

Skënder Buçpapaj *(fq. 20)*
Syshiu je, sybora ime syqiell

Resmi Osmani *(fq. 16)*
Portreti i Motrës Tone

Arben Velo *(fq. 19)*
Takohemi në ëndërr

Edison Çeraj *(fq. 17)*
Frymëdyzim

Botohet në rumanisht vëllimi poetik "Foresteria" i akademikut Kujtim M. Shala *(fq. 13)*

FREDERIK RRESHPJA, POETIKA E VETMISË DHE ANKTHIT EKZISTENCIAL

Nga Sadedin Mezuraj *(fq. 9)*

Ndërkohë që po përgatisnim për botim veprën e plotë në shtatë vëllime të autorit, kjo sprovë e Kadaresë u gjend në një botim spanjisht. Ishte një përmbledhje esesh nga një takim ndërkombëtar (Festa Internacional de la Literatura Kosmopolis), në Barcelonë, 2004.

Kjo sprovë u botua më vete (2009) në një libër spanjisht, së bashku me një intervistë dhënë shkrimtarit Bashkim Shehu.

NJË SPROVË E KADARESË E PABOTUAR NË SHQIP

Zemërimi i Akilit

Në qoftë se do të përsiatnim për atë pjesë të letërsisë botërore që ka për motiv apo për subjekt luftën, thënë ndryshe, që është pjellë nga lufta, do të ndesheshim me një të vërtetë befasuese. Të gjitha luftërat që ka bërë gjer më sot njerëzimi, dhe ato, për turpin e tij, kanë qenë jo pak, por rreth 145.000, pra të gjitha këto luftëra bashkërisht, nuk kanë pjellë dot letërsi sa ç'ka prodhuar vetëm njëra prej tyre: lufta e Trojës. Nuk janë vetëm dy poemat homerike, është pjesa kryesore e teatrit tragjik grek, që nuk mund të kuptohet pa të. Është një pjesë e madhe e poezisë, prozës, dialogëve dhe filozofisë greke dhe latine. Pa përmendur veprat e humbura. Pa përmendur qindra të tjerat që u shkruan më pas e që vazhdojnë të shkruhen edhe sot në dhjetëra gjuhë. Pa përmendur mijëra të tjera ku autorët i kthehen kësaj lufte, si të donin të mos e linin këtë botë, pa thënë diçka për të.

Për nga përmasat e saj, për nga ushtritë që u ndeshën, për nga armët, sulmet e kundërsulmet, për nga tmerret, kufomat dhe masakrat, lufta e Trojës, e krahasuar me lemeritë ushtarake që ka përjetuar njerëzimi më pas, nuk është veçse një lodër fëmijësh. E megjithatë është ajo dhe vetëm ajo, që sundon e vetmuar dhe pa asnjë shemër në letërsinë botërore. Dhe ky sundim, me ç'duket, do të jetë i përjetshëm.

A ka një të fshehtë që ta shpjegojë këtë sfidë, këtë mbretërim apo këtë vetmi, quajeni si të doni?

Natyrisht që ka, madje jo një, por ndoshta disa të fshehta.

Kemi lexuar shumë libra, jashtëzakonisht shumë libra për Homerin dhe poemat homerike, por duhet të pranojmë se ende nuk e kemi zbuluar dot enigmën e këtij monarku pa sy.

I jemi vërtitur vite me radhë, shumë herë na është dukur se e kemi gjetur të çarën për të depërtuar në mjegullën e tij. Kemi hapur e stërhapur fjalorët për të ndriçuar kuptimin e harruar të ndonjë fjale. Kemi lënë fjalorët e kemi rrëmbyer kazmat për të gërmuar truallin ku ka ndodhur ngjarja e Trojës. Kemi rendur si të marrë pas çdo poçeje a pas çdo heshte të thyer, me të cilat personazhet mund të kenë pirë verë a të jenë goditur për vdekje. Kemi bërë shumë mundime të tilla, gjersa e kemi kuptuar se shi në kohën kur kemi kujtuar se i jemi afruar zbërthimit, pikërisht atëherë i jemi larguar më fort se kurrë.

Çfarë është atëherë ky mister?

Përpara se të vazhdoj me fjalën "mister", duhet të them edhe një herë, se nuk është fjala për kuptimin e tekstit homerik, por në radhë të parë për shpjegimin e asaj që thamë në fillim, se përse nga moria e pafund e luftërave të njeriut, kjo luftë, si asnjë tjetër, e ka zënë si në grackë përfytyrimin e njerëzimit. Bashkë me të ajo ka zënë në grackë trazimin e tij, nevojën për emocione, për art. Më 1913, në prag të kasaphanës së Luftës së Parë Botërore, në Azinë e vogël, vazhdonin me vrull gërmimet e polemikat për Trojën. Më 1938, në prag të Luftës së Dytë Botërore, gërmimet më në fund po mbaronin për t'u lënë vendin polemikave. Më 1958, pesë vjet pas vdekjes së Stalinit, dhe gati po aq vjet përpara vrasjes së Kenedit, problemet ishin me një kulm të ri. Sot, pas tmerreve në Ballkan, në Ruanda, në Nju-Jorkun e 11 shtatorit, në Afganistan, e në Irak, njerëzit, pasi dëgjojnë lajmet, kur vjen ora e leximit ose kinemasë, parapëlqejnë, ashtu si dy mijë vjet më parë, të dinë se ç'ndodhte në portën Skée të Trojës, dhe ç'fjalë të hidhura këmbyen Akili me Agamemnonin, në shatorren që aq pak i ngjante selisë së sotme të NATO-s. Prej acarimit të shefave të kësaj të fundit, mund të varen shumë gjëra në jetën e njerëzve, megjithëse, në orët e leximit ose të kinemasë, ata e marrin më seriozisht mërinë e Akilit, ndonëse ajo ka të bëjë me një robinjë, sesa ta zëmë atë të presidentit amerikan për punë të terrorizmit botëror.

Atëherë, në qoftë se ka një mister, ku është ai? Dhe ne që kemi arritur të zbërthejmë gjithfarë të fshehtash planetare, përse ndihemi të paralizuar përballë tij?

Le t'i rendisim me radhë disa nga hamendjet që mund të na afrojnë tek e vërteta e mbuluar.

Lufta e Trojës, ashtu si na e jep Homeri, është më tepër se një luftë. Me këtë mendim e kemi lehtë të bashkohemi të gjithë. Lufta e Trojës, përnjëmend, ka qenë edhe luftë, edhe paraluftë, edhe pasluftë. Edhe tmerr, edhe gosti, edhe diplomaci. Dhe ritual, dhe aventurë, dhe nostalgji. Ndërkaq, ky karakter global i saj nuk është i mjaftueshëm për të shpjeguar të fshehtën. Të tjera luftëra ia kalojnë dukshëm asaj në të gjitha ato që përmendëm.

Vazhdojmë. Lufta e Trojës u poetizua, pra u kthye në art, në kohën kur shkrimi nuk ishte shfaqur ende. Me fjalë të tjera, poetizimi i saj, u krye në një epokë kur tirania pranguese e shkronjave nuk ekzistonte. Ndërkaq, ky oralitet i saj, vështirë se mund të përbëjë një përparësi. Të tjera vepra gojore janë kujtuar nëpër shekuj, pa përfituar kurrsesi nga gojdhanizmi.

Me mungesën e shkrimit lidhet njëfarësoj një tjetër mungesë: ajo e dëshmimit. Lufta e Trojës ka qenë e padëshmuar nga asnjëra prej palëve ndërluftuese. Përfytyrimi i Homerit si korrespondent lufte ka qenë përjashtuar katërçipërisht nga të gjithë. Krusma që vjen nga mungesa e dëshmimit na kujton kronikën e luftërave midis hititëve dhe huritëve, pak përpara grekëve, kur problemi kryesor për ushtritë që niseshin për t'u kacafytur, nuk ishte vetë lufta, por gjetja e ushtrisë armike në shkretëtirë. Siç është dyshuar, disa ushtri, pasi nuk e gjenin dot kundërshtarin, ktheheshin duke shpikur një luftë të pabërë, e natyrisht një fitore të paqenë.

Me mungesën e dëshmimit lidhet kështu dyshimi i njohur tashmë se lufta e Trojës nuk është bërë kurrë. Polemikat për këtë vazhdojnë edhe sot.

Mungesa e dëshmimit ka qenë ndoshta një nga çelësat që shpjegon raportet e çuditshme të kësaj lufte me poezinë. Është, me sa duket, një nga komoditetet që poezia, dhe pas saj gjithë qytetërimi grek e zgjodhi, e shenjoi këtë luftë. Mungesa e dëshmimit, pra, është kusht për të lejuar zgjerimin e mendjes sonë, e vizionit tonë, e turrjes drejt caqeve që ngjajnë të paarritshme.

Thënë shkurt, mosdëshmimi, duke na çliruar nga shumë pakte të vjetra, na jep guximin e na bën të aftë të bëjmë ca pyetje që kurrsesi nuk do të mund t'i bënim në kushte të tjera.

Ja disa nga pyetjet:

Në qoftë se lufta e Trojës nuk dëshmohet, ashtu siç e duan kanunet tona, atëherë ç'ka qenë kjo luftë? Një ndeshje e padukshme, e fshehtë, nga ato që ndodhin në ndërgjegje? Një tjetër gjë, ta zëmë një reformë, një kapërcim, një lamtumirë me diçka, e maskuar, e veshur me trajtat e luftës? Një trillim, një alarm i rremë? Së fundi një ëndërr, një makth, një brengë e fshehtë e Greqisë?



Selección de intervenciones KOSMOPOLIS

Fiesta Internacional
de la Literatura 2004

Digitales

Comparte

Autores/as: **Ramón Sánchez Lizarralde**, **Robert Coover**, **Juan Abreu**, **Drago Jancar**, **Shamshad Khan**, **Joe Haldeman**, **José Eduardo Agualusa**, **Margery Arent Safir**, Dušan Velickovic, **Ozren Kebo**, **Elisabeth D. Inandiak**, **Ismail Kadaré**, **Barbara Nadel**, **Predrag Matvejević**, Carles Sudrià, **Kathleen Ann Goonan**

Relacionado con **Kosmopolis 2004**

Të paaftë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të tilla, ne kemi parapëlqyer, ashtu siç bëjmë shpesh, një alternativë të rëndomtë e burracake: alternativën, ka pasur apo s'ka pasur luftë të Trojës!

Në një alternativë, zakonisht njëra palë ka të drejtë, e tjetra jo. Për alternativën e mësipërme përdora fjalën "burracake", sepse mendoj se të dyja palët janë njëlloj të gabuara.

Ata që mohojnë Trojën lënë të kuptohet se bashkë me mohimin e tyre, një problem mbyllet. Se cili është ky problem që mbyllet, jam i sigurt se nuk janë në gjendje ta thonë. Pala tjetër, e kundërta, ajo që e mbron ekzistencën e Trojës, natyrisht që ngadhënjyeshëm shpall se problemi zgjidhet. Se cili është ky problem që zgjidhet, jam i sigurt se as këtë nuk e dinë.

Të dyja palët harrojnë se trajtimi homerik për këtë luftë, thënë ndryshe, vetë kjo luftë, nuk ka nevojë për ta. Në rropatjet e tyre, të dyja palët, ndonëse e përmendin pa pushim Homerin, janë në të vërtetë kundër tij. Sepse të dyja palët bëjnë një transferim të pafalshëm, kthimin e tregimit të Trojës, nga bota e letërsisë në botën e dëshmisë. Me fjalë të tjera, të dyja palët, harrojnë se kjo ngjarje, kjo luftë, ky trazim, u bë ushqimi shpirtëror i krejt qytetërimit grek, për asnjë arsye tjetër, arsye ushtarake, historike ose politike, po për arsyen e vetme sepse u këndua homerikisht nga një poet ose nga një grup poetësh.

Për Trojën homerike janë të panevojshme si ftohtësia skeptike e mohuesve të Trojës, si gëzimi naiv i pohuesve të saj. Le të ndalemi te këta të dytët, "pozitivët", zemërmirët, ata që duan të na ngushëllojnë me mirësinë e tyre, pa e kuptuar se po na fyejnë. Ata presin falënderimin tonë dhe natyrisht befasohen nga mosmirënjohja jonë. Ata nuk kuptojnë se me rropatjen e tyre nuk arrijnë gjë tjetër veçse të vërtetojnë qenien e një qyteti të vdekur. Ndërkaq, ky qytet, falë poezisë, është i gjallë ndër të gjallët, krahas Nju-Jorkut, Parisit, Tokios, Jerusalemit, Romës.

Ka më shumë se një shekull që kjo aradhë hulumtuesish zemërmirë, duke kujtuar se po na bën një dhuratë, po kryen një sakrilegj. Ky sakrilegj mund të quhet: rrëmbimi, uzurpimi i Homerit.

Pothuajse nëntëdhjetë për qind të librave të shkruar në shekullin e fundit për poemat homerike nuk kanë të bëjnë me krijimin poetik. Përpara dhe pas Schliemann-it e Dörpfeld-it hulumtues të tjerë, si Von Hahn, Meyer, Belgen, Schuchhard, e të tjerë, u vunë në krye të një aradhe të pafundme që ka kryer një pushtim të vërtetë, me fjalë të tjera një dhunim të poezisë antike. Si të mos mjaftonin historianët e arkeologët, një tabor i pambarim vjen pas tyre: filologë, gjeologë, etnologë, meteorologë, sizmologë, grafologë, numizmatologë, asyrbabilonogë, shtrigologë, folkloristë, qeramistë, urbanistë, megalopolistë, moralistë, hititistë, antropologistë, gjeografë, ikonografë, hartografë, topografë, etj., etj.

I gjithë ky tabor, duke tundur mbeturina gurësh, argjilash, armësh të ndryshkura, kanë prerë, kanë shtupuar shtegun që çon drejt Homerit. Versioni homerik i dramës së Trojës, përpara se të jetë përshkrimi i një lufte e i një paslufte, është tjetër gjë. Ai është turbullimi që sjell ploja, ajo që në disa gjuhë quhet "zënie e gjakut". Është historia e një pendimi, më të madhit pendim që ka njohur gjer më sot planeti ynë. Është gracka e parë, dhe për fat të keq, e fundit gjer më sot, ku është zënë ndërgjegjja greke e bashkë me të ndërgjegjja e krejt qytetërimit tonë. Të gjitha luftërat që bashkërisht ka bërë raca njerëzore, nuk kanë pjellë as gjysmën e këtij pendimi.

Nga kjo pikëpamje, lufta e Trojës, versioni homerik, është jo vetëm një luftë *ndryshe*, por ajo është një luftë e papërsëritshme gjer më sot, një luftë që ka lidhje me të ardhmen. Thënë shkurt, ajo është lufta më e re e njerëzimit. Për të treguar, me një shembull të thjeshtë, këtë sipërani të saj, mjafton të kujtojmë se, vetëm disa vite pas Holokaustit, pendimi ishte kaq i pamjaftueshëm saqë urrejtja që e polli atë pësoi një ringjallje dhe ende është e pranishme në kohën tonë.

Nuk kam asnjë prirje të idealizoj antikitetin grek, e aq më pak ta vendos në raporte të favorshme krahasimi me epokën tonë. Asnjë nga ne nuk mund të jetë aq naiv saqë prapa anës së ndritshme të fillimeve të qytetërimit tonë të mos dallojë njollat e tij, e në radhë të parë, njollën kolosale: pranimin njëzëshëm të skllavërisë. Duhet thënë ndërkaq se prej kohësh është vënë re njëfarë simetrie e habitshme e dy epokave të largëta: antikes dhe modernes. Herë-herë duket se për një drejtpeshim misterioz, drejtpeshim që vetëm një vizion nga lart i historisë mund ta pikasë, njëfarë krahasimi krijohet, ndonëse i mjegullt, midis dy epokave. Duke hetuar të mirat dhe të këqijat e tyre, ne e kemi tepër vështirë të gjejmë se cila prej të dyjave del fituese në këtë garë. Ne ndihemi krenarë sot me të drejtat e njeriut, aty ku antikiteti del i njollosur me baltë, por peshorja, aty për aty, tronditet, kur vjen fjala te pendimi pas krimit. Aty të njollosurit jemi ne, dhe fitimtarët ata. Fitimtarë falë poemave homerike, siç e pamë më lart.

Homeri, ati ynë, di gjithçka. Ai s'njeh veç një gjë: urrejtjen.

Urrejtja është ndotja më e madhe e planetit tonë sot. Ajo është, për fat të keq, pjellë e njeriut, dhe nuk mund të luftohet veçse me mjete njerëzore. Në luftën kundër urrejtjes, makina të tilla, si poemat homerike, janë të pazëvendësueshme. Ndaj dhe përçudnimi, prishja e këtyre makinave, do të ishte fatale për njerëzimin. Në rastin e luftës së Trojës, ne do të fitonim topografinë e qytetit të masakruar, por do të humbnim shpirtin e tij. Thënë ndryshe, do ta jepnim atë në këmbim të një mumieje.

Gjeniu i radhës i njerëzimit, sikur ta ndiente rrezikun e sulmit të arkeologëve e gjeografëve, i gjeti poemës së vet "Komedia Hyjnore" një truall të paarritshëm prej tyre: ferrin, purgatorin dhe qiellin.

Nuk jam kurrsesi ithtar i hulumtimit të pastër të poezisë, i frikës nazike prej fakteve, rrethanave, madje kureshtive. Si çdo lexues normal, kur lexoj "Iliadën", kam dëshirë të di gjithfarë shënimesh shkencore që shpjegojnë, plotësojnë, madje kundërshtojnë vizionin poetik.

Është kënaqësi të mësosh, për shembull, se ndeshja e heronjve të hipur mbi qerre luftarake ka qenë një fantazi poetike, dhe se në të vërtetë

DIÇKA QË KA LIDHJE ME SPANJËN

Në shënimet gjej diçka për një shkrimtar argjentinas, që ka botuar një shkrim apo thjesht një replikë lidhur me sprovën "Zemërimi i Akilit", pjesë e përmbledhjes me të njëjtin titull, vënë në qarkullim nga shtëpia botuese "Katz".

Ngaqë shënimi, si zakonisht, është marrë me shpejtësi, veç emrit të shkrimtarit apo studiuesit, Ezequiel Martinez, nuk ka ndonjë të dhënë tjetër për të. Nuk më kujtohet të kem dijeni për këtë shkrimtar, aq më tepër për përmbledhjen "Zemërimi i Akilit", madje as për sprovën me të njëjtin titull, dhe që quhet si e imja.

Nuk jam fare i sigurt që e kam shkruar një sprovë të tillë, megjithatë s'mund të them me bindje se s'kam asnjë lidhje me të. Më kujtohet se, nisur nga një thënie e Konicës, jam marrë, me një kureshti përkthimi, më saktë, me përkthimin e gabuar të fjalës "mëri", me të cilën nis "Iliada", thënë ndryshe, letërsia botërore. (Historia e "zemërimit të Akilit", që, në të vërtetë, nuk ka qenë mëri, por diçka e zgjatur, *mëni*, sipas shqipes, *mani* sipas latinëve, *depresion*, siç do të thuhej sot.)

Martinez nuk e ka për këtë. Me sa marr vesh nga teksti spanjisht, gjuhë që nuk e njoh, ai habitet prej shifrës 14 500 (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind), që unë e paskam përmendur në sprovën time dhe që, sipas meje (më saktë, sipas tij që mendon se sipas meje), jepet si numri i luftimeve që njerëzimi paska bërë gjatë gjithë historisë së vet.

Argjentinasi pyet se ku e ka gjetur I. K. këtë shifër, ose ku qenka bazuar në qoftë se e ka njehsuar vetë, e kështu me radhë.

Që të jem i drejtë, s'mund të them se s'jam pakëz i habitur gjithashtu. Jo aq për atë se si një shkrimtar argjentinas dhjetë mijë kilometra larg shkruan diçka të tillë, por më shumë me veten time. Siç e përmenda më lart, s'mund të them dot se shifra e çuditshme s'ka fare lidhje me mua. Madje, turbull më duket se një ditë e kam vrarë mendjen vërtet për një gjë të tillë. Ajo që s'më kujtohet është se çfarë më paska bindur që atë shifër të mallkuar ta kem shkruar apo thënë (sipas tij etj.) diku.

Të gjitha pyetjet që bën Martinez-i, madje të shtuara, i përsëris tani me vete. A mund të gjendej vërtet numri i luftërave të njerëzimit? Si ishte e mundur që historianët s'ishin marrë me këtë? E aq më tepër, ekspertët e luftërave të të gjitha llojeve, të rrufeshme, të zgjatura, të fshehta, ajrore, batajistët, hartografët, shkrirësit e bronzit, qëndisëset e medaljeve, numizmatët, gjer te gdhendësit e kryqeve të varreve...

Në titull të shkrimit të tij, "Tërheqja pas të dhënave të panevojshme", krahas habitjes, spikaste njëfarë tërheqjeje, *la atraccion, por los datos inutiles*.

Duke iu kthyer tekstit, marr vesh papritur se atë punën e 14 500 luftërave e paskam thënë në një konferencë në Barcelonë.

Aha, them me vete.

(Barcelonë, ç'të panë sytë...)

Më kujtohet se Bashkim Shehu, që ka qenë përkthyesi im në atë konferencë, diçka më ka folur për tekstin e nxjerrë prej saj dhe botimin si një sprovë më vete.

Nuk e gjej dot në telefon, ndërsa e ndiej se dëshira për të marrë vesh ç'ka ndodhur më është zbehur disi. Më shumë se të jenë shpikur, ka gjasë që fjalët të jenë thënë vërtet prej meje.

Jam duke i mbyllur shënimet, kur sytë më shkojnë te fjala "vergüenza". Mendja më thotë se do të thotë "turp", por nuk arrij ta besoj se argjentinasi e ka me mua. Sidoqoftë, nuk e kam vështirë ta vërtetoj se është pikërisht "turp". E lexoj frazën disa herë në spanjisht, pastaj të përkthyer prej Google-it në frëngjisht, për t'ia gjetur pak a shumë kuptimin krejt paragrafit: Gjithë kacafytjet që, gjer më sot, pra 14 500 luftëra gjithsej, dhe kjo për turp të tyre, *y ello para su vergüenza*, nuk kanë pjellë dot aq letërsi sa vetëm njëra, ajo e Trojës.

(Barcelonë, ç'të dëgjuan veshët...)

Pra, ishte fjala për turpin e përbashkët të katërmbëdhjetë mijë e pesëqind luftërave, që unë, Zoti e dinte ku e kisha gjetur, për ta thënë një ditë në një konferencë.

Ndërsa po i mbyllja shënimet, s'më mbetej veç të vija në përfundimin gjysmë filozofik, se, po të ishte puna për gjëra të pasakta, për të mos përdorur fjalën "të papërgjegjshme", këto i thosha zakonisht në Spanjë...

Arsyeja për këtë mund të merrej me mend.

I. Kadare, "Mëngjeset në kafe Rostand"

qerret nuk ishin veçse mjete transporti, si të thuash ca taksi që i çonin luftëtarët e shquar në vijën e parë, ashtu siç çojnë sot aktorët e famshëm te sheshi i xhirimit.

E kështu ndodh me të tjera kryevepra. Në qoftë se nga shembujt historiko-shkencorë ne mësojmë për shembull se kufoma e mbretit Dunkan të vrarë prej Makbethit nuk u gjet në mëngjes në dhomën e gjumit, por dy milje larg, në një kanal ujitës plot llum, ne biem në mendime për të fshehtat e krijimit, dhe mendja na shkon se Shekspiri nuk do ta ndryshonte ndoshta këtë fakt rrëqethës, në qoftë se "Makbethi" i tij nuk do të ishte dramë, por poezi ose roman.

Për t'u kthyer tek "Iliada", ne jemi kureshtarë të dimë perimetrin e Trojës, jo për topografinë, por sepse na jepet një rast për të vrarë mendjen se si mund të ketë qenë në të vërtetë, e si është dhënë nga poezia dyluftimi më i famshëm i krejt letërsisë antike, ai midis Akilit dhe Hektorit.

Ne kemi më shumë se dy mijë e pesëqind vjet që i besojmë leximit të sipërfaqshëm të këtij përshkrimi. Të paaftë për të vënë në dyshim ikjen e Hektorit të tmerruar përpara Akilit, ne kemi vrapuar te veglat matëse për të gjetur perimetrin e Trojës, thua se ky perimetër do të mund të jepte lodhjen, dihatjen apo Zoti e di çfarë, të dy dyluftuesve. Duke tringëllitur veglat matëse, për asnjë çast ne nuk kemi bërë pyetjen: si është e mundur që heroi i parë i trojanëve vrapon si një lepur përpara Akilit? Si është e mundur që pas kësaj ai vazhdon të nderohet si heroi i parë i Trojës? Së fundi, si është e mundur që Homeri, aq i vëmendshëm për bëmat, për mburrjet, kapardisjet dhe turpërimin e heronjve, për asnjë grimë nuk e quan një cen, apo qoftë një incident, sprapsjen e Hektorit?

Të mpirë prej aparatit kolosal që shoqëron tekstin e Homerit, ne e lexojmë dhe e rilexojmë dyluftimin e famshëm, pa e vënë re se ka diçka që nuk shkon në këtë histori. Mirëpo aparati shoqërues, ai aparat i mbushur me vegla, parmenda parake, pllaka argjile, kanale ujitëse, monedha, endje pëlhurash etj., jo vetëm nuk na ndihmon për të pasur një sy poetik mbi tekstin, por dëshpërueshëm varfëron vështrimin, gjersa na i mbyll krejt. Kështu, gjysmë të verbër, ne kalojmë sipër rreshtave ku ndoshta fshihet e vërteta. Midis tekstit tepër të gjatë të dyluftimit janë fjalët: "si në ëndërr ata ndiqeshin", ku, me sa duket, gjendet çelësi i enigmës.

Sipas këtij ndriçimi poetik, tabloja përmbyset: ka vërtet një ndeshje për jetë a vdekje të Akilit me Hektorin, por nuk ka ikje të Hektorit rreth mureve të Trojës. E aq më pak një rendje të dytë, që do të ishte dyfish poshtëruese. E aq më pak një të tretë, që do të ishte vdekje morale e prijësit të trojanëve dhe e vetë Trojës.

Hektori është rrëzuar qysh në goditjen e parë, kjo është e gjitha. Është makth dhe asgjë tjetër, rendja e tij për t'i shpëtuar vdekjes.

Është halucinacion i pastër shfaqja e hijes së vëllait të vet, Deifobit, që i zgjat një heshtë të re. Është pjellë e makthit dialogu i tij me Akilin, përpara dyluftimit , e sidomos pjesa e tij më e pakapshme, lutja për të mos ia gjymtuar fytyrën, lutje e parakohshme, që nuk ndodh kurrë midis dyluftuesve. Është përsëri halucinacion, më i trishtueshmi i gjithë shajnive, kërkimi me sy për herë të dytë i hijes së vëllait, për të lypur prapë një heshtë, dhe mosshfaqja e tjetrit.

Të gjitha këto, që na duket se ndodhin përpara mureve të Trojës, në sytë e mijëra shikuesve, ndodhin në të vërtetë në mendjen e tij, që po errësohet nga vdekja. Në sytë e shikuesve ndodh vetëm zvarrisja mizore e të vrarit.

Dy pyetje janë të pashpjegueshme me këtë rast. E para, si është e mundur që Homeri e ka bërë këtë? Për ta poshtëruar Hektorin, meqë Hektori është trojan, pra i mundur, e Homeri është nga vendi i Akilit, pra nga krahu i fitimtarëve?

Ne të gjithë e dimë se kjo përjashtohet. Homeri është i paanshëm. Më i paanshmi i gjithë poetëve. Paanshmëria e tij s'mund të jetë mashtruese ngaqë ajo nuk dëshmohet në një vepër, ku tërthorazi përshkruhet një konflikt. Ajo dëshmohet në epopenë ku të dyja palët ndeshen drejtpërdrejt, ku sulmojnë, sprapsen, theren, grihen, bishtnojnë, mashtrojnë, klithin, përgjaken e rënkojnë sy më sy e gjoks më gjoks.

Disa studiues janë ngutur kur kanë qëmtuar aty-këtu ndonjë varg ose ndonjë cilësor, për të treguar kinse anshmërinë e poetit në favor të grekëve. Jo vetëm që kjo ngjan e pabesueshme, por në peshoren e përgjithshme, simpatia jonë, e sidomos dhembja jonë anon në mënyrë të qartë nga të mundurit. Dhembja për Trojën, nga poemat e Homerit kaloi në tragjedinë greke e fill pas saj në krejt artin grek.

Kur lufta nisi, një nga qëllimet, një nga ëndrrat e fitores greke ishte grabitja e thesareve të Trojës. Dhe ato u grabitën vërtet, dhe ashtu, gjysmë të llangosura nga gjaku, u ngarkuan në anije për të pasuruar Greqinë.

Greqia u pasurua vërtet. Por jo nga thesaret e grabitura. Siç u tha në fillim të kësaj sprove, ajo u pasurua nga pendimi për Trojën.

Të kthehemi te dyluftimi Akil-Hektor. Pyetja, ç'ka ndodhur befas me Homerin? mbetet gjithmonë shqetësuese. Një harresë në tekst? Një humbje e mëvonshme gjatë tejçimit gojor nga një rapsod në tjetrin? Një zhvendosje e fjalëve "si në ëndërr ata ndiqeshin", nga kreu i episodit, ku duhej të ishte vendi i tyre i natyrshëm, në mes të tij?

Pas pyetjes, ç'ka ndodhur me Homerin? vjen pyetja tjetër, edhe më shqetë-suese: ç'ka ndodhur me ne? Si e kemi pranuar për një kohë kaq të gjatë këtë dyluftim të çuditshëm?



Është vështirë të jepet një përgjigje. Përpara se të fajësonim trullosjen tonë historiko-topografike, ndoshta do të ngushëlloheshim me atë, që me poezinë, e sidomos me Homerin ndodhin përherë gjëra të paparashikueshme.

Një rilexim, më saktë një rikthim në art, do të na ndihmonte ndoshta për të depërtuar nëpër mjegull. Përpara nesh janë dy poema homerike. Nuk e di në qoftë se dikujt i ka shkuar mendja për një poemë të tretë. Një poemë aspak të humbur, por të munguar. Një poemë midisëse, në të cilën duhej të ishin pamje, ngjarje, ëndrra ose zhgjëndrra, të ndodhura midis "Iliadës" dhe "Odisesë".

Në këtë poemë të aspaktë (inekzistente), do të ishin ndoshta ato që ndodhën në paraluftën e sidomos në pasluftën trojane. Rënia dhe lemeria e Ilionit duhej të ishin të plota aty. E pas saj kthimi i trishtueshëm, si në një ëndërr të keqe, i fitimtarëve. Zënia e gjakut, mallkimi që i binte herë njërit, herë tjetrit, e së fundi fillimi i pendimit. Aty do të rigjenim me siguri Helenën e bukur, por jo njëzetecavjeçare, të shkumëzuar nga pasioni, por tridhjetëvjeçare, tashmë grua mëkatare, dashnore e vejushë njëherësh, së fundi, në prag të të dyzetave, ashtu siç jepet tek "Odiseja", kur e kthyer te burri i parë, është shndërruar në moraliste dhe dënon çdo aventurë gruaje!

Kjo poemë e tretë nuk u shërua as nga Homeri, as nga homeridët. Ajo nuk u pengua nga asgjë, ajo thjesht u quajt e panevojshme. U quajt kështu nga një urdhër, që për shumëkënd mund të dukej absurd, por jo për ne, njerëzit e artit. Është urdhri sipëran: poema e tretë nuk kishte vend në këtë botë!

Gjithmonë sipas këtij urdhri, poema e munguar kësisoj, ndonëse e pashfaqur, ndonëse pa vend në botë, në gjithnajën e poezisë ka jetën e saj.

Në këtë poemë të aspaktë ka gjasë që të gjejmë përgjigje për shumë enigma. Atje mund të gjejmë ndoshta diçka edhe për dyluftimin e çuditshëm Akil-Hektor. "Iliada", falë një simetrie, nga ato që e kemi lehtë t'i quajmë hyjnore, hapet me emrin e të parit dhe mbyllet me emrin e të dytit. Rendja e Hektorit, ajo që siç u tha më lart, duhet të ketë ndodhur jo në jetë, por në ndërgjegjen, ose më saktë në ndërdijen e tij, dëshmon se Hektori, ashtu si të gjithë, duke përfshirë këtu edhe heronjtë, e njeh frikën. Ndërkaq, sipas dromcave të mjegullnajës, prej së cilës kanë dalë poemat homerike, ne e dimë që Akili, ky superhero, ky superushtar, gjithashtu ka pasur një çast aspak të denjë në jetën e tij. Kur u dha kushtrimi kundër Trojës në qendrat e rekrutimit, Akili i veshur si grua, ishte fshehur midis vajzave shërbëtore, për t'iu shmangur detyrës!

Shumë gjëra do të gjenim te poema e tretë, ajo që do ta quaja "Mungesiada". E ndër të tjera do të gjenim ndoshta shpjegimin e plotë se përse dy

dyluftuesit e lavdishëm, Akili me Hektorin, janë njëherësh luftëtarë dhe dezertorë lufte, heronj dhe antiheronj.

Duke mbyllur këto shënime, më lejoni të kthehem te vargu i parë, ose më mirë, te fjala e parë e dypoemshit homerik. Kjo është fjala "menin", që në greqishten e vjetër do të thotë "mëri". Mërinë (menin) këndo o muzë! Ta marrim për një shenjë paralajmëruese, për një ogur të keq, që fjala e parë me të cilën nis letërsia europiane është pikërisht kjo?

Një shekull më parë, një eseist shqiptar me emrin Faik Konitza shkroi një sprovë provokuese dhe sfidante, ku në mënyrë të prerë shpallte se ka më shumë se dy mijë vjet që vargu i parë i "Iliadës", "Këndo o muzë mërinë e Akil Pelidit", është përkthyer e vazhdon të përkthehet krejtësisht gabim në pothuajse të gjitha gjuhët e botës.

Sipas tij, me përjashtim të emrit të Akilit, asgjë nuk është e saktë në këtë varg. Gjithmonë sipas tij, gabimi kryesor bëhet te fjala e parë "mëri". Ai shpjegon se kjo fjalë, që zakonisht përkthehet me fjalën "zemërim", në greqishten e vjetër ka një kuptim më të thellë e të ndërlikuar. Fjala "menin" është një hidhërim i thellë, i gjatë, i sëmurë, një gjendje depresioni, siç do të thuhej në kohë të Konitzës, e aq më tepër sot. Për ta kapur më mirë këtë, Konitza na kujton kalimin e kësaj fjale në latinisht, e pas latinëve në gjithë gjuhët europiane, në trajtën aq të përhapur "mania", fjalë që qëndron në rrënjën e dhjetëra të tjerave, një pjesë e të cilave tregojnë gjendje të rënda psikike.

Pra, jo nga "zemërimi", që zakonisht është i shkurtër, por nga "mëria", që s'mund të jetë veçse e gjatë dhe kapitëse, me fjalë të tjera nga një gjendje e rëndë depresioni vuan Akili në fillim të "Iliadës". Është kjo gjendje e rëndë që e ka çuar heroin në vendimin për të braktisur fushën e luftës.

Mund të themi se në njëfarë mënyre, qysh në fjalën e parë të "Iliadës", jepet një pjesë e kodit zbërthyes të kësaj epopeje. Ajo nis me një mëri (menin), ashtu si vetë lufta e Trojës, ka nisur plot mëdyshje, për të mbaruar me një pendim. Në një vizion të përgjithshëm gjithçka është harmonioze në këtë epope. Një luftë ndryshe, një luftë e tipit të ri, që mohon, që tejkalon, që mbyt vetveten. Një fitore që s'është fitore, një ngadhënjim që ndiqet nga një mallkim. Shkurt, një luftë e njëherësh një antiluftë.

Për të vazhduar mendimin e Konitzës, ka gjasë që përkthimi i gabuar i fillimit të "Iliadës", më tepër se rastësi, të jetë një pasqyrim i mendimit tonë të cekët, konformist për luftërat. Zëvendësimi i fjalës "mëri" me "zemërim", u shkon për shtat klisheve tona, për urrejtjen, propagandën luftënxitëse, egërsinë, fitoren, brohoritjen e fitimtarëve etj., etj. Kurse kodi i luftës së Trojës, version i Homerit, kumti i thellë i saj, ende mbetet i huaj e i largët për ne si një fantazmë, shenjat e së cilës, sado që përpiqemi, nuk i marrim dot vesh.

Tiranë, 2004

Pas leximit të romanit "Liria ime" të Mehmet Krajës

PO TI, DO TË DIJE Ç'TË BËJE ME LIRINË TËNDE?

Nga Anxhela Çikopano-Hoxha

Nuk do të kisha shkuar vetiu në një raft librarie të merrja "Liria ime" të Mehmet Krajës, për t'ia shtuar bibliotekës së shtëpisë. Për asnjë arsye specifike, thjesht nuk do të më kishte shkuar mendja të lexoja një autor jo fort të reklamuar lart e poshtë. Fatkeqësisht, kjo na ndodh rëndom të gjithëve. Arbër Ahmetaj më prezantoi me të dhe, siç thotë ajo shprehja: "Njerëzit që të tregojnë muzikë të re, janë të rëndësishëm", them se kjo vlen edhe me ata që të prezantojnë libra. Mehmet Krajën e njihja veç për fytyrë, e kisha parë në televizor e në foto, e kujtoja nga koha kur ishte në Tiranë, po nuk di me ç'padije s›e çoja në mend ta lexoja. "Liria ime" është libri që më prezantoi thellë me të dhe sot them se pa dyshim që dua të lexoj më shumë prej kësaj pene.

Me këndvështrimin e përkthyeses, libri në fillim më trembi disi: një kalvar i vërtetë me fjalitë e gjata të një përroi mendimesh, lidhur nga presje, që hidheshin në letër siç vërtiteshin në kokën e personazhit. Po në atë rrëmujën karakteristike të mendimeve tona, që Kraja e hedh kaq organikisht në letër, janë çelësat për të zbuluar më shumë për personazhet e ngjarjet. "Ne shkruajmë për të kuptuar e sistemuar mendimet që kemi në kokë", thotë De Lilo. E Kraja ka aftësinë ta sistemojë e ta shprishë prapë, tani në mënyrë të ndërgjegjshme e të qëllimtë, duke mbathur çizmet e personazhit e duke ecur nëpër udhën e tij, si nëpër një baltë të ngjitshme, plot me detaje aspak të rastësishme.

Ne "t'Shqipnis" e paragjykojmë shpesh letërsinë e Kosovës, me një instinkt të pandërgjegjshëm se prej gjuhës nuk do ta lexojmë dot. Se do të jenë libra "të rëndë". Por gjuha e Krajës është qelibar, aq sa të vjen zor nga vetja si e paragjykuar dhe çuar nëpër mend se do të ishte një libër i tillë. "Liria ime" është një libër i rëndë plumb, por aspak prej gjuhës.

Libri sjell në çdo kapitull një histori njerëzore prej shqiptarëve, që tani po jetojnë në Kosovën e lirë ose në raport me të. Po a janë të lirë brenda? Gëzimi i lirisë së atdheut a solli shend edhe brenda njeriut? A i shoi ai me dorë gjithë ç'kishte pjellë lufta? A ishte një garanci se tani njerëzit do të ishin të lumtur, si s'kishin qenë kurrë më parë? A ishte mungesa e lirisë shkaku prej nga buronte palumturia e tyre, ligësia e tjetrit, marrëdhëniet e shprishura? A do të vihej tani mrekullisht gjithçka në vendin e vet? Në fund të fundit, kur njeriu, më në fund, e fiton lirinë e tij, a di ç'të bëjë me të? Si endet njeriu në liri, kur në mungesë të saj është dërrmuar së brendshmi?

Do të doja me qejf t'u përgjigjesha të gjitha këtyre pyetjeve, por leximi i këtij libri sjell një përjetim sa personal, aq edhe universal, ndërsa personazhet zhvishen pa mëshirë së brendshmi nën lëkurën tonë. E çka dhemb më shumë e na identifikon me ta janë dobësitë njerëzore, që autori i ka motiv edhe në aktet më të guximshme. Kjo përvojë personale zbulese nuk i duhet privuar askujt, edhe pse unë dua shumë t'u përgjigjem pyetjeve pas leximit të librit.

Me përsiatje që shkojnë larg e më larg e krejt beftë, brutalisht, kthehen me këmbë në tokë, ndonjëherë në forma edhe vulgare, po kaq reale për personazhin: "Jeta dinte me qenë e pamëshirshme për disa njerëz, po Selim Rrasniqi besonte se jetën e vërtetë do ta bënte pas vdekjes, kur shpirti i tij do të ngjitej në qiell e nga ajo lartësi toka do t'i dukej si gogël muti"; me figurshmëri krejt origjinale: "Ai foli me një bariton disi të pjerrët, sikur fjalimi të ishte i shkruar në italik për Radio-Tiranën".

Me një galeri të paimagjinueshme personazhesh e vendndodhjesh, lidhur të gjithë pas kapistallit të lirisë, "Liria ime" është një libër aspak i lehtë për t'u gëlltitur, po që prej mesit e gjer në fund, lexuesi, që përgjon nga vrima e çelësit jetët e të tjerëve, tani e zë veten mat duke përgjuar brendinë e vet.

Një libër që të shkund e të rrit, ndërsa pyet veten: po unë do dija ç'të bëja me lirinë time?

(Marrë nga "Revista Letrare", Bruksel)



FIGURA MITOLOGJIKE E ZANËS, HYJNESHË E BLEGTORISË DHE E VALLEVE

Prof. As. Dr. Anton Papleka

Blegtoria ka qenë një nga veprimtaritë kryesore të malësorëve, me të cilën ata kanë siguruar jetesën. Për këtë arsye, ajo ka zënë një vend të rëndësishëm edhe në kulturën e tyre shpirtërore e materiale. Me jetën baritore lidheshin rite dhe ceremoni, pjesë të letërsisë gojore, melodi dhe vegla muzikore, *kcime* të ndryshme, veshje, elemente të arkitekturës popullore deri edhe disa nene të së drejtës dokjesore, të Kanunit të Maleve, të cilat kishin të bënin me disa të drejta të veçanta të „gjasë e të çobanit", me kullotat verore, me shtegtimin e përkohshëm të kopeve, që njihet me termin shkencor trans-humancë, domethënë me daljen në bjeshkë dhe me djergien nga bjeshka.

Në këtë trashëgimi të lashtë e të pasur kulturore, spikat figura mitologjike e Zanës si hyjneshë e natyrës, e gjelbërimit, e blegtorisë, e këngës dhe e valleve.

Për shkak se në kulturën shqiptare, shkrimi është përdorur relativisht vonë, të dhënat shkrimore që kam mundur të gjej për këtë hyjneshë, nuk janë më të hershme sesa shekulli XVII. Në poezinë *Duel n'Gurit bukuria*, e autorit Lukë Bogdani, botuar më 1685, thuhet:

Tufë-tufë tue mbëledhë
Me zymbyla nji kunorë,
Drandofile bashkë dredhë
Në këshet me gjithë dorë

Lulesh, ani me ia falë
Blegtoreshësë Zanë,
Që ndër valle kur të dalë,
Të na ndrijë dhenë tanë."

Hyjnesha Zanë është një figurë mitologjike mbarëshqiptare, siç e dëshmon edhe emri i saj që njihet në të gjitha viset ku banojnë shqiptarët. Natyrisht ky emër shqiptohet në mënyra të ndryshme, në përputhje me veçoritë fonetike të dialekteve apo të folmeve të veçanta. Në qoftë se në Shqipërinë e Veriut ai shqiptohet *Zana*, në Shqipërinë e Mesme, ky emër shndërrohet në *Zarza*, në Shqipërinë e Jugut, në *Zëra,* kurse tek arbëreshëte Italisë, në *Zara/ Zarëza*.

Sipas dijetarit të shquar Eqrem Cabej, emri Zana lidhet me emrin latin Diana, sepse në kohën e pushtimit romak, hyjnesha ilire u identifikua me hyjneshën Diana që adhurohej nga romakët. Kjo etimologji shkencore vërteton se hyjnesha Zana dhe besimet që lidhen me të janë shumë të lashta.

Në Shqipërinë e Veriut nuk është ruajtur vetëm trajta më e hershme e emrit të hyjneshës, për të cilën po flasim, por edhe trajta ikonografike e saj më e plotë dhe më e gjallë. Në vijim të kësaj teme do të përpiqem të ravijëzoj portretin e saj sipas përfytyrimeve të banorëve të Tropojës.

Të dhënat etnografike që kam mundur të mbledh, dëshmojnë se të parët tanë Zanën e kanë imagjinuar në trajtën e një vajze apo të një nuseje, pra, në trajtë antropomorfe, ashtu siç kanë qenë hyjnitë helene, romake dhe ato të popujve të tjerë indoeuropianë.

Markaj-Krasniqe: " *Kanë kullotë lopët tanë ditën në bjeshkë të Cukalit. Kur janë kthye në pramje, çobani nuk e ka pa lopën e cingares. Ka dalë me e lypë të nesërmen. Tuj ecë, ka pa nji rogë të rrethueme në të tana anët. Kur asht avitë, e ka pa lopën që kish pjellë, bashkë me viç. Aty ngat, ka pa ni femën shumë të bukur, të veshun vizllimë, me bistekë die në fund të kambëve."*

Kërrnajë-Gash: "*I shtina dhentë në qetë. Hini jezeri. Thashë: hajt të shkoj te dhentë. Në derë të kershit, gjeta nji grue të veshun në tesha nusnie. Ulë maje guri. Furkën shti në brez, tuj tjerrë. Kur më ka pa mue, ka lshue furkën e asht çue në kambë. M'u ka turrë me m'rrokë. Kam ikë. Me folë, as ajo, as unë nuk folshim. Më kishin thanë roptë : « Mos fol, në pafsh gja, se asht Zanë e të ban për veti."*

Curraj i Epër-Nikaj: "*Muji punojke me rrogë tu i pari i vendit. Ai ruejke lopët. Ni ditë, i hupin lopët dhe del me i lypë në bjeshkë. Shkon tu ni shpellë ku gjen dy djepa. Në ata djepa ishin dy fëmijë tuj kajtë. Ai u hin ndërmjet me i përkundë. Ma vonë, aty vijnë dy gra që ishin kanë dy Zana..."*

Brisë-Mertur: "*Lahutari Sokol Martini po rrugëtonte natën në rrethinat e Pejës. i kanë dalë përpara dy nuse, të cilat i kanë thanë: "Ke me i ra lahutës e ke me këndue." Mbasi i folën kështu, të Lumet e natës i hupën nga sytë dhe shkuen në punë të vet. Qysh nga ajo kohë, kanga i shkoi mbarë."*

Imazhi i Zanës në trajtën e një nuseje të bukur është ruajtur edhe në këngët rituale, siç është rasti i këngëve të dasmës ku thuhet:

Mori nuse si erdhe pramë,
A je njéri, a je Zanë ?!

***

Zana iliroshqiptare ka qenë një hyjneshë shumëfunksionale.

Së pari, ajo ka qenë mbrojtëse e natyrës së virgjër, e ujërave, e gjelbërimit, e kullotave dhe e kafshëve të egra. Atributi i Zanës si mbrojtëse e burimeve dhe e lumenjve dëshmohet jo vetëm në disa këngë kreshnike ku ajo ndëshkon krushqit që ia turbullojnë gurrat, por edhe nga tregimet e të moshuarve : « *Zanat e shtrojnë sofrën buzë ujit. Të parët thanshin : « Mos pini ujë natën në breg të lumit,se aty Zanat shtrojnë bukën. »*

Atributi i Zanës si mbrojtëse e gjelbërimit ka lidhje të ngushtë me kultin e drurëve të shenjtë, të mrizave, të cilët quheshin të paprekshëm. Në baladën e njohur « *Rriti nana dy jetima* », Zana i ndëshkon me vdekje dy gjahtarët e rinj që kanë shkelur tabunë, paprekshmërinë e pyllit të shenjtë. Kjo baladë mbyllet me vargjet domethënëse :

Nuk jam kanë nuse me ju gzue,
Jam kanë Zana e malit me ju zanue ! »

Në epikën legjendare dhe në besimet popullore, del në pah se Zana ka qenë mbrojtëse e kafshëve të egra. Veç të tjerash, këtë e vërteton edhe kulti i Tri Dhive të Egra, „*me brina dukati* », tek të cilat banonte shpirti i jashtëm i hyjneshës. Prej këtyre dhive të mbinatyrshme buronte fuqia hyjnore e Zanave.

***

Zana iliroshqiptare ka ndërhyrë edhe në jetën e përditshme të njerëzve, duke mallkuar e duke ndëshkuar keqbërësit, duke përkrahur njerëzit e drejtë, të pambrojtur, zemërmirë dhe punëdashës. Një i moshuar nga fshati Mëserr-Nikaj tregon : « *Tri herë në vjet, Zanat dirgjen prej bjeshkëve të nelta e bajnë mbledhje në nji ledinë, maje kodre. Ato mallkojnë ata që bajnë gjynahe, ata që vrasin, që lanë jetima, që lanë veja. Ato urojnë ata që bajnë mirë, që bajnë gurra e pushima.* »

Rolin e Zanës si ndëshkimtare e së keqes e vë në dukje edhe lirika gojore:

N'Kërbicë t'Hasajve këndon Zana:
-Kurr n'at' bjeshkë ma mos raftë hana,
Kurr n'at' bjeshkë hana mos zdrittë,
Kurr për rrugë drumtar mos daltë,
Mos daltë dushk as mos daltë bar!
Ty, moj bjeshkë, qysh s'erdhi keq?!
Për gjynah i le dy pleq,
Le nji nanë tuj kajtë tu votra,
Veshë në t'zeza katër motra !...

***

Funksioni i zanës si hyjneshë e etnomjekësisë vihet re në disa këngë kreshnike ku ajo ia shëron varrrët (plagët) e rënda Mujit, madje në ndonjë rast e ngjall së vdekuri. Po ashtu, ajo ia shëron sytë e verbuar Zukut Bajraktar. Mendoj se ky funksion i Zanës ka lidhje me atributin e saj si hyjneshë e gjelbërimit, meqenëse shumë ilaçe përgatiteshin me substanca bimore, të nxjerra nga rrënjët, lëvoret, gjethet apo lulet e bimëve. Funksioni i lartpërmendur i Zanës ka mbijetuar edhe në besimet popullore: "*Ish kanë njani me nji sy të verbët, tjetri po e lanke. Nji za i tha n'andërr: "Shko në filan vend, në bjeshkë, e thirr me të madhe: "Oj Zana e malit, ndimë!" Ato do të vijnë e do të aviten. Mos u huto. N'ditsh me u sjellë me to, Zanat do të të shëndoshin.* »

***

Nuk ka dyshim se një nga funksionet kryesore të Zanës ka qenë mbrojtja e arteve, e poezisë dhe e koreografisë. Ajo ka pasur atributin për të frymëzuar poetët, këngëtarët, kërcimtarët. Në traditën kulturore të banorëve të Tropojës, për këngëtarin e shquar përdorej shprehja: „*Ai këndon si Zana e malit*."

Rolin frymëzimdhënës të kësaj hyjneshe e nxjerrin në pah vargjet e mëposhtme:

Mori Zanë, e bardha Zanë,
Falma zanin ta baj kangë!

Një nga emërtimet eufemistike kryesore për të shenjuar Zanën ka qenë fjala e përngjitur « *shtojzovalle* », e formuar nga urimi magjikoreligjioz : « *T'i shtoftë Zoti vallet ! » ose « T'i shtoftë Zoti rreshtat në valle !* »

Sipas traditës pagane që ka mbijetur në viset e Tropojës, kur dikush takohej rastësisht me Zanat, për të mos i acaruar ato, për të mos u shituar prej tyre, duhej t'i përshëndeste me formulën namatisëse : « Koftë e bardhë kjo ditë që u ndesha me ju, ngatuzorreshtin e shtojuzovallet ! »

Funksioni i Zanës si mbrojtëse e poezisë dhe e valleve është pasqyruar edhe në letërsinë e shkruar, në ato vepra që kanë pasur si model krijimtarinë gojore, që janë mbrujtur me lëndë mitologjike iliroshqiptare, siç është rasti i poemës epike « *Lahuta e Malsisë* » të Gjergj Fishtës. Në këngën e nëntë të kësaj poeme flitet për Zanën si mbrojtëse e poezisë:

Shkrepi dielli buz's s'Cukalit,
Eja t'kndojmë, oj Zana e Malit,
Eja t'kndojmë n'Lahutë t'Malsisë,
Si ata krent e Shqiptarisë,
Në Prizren na janë bashkue... (f. 101)

Pikturë nga Bashkim Ahmeti

Në këngën e njezetekatërt, Zana paraqitet si valltare dhe si mbrojtëse e koreografisë:

Gurra ishte, ujë po kishte
Sa me blue nji gur mullini.
Aty dilshin Orë e Zana
Për me u la, për me u flladitë
E npër rreze që lshon hana,
dorë për dore për me u ngjitë,
me u ngjitë n'valle e me lodrue...(f. 384)

Në këngën e njëzetekatërt, vihet theksi te roli i Zanës si Muzë që i sugjeron poetit temat e krijimeve të tij, i frymëzon vargjet që do të thurë dhe imazhet poetike :

Hej, moj Zanë, ty t'kjosha true,
Si s'po t'bjen ndërmend për mue,
Punë të hershme me m'kumtue... » (f. 449)

Madje në këngën e mësipërme, duke iu drejtuar Zanës frymëzimdhënëse nga Lissusi i lashtë, poeti e përqas atë me shtojzovallet që banonin në viset e Tropojës :

E npër zalle e npër hamalle,
Shumë po kish do Shtojzovalle,
Shoqet e tua që po kndojshin,
Që po kndojshin e po lodrojshin,
Larg e larg me u ndie jehona,
Bane bé si kah Valbona... (f. 453)

***

Nga të dhënat e parashtruara më lart, del se në panteonin e mitologjisë iliroshqiptare, Zana ka pasur edhe atë funksion që në panteonin e mitologjisë helene ka pasur Terpsikora, muza e valles. Pra, është fare e natyrshme që banorët e Tropojës, të cilët kanë ruajtur gjurmë të lashta të kultit të Zanës, të kësaj hyjneshe që ka qenë një valltare virtuoze, mbrojtëse e artit të kërcimit dhe e kërcimtarëve, kanë trashëguar nga të parët e tyre disa nga *kcimet* më burimore e më të bukura të visarit koreografik shqiptar.

Trashagimia kulturore e banorëve të Tropojës, në të cilën përfshihen ritet, ceremonitë, letërsia gojore, melodité dhe veglat muzikore, kcimet, veshjet, arkitektura popullore dhe e drejta dokjesore, janë një pasuri e lashtë dhe e larmishme, me vlera estetike, humaniste dhe ekologjike, të cilat brenda veçorive krahinore e kombëtare, ngërthejnë mesazhe universale. Këtyre vlerave u shkon për shtat shprehja e shkrimtarit portugez Miguel Torga, i cili ka thënë se universalja është lokalja pa mure.

Në kohën e sotme, kjo trashëgimi kulturore rrezikohet të mënjanohet apo të zhduket për shkak të dy proceseve që karakterizojnë shoqërinë bashkëkohore, siç janë zhvendosjet masive të popullsisë përmes imigrimit të brendshëm dhe emigrimit të jashtëm dhe dukuria e globalizimit që favorizon tjetërsimin, akulturimin, mbizotërimin e kulturave të shteteve të mëdha, me ekonomi të fuqishme dhe me teknologji shumë të zhvilluar në dëm të kulturave të vendeve të vogla.

Për të shmangur zhdukjen e trashëgimisë kulturore, për të cilën po flasim, për t'ia bërë atë të njohur një publiku sa më të gjerë kombëtar e ndërkombëtar, duhet të intensifikohet grumbullimi, ekspozimi dhe studimi i saj përmes simpoziumeve shkencore, koncerteve folklorike, albumeve, filmave dokumentarë, veprimtarive ekoturistike etj...

Për të realizuar një synim të tillë, të vështirë, por fisnik, është e domosdoshme që kjo trashëgimi të merret në mbrojtje jo vetëm nga institucionet lokale e kombëtare, por edhe nga organizma ndërkombëtare, siç është UNESCO-ja, e cila mund të ofrojë asistencë të specializuar dhe fonde financiare ashtu siç ka ndodhur deri tani me shpalljen e disa traditave kulturore pjesë e trashëgimisë kulturore universale të njerëzimit.

Muza lirike e poetit Hamit Aliaj

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

Hamit Aliaj është njëri nga poetët e plejadës së viteve '70 në poezinë shqipe, i cili vinte nga treva veriore e vendit, nga Tropoja si një poet i talentuar dhe me një vizion jashtëzakonisht të hapur në komunikimin poetik të kohës dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Përveçse erdhi si një zë krijues në poezinë shqipe, ai përbën një qasje të veçantë, madje specifike për vendin që krijimtaria e tij zë në poezinë shqipe, por edhe se si ka ardhur në poezinë shqipe.

Duke qenë një poet i lindur në një trevë etno - kulturore dhe etno-sociale të Veriut të Shqipërisë, Tropoja, e njohur për specifikat shpirtërore dhe kulturore, ardhja e Aliajt në poezinë shqipe, solli një pamje, një element e një detaj të veçantë në mozaikun e poezisë shqipe. Të mos harrojmë, siç dhe është shkruar në jetëshkrimin e poetit, Hamit Aliaj është lindur dhe rritur në një mjedis, ku ishin të forta marrëdhëniet e brezave përmes kumteve të së kaluarës në kohën e tij, një mjedis social– kulturor ku prania e një lloj epike ishte e fortë, e që do të vazhdonte dhe më vonë të ishte e pranishme, jo vetëm në jetën kulturore dhe mjediset tradicionale familjare, por edhe në poezinë e Aliajt dhe poetëve të tjerë nga kjo trevë.

Hamit Aliaj e ka shfaqur ndjesinë prej poeti dhe një njeriu të ndjeshëm qysh në fëmijërinë e tij të njomë. Për të thuhet se ishte i ndjeshëm, meditues, i prirë pas gjërave estetike (bisedat e mbrëmjes, kënga epike në dhomën e malësisë dhe të familjes, prirja për të zbuluar të bukurën, fillimet e vargëzimeve që herët e tjerë), ku natyrisht një rol të madh ka nëna e poetit, e cila përveçse ka prekur nga afër shpirtin e tij të brishtë dhe të ndjeshëm prej krijuesi, e ka stimuluar dhe i ka qëndruar afër atij.

Poeti Hamit Aliaj ka lindur në Kasaj të Tropojës, një fshat u mrekullueshëm, me një pamje të gjerë të horizontit, ku poeti ka arritur të shohë me sy Kosovën, e cila ka qenë dhe mbetet shumë e lidhur me të ashtuquajturën Malësia e Gjakovës, ku ka mjaft ngjashmëri, kode dhe histori, folklor të përbashkët dhe histori të përbashkëta në rrjedhën e shekujve, po ashtu edhe të konstitucionit shpirtëror. Kasaj gjendet në një mjedis natyror të mrekullueshëm, një peizazh që ofron ndjesi të shumta, ashtu siç në traditë, ku në rininë e poetit dhe më vonë bashkëjetonin zakone, tradita, gojëdhëna, kumte dhe tregime legjendare të moçme personifikuese, të cilat i shkonin sfondit blegtoral dhe traditës së barinjve që e mbushnin hapësirën me tingujt e fyellit.

Si në të gjithë Tropojën, Nikaj- Merturin dhe Malësinë e Gjakovës dhe në Kasaj kënga legjendare këndohej me një epizëm të qartë tradicional. Kjo lidhje e fortë e banorëve të këtyre anëve, si dhe të poetit Hamit Aliaj ka vazhduar deri vonë, madje edhe në ditët e sotme, ku një pjesë e familjeve të fshatrave të Malësisë së Gjakovës, gati stinën e verës e kalojnë në bjeshkë, deri në Shkëlzen, çka ka bërë që bjeshka të jetë një mit i përtërirë me të gjithë rrëfimet dhe gojëdhënat që ekzistojnë për të. Kjo ka qenë një tablo dhe një pjesë e rëndësishme jetësore që ka mbetur në temat, frymëzimin dhe motivet që përcjell poezia e Hamit Aliajt, pra një lloj kredoje e lexueshme.

Poeti Hamit Aliaj ka një vijimësi krijuese gjatë gjithë kohës, që kur botoi librin e tij të parë në vitin 974. Një poet që ka gjetur motive, ka zbuluar ndjesi të thella emocionale, ka bërë që poezia e tij të prekë çdo kohë të tij, edhe kur ai ishte mësues dhe nuk ishte mësues, edhe kur ishte drejtues, dhe kur banonte në Kasaj apo B. Curri, edhe kur banon në Tiranë. Që nga viti 1974 ai i ka ofruar lexuesit libra me poezi, studime, skenarë filmash, tekste këngësh të mrekullueshme, monografi të ndryshme, të cilat përmbushin dhe veprimtarinë shkrimore dhe librat poetik të botuara.

Kështu, në librat e botuar të Hamit Aliajt mund të përmendim librat me poezi dhe të tjetrës si: "Bjeshkët janë mbiemri im", Tiranë 1974, "Epike" (me bashkautor) 1979, Prishtinë, "E ruaj një fjalë për ty" 1986, Tiranë, "Lotin nuk ta fal" 1990, Tiranë, "Mungon viti Një" 1997, Tiranë, "Njëqind vjet e Martë", 2006, Tiranë, dhe tri libra të tjerë, jo të llojit "poezi", siç janë: "Ali Iber Nezaj monografi", 2012, Tiranë, "E hëna e përtej botës", 2017, "N' Dardani bjen një tupan", /2021. Po ashtu, në jetëshkrimin e Hamit Aliajt rezultojnë dhe dy studime të rëndësishme, që titullohen "Epika legjendare shqiptare" (Arkivi i Fakultetit të Filologjisë) 1979 dhe "Tri shenjtëri të mëdha" (hyrje në librin "Dervish Luzha një yll drite") 2009.

Gjithashtu poeti Hamit Alia ka shënuar firmën e tij në promovimin e dhjetëra poetëve të rinj nga treva e Tropojës, dhe mbi 30 librave artistik e studimor për kulturën e historinë. Rreth gjashtë skenarë filmash dokumentarë, mbi 200 shkrime të natyrës së esesë, portretit letrar dhe reportazheve, pa harruar rreth 20 tekste këngësh të kënduara nga Ansambli Dardania në ngjarjet kulturore lokale, kombëtare dhe Festivalin e Gjirokastrës (1988) dhe atë të Beratit (1995). Mjaft çmime, mirënjohje, tituj, deri tek ai "Mjeshtër i Madh" (2014) përbëjnë një pjesë të vlerësimit që poeti Hamit Aliaj ka marrë deri sot, pa harruar vlerësimin që mendimi kritik i poezisë shqipe ka për të gjatë gjithë kohës.

Siç edhe mund të shihet, në të gjithë rrugëtimin poetik të Hamit Aliajt ka një raport të ruajtur mjaft mirë me poezinë; ai mbetet një poet i figurës më së shumti, i cili nuk ka një prirje për të sofistikuar formën përmes figurës dhe pse figura poetike në poezinë e tij perceptohet më së shumti përmes simbolit të drejtpërdrejtë. Materia poetike e Aliajt është e thjeshtë, ai i beson peshës së fjalës, e cila kalon përmes kodeve të komunikimit, e përftuar në mjedisin ku është rritur, mjedisin e komunikimit social, ku në nënshtresa të thjeshta të tij është marrëdhënia e fortë e njerëzve me trashëgiminë dhe psikologjinë e personifikimit, si një mega - jetësim.

Në poezinë e Hamit Aliajt lëviz një shpirtëzim gjithsorizues, një shpirtëzim, ku shpeshherë natyra dhe njeriu krijojnë një alkimi me zgjatime tradicionale të kultit të krijimit, me burim jetik që nga kënga kreshnike, poezia popullore, të krijuara në kodin e odës së burrave, kultin e lahutës, kultin e epikës dhe psikologjinë e dukshme të dinjitetit.

Në këtë komunikim që sjell poezia e poetit Hamit Aliaj ajo reflekton mjedisin ku ai lindi dhe u rrit, ku shfaqen etyde, lirika, marrëdhënie të mjedisit epik- tradicional, njeriu, natyra, kumtet e Shkëlzenit dhe të Bjeshkëve të Namuna dhe shumë marrëdhënie të tjera, por duke qenë herë metaforik, herë simbolik, herë alegorik dhe herë vizatues i mjediseve të caktuara.

Poezia e titulluar "Harqet e ditës sime", duket se sjell një prerje të rëndësishme për të kuptuar kumtin që dritëson poezia e Aliajt, për shkakun e një dialektike të çuditshme që e përshkon atë. Është një poezi që të kujton unazën si një simbol që i bashkon apo i mban mbledhur gjërat, një unazë që i lidh gjërat. Si simbol përdoret "harku", një formë e interpretuar nga disa fusha të dijes që nga gjeometria, fizika, astronomia etj, që në figurat letrare të kujton parabolën, një mundësi për të lidhur gjërat, të kaluarën me të sotmen, të tashmen me të ardhmen, atë përtej lumit me atë këndej lumit, njerëzit nga njëra kohë në kohën tjetër, por që poeti e përdorë mjeshtërisht në dialektikën e gjërave.

Pra në frymëzimin e tij shpërfaqet një jetësim gati universal, duke na kujtuar "harkun e triumfit" në luftëra, "harkun e trupit" që përkulet mbi djepin e fëmijë si nyjë e lidhjes së kohërave, "harkun e ylberit", "harkun e dorës mbi trupin e të dashurës", "harkun e lahutës", urat mbi lumenj, këmba në ecje, dega me frutën, harkun e syve që pikasin të bukurën, pra një pafundësi harqesh, pasi jeta rrugëton nëpër ligjet dialektike që të kujtojnë harkun. Gjithë kjo mori harqesh, që në të vërtetë janë një parabolë tipike, poeti mëton të shohë ditën e tij, ai nën këtë mori harqesh ndjehet i sendërtuar në të gjitha aspektet që përcjell jo një poet, por një krijesë njerëzore detyrimisht, pasi këtë ligj e përshkon dialektika. Këto raporte hasen shpesh në poezinë e Aliajt, për shkakun e një sintakse poetike të gjymtyrizuar në njërën pjesë tek simbolika apo personifikimi, ndërsa pjesa tjetër tek një llojë përditësie, që në të vërtetë përbën dhe praninë e tij.

Në një hulumtim të hollë, vërehet se në poezinë e Hamit Aliajt shpërfaqet "formimi" fëminor, ndjeshmëria artistike në të cilat siç e tregojnë njohësit e mirë të fëmijërisë së tij dhe krijimtarisë artistike, ka një pleksje sintetike të jetës me shqisën poetike. Atë duhet ditur ta lexosh. Detajet poetike në poezinë e tij, të cilat janë jetike në mënyrën e komunikimit të tij, janë më së shumti forma të hapura, qoftë për konceptin e tij të komunikimit poetik ("...dhe harku mbi djep i një nëne", "dhe harku i lahutave që nga guri lindin burrin" etj), janë tipikisht struktura të hapura të komunikimit (një poet ka dëshirë të madhe që ai të lexohet, të kuptohet dhe të emocionojë me gjetjet e tij lexuesin), por dhe për një arsye tjetër, pasi në profilin poetik, ai ka një raport të qartë, mëvetësisht nuk kërkon t'i ikë burimit të përditshëm të frymëzimit, që atij i vjen nga mjedisi, njerëzit, psikologjia jetësore e përditshmërisë, pasi botëpërjetimet perceptojnë një përditësim ndjesish dhe

(Vijon në faqen 8)

(Vijon nga faqja7)

shqetësimesh në pasqyrën njerëzore ku sheh fytyrën e vet poeti.

Pra, duke qenë njëherësh dhe ndërmjetësi artistik i kohës, mjedisit njerëzor dhe njerëzve, ai nuk kërkon të ikë prej tyre, pasi ushqehet prej këtij mjedisi (kënga legjendare nuk këndohet tjetër kundi si në vendlindjen apo trevën e tij, tregimet popullore, deri në besim askund tjetër nuk reflektojnë si në ndërgjegjen e njerëzve me të cilët ai ka përditësimin e vet, as Shkëlzen, e Bjeshkë të Nemuna nuk gjen tjetër kund, as psikologji njerëzore që besojnë në mitet dhe zanat, në kultin e natyrës dhe të stinës nuk ka tjetër kund), e për këtë mjafton të perceptosh drejt sintaksën poetike të poetit, deri në poezinë më të fundit të botuar prej tij. Kjo lidhet mjaft mirë në alkiminë që poezia e poetit Hamit Aliaj ka me motivet që i vijnë atij nga mjedisi malësor, nga psikologjia jetësore sociale, që përthyhet në përjetime të epërme siç është poezia.

Në këtë bashkëjetesë jetësore dhe artistike, lexuesi duhet të dijë të lexojë dhe raportet e poetit përmes të cilave vjen dhe shfaqet familja, lirizmi, uni poetik, njerëzit që e rrethojnë, një lloj etno - mendim i shndërruar në poezi, në sythe sintetike emocionesh dhe përjetimesh. Poezitë "Tetë minuta" dhe "Dita e tetë e botës" duket se kalojnë përmes një numërimi simbolik, që nuk është numër biblik, por një numër që tregon të paplotën, që gjen madje një plotësim të konceptit dialektik të poetit edhe në poezinë tjetër titulluar "Diçka mangët mbetet gjithmonë". Poezia "Dita e tetë e botës" ngjan të jetë një bisedë e koduar me një pjesëtar të familjes, që mbart një filozofi inteligjence dhe kodi jetik të mjedisi, poeti shkruan: "Drenis Aliaj, ti e din,/ Fisit tonë me drita të murosura/ i ka munguar viti Një, i Nisjes.", pastaj "Kanë thënë:/Shiheni hartën tuaj të prerë;/ I ngjan lëkurës së dhisë, simbol i Mallkimit" dhe "Po, nëse bota u bë në shtatë ditë,/ Përtej Mallkimit, ne jemi Dita e Tetë...", pra është një poezi ku plekset bashkë një simbolikë prej mitit deri përtej rendit biblik, por hyjnor, kapërcimi i mitit është fuqi hyjnore. Është një poezi që pleks magjishëm një histori konvertuese dhe mbijetuese, me një kapërcim kohësh, që e afron me kumtin bazik të saj, një parabolë kontekstuale e qartë dhe mjaft komunikuese.

Janë të rrallë, madje specifik në poezinë shqipe poetët që krijojnë një burim të tillë krijimtarie, të cilën e ditarizojnë, e çojnë në një zonë të epërme përditshmërinë njerëzore, atë që poeti e merr çdo ditë nga mjedisi dhe njerëzit pa asnjë lloj kushti. Në fund të fundit poezia është e bukur, tërheqëse, komunikuese dhe depërtuese brenda gjendjeve njerëzore për shkakun e përdorimit të kaq shumë supozimeve dhe lidhjeve të brendshme, pasi nuk ka mundësi tjetër më të mirë se poezia, ku lidhjet e kohërave të jenë kaq plotësuese për njëra- tjetërn, që në fund të fundit mbështetet mbi një visae të provuar filozofik, se gjërat në këtë ekuilibër forcash apo gjendjesh vijnë nga zgjatimet e të kaluarës dhe udhëtojnë në zgjatimet e tyne në të ardhmen.

Poezia "Syri i Shives" është njëra nga poezitë që krijon një ide, një sprovë të nevojshme për të kuptuar më mirë nga poeti trashëgiminë dhe mitet në poezitë që kërkojnë të komunikojnë në shekuj më vonë të "farkëtimit" të tyre me shekuj më parë. Është një poezi që "sharton" mitet me aktualitetin, metaforën e të cilës poeti e ndërton me shëmbëllimin e njeriut të hershëm, shumë të hershëm të shtresave antropologjike primitive me të sotmen. Ai shkruan:"Thonë se njerëzimi ka qenë me tre sy/ Syrin e Shives pas koke e kishte/ për të parë mbrapa", e më pas rrugëtimi alegorik i poetit vjen tek njeriu i sotëm, ku shfaqet kryengritja vertikale e hapur, por e qartë e poetit: "Të shuhet Syri i Tretë Zotat urdhëruan/ Me tre sy mund të jemi vetëm ne,/ Dhe shpina njerëzore mbeti përjetë në natë,...", një alegori brilante përmes të cilës shtresimet dhe kritika e poetit është kaq bashkëkohore.

Në poezi ka një pleksje të hollë, gati vibrante po të vëresh elementët me të cilët poeti e ndërton metaforën. Një mekanizëm të tillë poeti Hamit Aliaj ndërton dhe disa poezi të tjera, rëndom poezi ku kontrastet janë të dukshme dhe qëndrimet janë të qarta. Në këtë formë është ndërtuar dhe njëra nga poezitë, e cila përpiqet që të mbartë kohën mbi shpinë. Poezia e titulluar "Viti 1990" është ndërtuar përmes kontrasteve të thella, në një sintaksë funksionale, ku gjymtyrët që mbartin kuptimet dhe kumtet përplasen në njëra tjetrën herë në antiteza dhe herë në oksimorone jashtëzakonisht funksionale.

Poeti shkruan: "Mund t'i zbresësh të gjitha vitet deri te viti një/ Dhe gjen përvjetorin e çdo ngjarje të botës/ Në vitin 1990", një strofë analitike, që përmes matëseve kohorë, që në vetvete janë epoka, ngjarje, dogma, ideologji, lindje dhe vdekje, progres e regres etj. ngjan me një kryefjalë, për t'u plotësuar me dhjetëra pjesë të nënrenditura të natyrës komentuare. Një hepim i vazhdueshëm përmbush një

"dyshim" filozofik të poetit për konceptin e lirisë, pasi: "Të gjithë vitet janë më të vogël se ky vit", " qengin e parë që ma falën e lashë në pyll/ T'i ndillte ujqërit. E kish marr malli pyllin tim për ujqër" apo "Në gjysmën time binte borë, në tjetrën dita gjarpri plaste vape...", ku shfaqen dilemat njëherësh me atë që kishte ndodhur dhe ajo që ndodhte. Poezia lidhet fort me ngjarjet e vitit 1990, një vit i cili krijoi shumë raporte brenda shqiptarëve, për shkakun e të kaluarës dhe të ardhmes.

Hamit Aliaj risjell përmes poezisë së tij perceptime të ndjera lirike, poezi të cilat krijojnë një ndjesi njerëzore, një profilitet të veçantë, që mbart një lidhje të fortë me atë që ai e ka kultivuar që herët dhe që lidhet fort me ndjesinë popullore apo të mjedisit ku ka jetuar, pasi ato janë të ngarkuara me një kumt të dukshëm njerëzorë, ku e bukura është kaq afër, gati e prek dhimbjen dhe është gati të prishë ekuilibrat, që gjithsesi nuk prishen kurrë. Poezia "Ti je harrimi" është ndër poezitë lirike, një poezi dashurie me anë të cilët poeti arrin të krijojë një përfytyrim të qartë mbi marrëdhëniet dhe raportet që ai ka me femrën si burim jetësor nga njëra anë, por dhe si një ndjesi e flladitje bukurie dhe ëmbëlsie. Ai shkruan ndër të tjera :"Ti je harrimi/ Se kur të shoh ty, unë harroj të plakem,/ Gjithë bukurive të tjera emrin ua harroj,/ E i thërras me emrin e paemër...". Lehtësisht poeti krijon një raport të epërm, të besueshëm dhe të duket sikur të kujton një këngë të dëgjuar dhe më herët. Këtë ndjesi e shpalosin dhe poezi të tjera si: "Kjo ditë që ikën, nesër vjen", një poezi lirike me një gjerësi gati universale (Ajo lule që ti mban në dorë/ Kushedi nga çfarë e çuditshme vjen/ E krijuar nga shirat a nga hiri/ Të një hapësirë të mistershme si gruaja,/ A nga avujt e Vaterlosë së përgjakshme,/ Ndoshta është gjaku i Zhuljetës a Lorkës,/ A një lot i një dashurie të humbur...). Poezie e dashurisë tek Hamit Aliaj ndërtohet mbi detajet të cilat i lejojnë poetit të vizatojë një ndjesi hyjnore dhe të perimetrojë një metaforë universale.

Natyrisht në poezinë e Aliajt ka një numër të konsiderueshëm dhe të vazhdueshme të poezive që lidhen me Kosovën. Janë poezi të një konteksti të gjerë, një përjetim i vazhdueshëm që nga fëmijëria e tij, pasi atë që e dëgjonte në mbrëmje me familjen, të nesërmen përpiqej ta mishëronte në pamjen e tokës së Kosovës, e cila gjithë ditën i qëndronte para syve. Poezia "Varret e shkjeve" është e hershme, por në simbolikën e vet, ajo mbart një histori armiqësie, atë të luftës me serbët, një histori e trishtueshme e hershme ballkanike. "Një mijë vjet as gjallë, as vdekë,/ një mijë vjet as njerëz, as dhe", më pas "Mbille lule-gjak kullon,/ mbille ahun- nuk dushkon" dhe "Vure veshin:/ kënga jonë tash një mijë vjet,/ s'po i lë të vdesin." Është një histori mbijetese, një histori luftërash, një mijë vjet as gjallë e sa vdekur. Në të vërtetë është metafora e luftërave të vazhdueshme të shqiptarëve me serbët, që Aliaj e sjell mjeshtërisht përmes këtij vargu gati epik. Një tablo të gjërë për Kosovën poeti sjell përmes poemës "Dhe mbi trekëmbësh ecte shekulli": Krejt gjak ishte Kosova,.../Gjak krajlësh e sulltanësh u mbush,/ Në tokën e qiellin e saj betohen/ dhe toka e qielli i saj/ gjëmojnë e qesin prush..." dhe poezi të tjera që duket se e lidhin atë dhe përfytyrimet e tij me legjendat kryesisht si thirrje dhe kujtesë për mbijetesën.

Një qasje interesante në poezinë e Hamit Aliajt janë edhe frymëzimet që mbartin në vetvete kultin e bjeshkës. Është një cikël i rëndësishëm, gati jetik, i domosdoshëm dhe përhershëm. Poezia është një hymn për kultin e bjeshkës, ajo që titullohet "E ruaj një fjalë për ty", e cila kthehet gati në një baladë për shkak të përjetimit të thellë që ai ka sa herë flet për bjeshkën: "Se janë do fjalë që mund t'i thuhen vetëm nënës,/ Vetëm nënës a dashurisë,/ se janë do fjalë që e bëjnë/ fëmijën burrë e burrin fëmijë...", se bjeshka atje është kult, është një vend ku mund të ulen zotat në mbrëmje për të ikur në mëngjes, se atje janë zanat e bukura, drerët dhe lartësitë e botës. Kulti i bjeshkës është shtrirë në shumë përjetime të tjera të poeti në poezinë e çdo vëllimi.

Hamit Aliaj ka një poezi në të cilën preket gjithçka që e rrethon poetin, gjërat që frymojnë dhe krijojnë ndjesinë e pranësisë (të pasurit apo të qenët pranë), pra të duket se i ke pranë. Jetësimet dhe personifikimet e shumta, gati gjithë poezia e tij është një lloj personifikimi, ku ai i trajton gjërat si të shpirtëzuara dhe komunikuese, ndaj e bëjnë atë të jetë i pranishëm. Poezia që u shkruajt para viteve '90 prek në jo pak raste dhe veset që kishte shoqëria e kohës, ashtu siç janë refleksionet për natyrën, një arsenal i vendeve dhe maleve, krojeve dhe majave, fushave dhe qafave, Valbonës dhe fshatrave, stinëve dhe moteve, borës dhe shiut, festave dhe njerëzve, duke e bërë poezinë e Hamit Aliaj kaq jetësore dhe të afërt me kohët dhe kohën.

Një lexim brilant të krijojnë poezitë mbi personazhet legjendarë dhe historikë, siç është poezia: "Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë", "Zeka i zi", "Shkëmbi i Gjo' Balës", "Si krijohen legjendat", "Isa Boletini në Londër", "Sulejman Vokshi", "Ali Ibra", "Mic Sokoli", "Col Delia" etj. Një mundësi përjetimesh të mëdha të poetit me kohën, historinë dhe mjedisin janë poemat që poeti Hamit Aliaj i ka lëvruar me një fuqi artistike të jashtëzakonshme, pasi në përditësinë e tij ka pasur gjithmonë një lidhje të fortë të njeriut me të kaluarën, me legjendën dhe historinë e njerëzve.

Poeti Hamit Aliaj është një poet me një profil të njohur, një profil që ai e ka krijuar përmes zëshmimit artistik dhe estetik të mjedisit ku ka lindur dhe është rritur.

Frederik Rreshpja: Poetika e vetmisë dhe ankthit ekzistencial

Nga Sadedin Mezuraj

1. Rreshpja-rikthim në vetmi

Në peizazhin poetik të fillimviteve 90-të, pas një heshtjeje gati njëzet vjeçare, rishfaqet emri i harruar i Frederik Rreshpjes, me profilin dhe zërin e tij të spikatur qysh në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar.

Në vitin 1994 Rreshpja botoi librin me titullin paradoksal "*Erdhi ora të vdes përsëri*". Në vitin 2004 botoi dy libra të cilat paralajmërojne qysh në tituj lejtmotivin dhe substancën bazë të materies artistike të poezive të tij : "*Vetmi"* dhe "*Në vetmi*".

Në etapën e krijimtarisë në diktaturë, Rreshpja u shpërfaq i dyzuar: me poezinë dominuese të entusiazmit dhe optimizmit social të realizmit socialist, si *maskë dhe arratisje nga vetvetja.*[1] Dhe nga ana tjeter, me pririen drejt poezisë me tone më *personale, një lirikë më intime dhe formaliste*[2], pra me një çvendosje të lehtë të aksit poetik nga modeli i pathosit revolucionar majakovskian, drejt modelit të poezisë si shprehësi e unit poetik dhe si manifestim i *refuzimit estetik* [3] të kanonit soc-realist.

Në kontekstin e ndryshimeve epokale që shoqëruan kalimin nga totalitarizmi në demokraci, mbi gërmadhat e grandnarrativës utopike u përvijuan prirjet e reja letrare të orientuara për kah *kodet e vogla* ku *"individualiteti autorial hapet si rrëfim autobiografik apo letërsi personale, si tekst pa kontekst mimetik, si kërkesë e modernitetit në letrat shqipe.*[4]

Fryma e poezive të Rreshpjes, të shkruara pas vitit 1990, zhvishet tërësisht nga tonet optimiste, zbrazet nga shenjat sociale dhe strukturohet rreth unit autorial, pa ngarkesat e kauzës apo kolektivitetit, ku epiqendra e reflektimit çvendoset nga jashtë, në brendësinë e subjektivitetit lirik. Përmes këtij proçedimi, poezia e Rreshpjes merr tiparet e *puro lirikës*. "*Lirika buron nga poezia, ku shpirtërorja dhe melodikja, si abstraksion gjuhësor, gati e braktis brendinë*."[5]

Sipas Terry Eagleton: "*Lirika duket se mbyllet më tepër hermetikisht ndaj historisë. Ajo përbën një gjini në të cilën "sensibilitetit" ndjehet në formën e tij më të kulluar e më pak të infektuar prej shoqërisë*"[6].

Pas daljes së vendit nga "burg i madh" i totalitarizmit, ku provoi privimin nga liria (burgun), margjinalizimin dhe lënien në heshtje, në kohën e lirisë, Rreshpja e gjen veten të rrethuar nga mospërfillja, zhgënjimi dhe brënda "burgut" të vetmisë. Ata që e njihnin nga afër, në shkrimet e tyre euologjike sjellin dëshmi për natyrën e tij antikonformiste, tipin e "çuditshëm" dhe njëzëri e cilësojnë si "*i vetmuari madh*", "*poeti bohem me vetmi legjendare*", "*njeriu bohem dhe fatkeq*", "*i braktisur në vetminë e tij biblike"* etj.

Nuk ka dyshim se, përtej konceptit mimetik të konsiderimit të artit si pasqyrim fotografik i realitetit, poezia e Rreshpjes mbart gjurmë autobiografike dhe ushqehet prej një përvoje jetësore thellësisht autentike. Jeta e autorit dhe arti tij bëhen shëmbëllime të njera- tjetrës.*"I lirë në mendime, rebel i pandreqshëm dhe i pathyeshëm në çdo kohë, aventurën e artit e plazmoi me aventurën e jetës, pikërisht si shprehje të lirisë ekzistenciale e individuale"*[7]

E vërteta është e bukur, e bukura është e vërtetë- pat thënë John Keats. E vërteta e jetës së Rreshpjes ishte e hidhur dhe duke u sublimuar në art, transfigurohet në bukuri estetike të vërtetë.

Sepse vetëm ai që ka përjetuar burgun politik, refuzimin, zhgënjimet, pabesitë, mospërfilljen dhe izolimin social, mund të shkruaj me aq ndjeshmëri, dhimbje dhe vërtetësi për vetminë, duke prekur thelbin e saj ekzistencial, në një botë të ftohtë dhe indifierente. Por poezia e Rreshpjes, duke u ngjizur si realitet letrar gjuhësor, i largohet kontekstit dhe fakticitetit si dëshmi e thjeshtë biografike dhe përmes imagjinatës dhe fantazisë, rikrijon një univers metafizik të sendërtuar si materie estetiko-artistike.

Megjithatë, në lirikën me motive politike nuk mungojnë referencat për ferrin totalitar dhe kalvarin nëpër të cilin kaloi jeta e tij:

Duke ecur e duke ecur
Kam për të arritur atje prej nga u nisa
Me shenjat e gozhdëve në duar
O Zot, ç'qe ky vrapim i çmendur në atë planet të largët
Mbushur me pretorë komunistë?

Pas vargjeve të unit lirik nuk mund të mos shquajmë analogjinë me silutën e Krishtit pas ringjalljes dhe ngjitjes në Qiell, me shenjat e gozhdëve të kryqëzimit në duar.

Kështu pra rishfaqet Rreshpja në etapën e dytë, në atë të krijimtarisë së tij në liri, i ringjallur por tashmë i rikthyer tek vetja dhe në vetminë e tij, në jetë dhe poezi.

Ne studimet dhe shqyrtesat analitike nënvizohet se poetika e Rreshpjes dallohet nga disa tipare të qënësishme, sikurse janë sensualiteti, sensibiliteti hollë, simbolizmi tingullor, sugjestioni, surealizmi dhe imazhinizmi.

Aktivizimi elementëve të natyrës të krijon përshtypjen se poezia e Rreshpjes është një zgjatim i romantizmit. Në të vërtetë Rreshpja as arratiset në natyrë dhe as ekzaltohet prej saj. Marrëdhënia e tij me natyrën dhe elementët e saj është një raport analogjie me dashurinë, shenjëzon dhe sendërton subjektivitetin lirik dhe meditativ i cili, duket sikur arratiset në natyrë por përherë kthehet brënda vetvetes.[8]

Përmes një figuracioni të spikatur-metaforës, metonimisë, animizimit, personifikimit, paralelizmit, sinekdodës etj, Rreshpja, me elementët e natyrës, jashtëson dhe objektivizon shtjellat shpirtërore të subjektit lirik, plazmon gjëndjet emocionale, ankthin, mungesën dhe pritjen, trishtimin morboz dhe dhimbjen e thekshme të njeriut të rrëzuar në honin e vetmisë ekzistenciale.

Pas lotëve të shiut, kujës së erës dimërore, shkretimit të pyjeve, iliadës së vetëtimave, vajtimit të qyqes mbi pizazhet e trishta, lexuesi zbulon drithërimat e një shpirti të shqetsuar, gjendjet emocionale të vetmisë, ankthin e pritjes dhe brengat për gjërat e humbura.

Si alkimist i fjalës dhe mjeshtër i figuracionit befasues, Rreshpja krijon një poezi vizuale me imazhe mbresëlënëse, pamore dhe dëgjimore, ku pranëvihet konkretia me abstrakten. Fakticiteti mbresave shqisore kombinohet me fanitjet sureale të fantazisë, gjuha krijon imazhe të gjëndjeve shpirtërore, ku shenjuesit zhvishen nga domethënia sociale dhe poezia shpaloset si lojë e gjuhës dhe asocioacioneve imagjnative surealiste.

Nisur nga përparësia e subjektivitetit përballë realitetit, jashtësimi i fluksit të ndjenjave dhe zmadhimi efekteve emocionale përmes theksimit të ngjyrave, poezia e Rreshpjes me atmosferën e saj të zymtë, tonet e errëta, ndjesitë e rrënimit dhe alienimt etj. përafrohet me ekspresionizmin dhe, në mjaft pasazhe, të kujton frymën e poezive të Trakl-it.

E megjithatë, poezia e Rreshpjes pas vitit 1990 fokusohet tërësisht tek *vetja dhe vetmia*, si substanca e subjektivitetit në një situatë ekstreme ekzistenciale.Vetmia, si toposi subjektivitetit, do të bëhet burimi dhe bërthama e topikëve të trishtimit, ankthit, dhimbjes, humbjes, pikëllimit, mallit dhe nostalgjisë.



2. Vetmia si përjetim dhe situatë ekzistenciale

Në poetikën e Rreshpjes, temat dhe motivet rreth vetmisë, fatit, dhimbjes, ankthit dhe vdekjes etj. jo vetëm janë të pranishme si në asnjë rast më parë në poezinë shqipe, por edhe përqasjet rreth këtyre topikëve, si thënie dhe domethënie poetike, krijojnë një rezonancë të thukët me frymën dhe qasjet e filozofisë ekzistencialiste.

Qenia si subjektivitet i mbyllur në vetvete dhe vetmia si situatë ekstremale ekzistenciale, kthehen në objekte të hulumtimit dhe reflektimit metafiziko- meditative të autorit. Thirrja e ardhur prej antikitetit "*Njeri, njih vetveten"* vjen në modernitet si vetënjohje e mikrokozmosit vetijak dhe si shprehësi e ankthit ekzistencial, përballë makrobotës së heshtur dhe indiferente.

Nisur nga ky këndvështrim, poezia e Rreshpjes, për nga motivet dhe qasjet meditative, rezonon me konceptet dhe frymën efilozofisë dhe letërsisë ekzistencialiste.

Ndryshe nga filozofia tradicionale dhe metafizika e saj abstrakte, ekzistencializmi u fokusua tek njeriu, jo thjesht si subjekt mendues racional, por si subjektivitet i gjallë, me shqetsimet e tij ekzistenciale, me pyetjet për kuptimin e jetës, të raporteve të tij me botën, me Zotin, me lirinë, me vdekjen. Në letërsinë ekzistencialiste njeriu përshkruhet si i hedhur në një botë absurde dhe pa kuptim, në gjëndje krize shpirtërore, vetmie, frike, ankthi, malli, mërzie dhe dëshpërimi.

Filozofia ekzistencialiste me postulatin e saj sartian *"ekzistenca i paraprin esencës"*, përuroi një Etikë të re të Lirisë dhe nënvizoi se njeriu, i pakushtëzuar nga ndonjë thelb i paracaktuar, "është i dënuar me liri" dhe liria shpaloset si përgjegjësi e tij. Zh.P.Sartri thotë: *Nuk ka determinizëm. Njeriu është i lirë, njeriu është liria. Nëse ekzistenca i paraprin vërtet thelbit, njeriu është përgjegjës për atë që është"*[9]

Sipas filozofisë ekzistencialiste, njeriu, përtej të qënurit qenie sociale, *ontologjikisht është i vetmuar*: ai lind vetëm, e përshkon i vetëm trajektoren e jetës, i merr vetë vendimet në jetën e tij dhe vdes i vetëm. Sartri pohon se e "vërteta e tmerrshme" dhe çmimi i lirisë, është vetmia dhe se liria dhe përgjegjësia rëndojnë mbi të gjithë njerzit dhe përgjithmonë.

Sigurisht që Rreshpja nuk filozofon rreth këtyre temave të problematizuara nga filozofia ekzistencialiste. Topikët e vetmisë, dhimbjes, fatit, trishtimit dhe vdekjes përftohen përmes qasjeve poetike, si përjetime meditative të subjektit lirik, si situata dhe gjëndje emocionale të cilat ushqehen nga vatra e vetmisë sociale dhe ekzistenciale.

Akti krijimit përjetohet si akt vetmitar. Çdo poet, kur ulet të shkruaj e ka të nevojshme të veçohet nga njerzit e tjerë, të qëndrojë vetëm përkohësisht dhe këto momente i përjeton jo vetëm si "vuajtje", por edhe si kënaqësi e realizimit të qënies së tij poetike. Por jo të gjithë poetët ndjehen *të vetmuar* dhe të rrethuar nga *vetmia* në jetën e tyre reale. Pas momentit të qëndrimit vetëm për të shkruar dhe medituar, poeti rifutet në jetë dhe si qënie sociale, bashkëvepron me shoqërinë përmes lidhjeve të shumëfishta sociale.

---

[1] Primo Shllaku: *Një letërsi tjetër*, Botimet e Bardha, Tiranë 2021
[2] Mujë Buçpapaj: *Poezia e viteve '70-të*, rikthimi tek burimologjia e poezisë më të mirë europiane, Tiranë 2020
[3] Riza Braholli: *Poetika e refuzimit estetik* (Zef Zorba dhe Frederik Rreshpja), Tiranë 2017
[4] Kujtim Shala: *Zbulesa e modernitetit: kodet e vogla të letërsisë shqipe*; Seminari XXXIII për gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqipe, Prishtinë 2014
[5] Behar Gjoka: *Frederik Rreshpja – Intensat shkrimore dhe liriku i rrallë i letrave shqipe*, ExLibris, 31.05.2019
[6] Terry Eagleton : *Hyrjë në teorinë e letërsisë*, Camaj-Pipa; Shkodër, 2005, f 82
[7] Moikom Zeqo https://pashtriku.org/drmoikom-zeqo-frederik-rreshpja-ska-ndermend-te-vdese-seriozisht/
[8] Riza Braholli: *Poetika e refuzimit estetik* (Zef Zorba dhe Frederik Rreshpja), Tiranë 2017
[9] Zhan Pol Sartre: Ekzistencializmi është humanizëm – në: Valter Kaufman - *Ekzistencializmi-nga Dostojevski tek Sartri*, Plejad, Tiranë 2011, f 259

(Vijon në faqen 11)

NJË LIBËR PËR SARANDËN NGA JOSIF PAPAGJONI

Nga Ymer Çiraku

Gjithkush, teksa fijet e jetës, të mpleksura siç janë, kërkojnë të lidhin shpirt e lëndë, mbamendje të hershme e çaste të fundme, copëra historish në harkun e një jete, tundohet t'i hedhë në letër për vete dhe për të tjerët të gjitha këto, ku përzihen përvijime të jetës personale me jetën e shoqërisë, ku ai ka qenë e ka kontribuar. Duket se kjo lakore vjen e shfaqet në një shumësi qasjesh, idesh, mbresash, dukurish, personazhesh edhe në librin "Fluturimi i bletës-Saranda", të studiuesit të njohur J. Papagjoni. Afrmendsh se nuk është një libër mirëfilli kujtimesh dhe mbresash për vendlindjen e tij. Përtej tyre, lexuesi vren abstragime, që rreken të përmasohen tanimë në rrafshe sociale, psikologjike, historike, arkeologjke, urbane, e gjer të një prerjeje filozofie për vet jetën, qënien, njeriun, kohën.

E shfaqur si një kredo, autori shpjegon se librin e tij e ka quajtur "Fluturimi i bletës - SARANDA", sepse donte që metafora e bletës t'i rrinte fletëve përsipër, si krahët e saj "tek fluturonte për të sjellë mes germave *nektarin* e qytetit, shpërndarë andej-këndej rrugëtimit, duke i dhënë kujtesës shpengimin historik përballë shifrave të rrepta, njerëzve, parashtrimeve kronologjike. Historia është e pamëshirshme, ajo rropos tempuj, shuan rrëfenja, mite e jetë njerëzish, histori institucionesh, etnish... Në kohët moderne, kujtesa triumfon ndaj harresës, jo thjesht me rrëfimet dhe pergamenat, me gërmat dhe simbolet, me reliket, statujat, mitet, muzetë, imazhet dhe kompjuterat, por dhe me librat, "bedenat" e të cilit, janë të patejkalueshme. Libri ka mbetur ende "Perandori" i dijes. Fluturim të lirshëm "bleta" ime!...", uron në fund autori, duke e shëtitur librin në shumë "lule" të qytetit të bukur të Sarandës, duke synuar të mbledhë edhe ai polenin dhe nektarin nga njerëzit dhe historia e qytetit. Qyteti për të është një nënë, sa edhe një e dashur e zemrës, histori zhvillimi sa edhe histori njerëzish, një nënkresë ku ai kërkon të shlodhet pak; është nostalgji, imazh, memorie lëvizëse, histori, breza e fise, vëllazëri dhe entitete antropologjike, fetare, krahinore, nacionale, histori institucionesh, bashkësish, njerëz të punës e të dijes - sa edhe histori qytetarësh të thjeshtë, që kanë mbetur shenja të forta identifikuese të Sarandës ndër vite.

Informacioni rreket që të jetë gjithpërfshirës, sa dhe jo rrallë autori sikur "vetëngujohet" në përjetime vetjake, që marrin një kah filozofik, etik, mes përsiatjesh në kuptimin fenomenologjik të lojës së gjeneratave njerëzore, të jetës dhe vdekjes, ndershmërisë dhe amoralitetit, "Sokratit të vuajtur dhe derrit të kënaqur". Konceptimi dhe derdhja e lëndës së gjerë, ka gjetur qasje të larmishme, me ndërthurrje dhe alternime kahesh, ku ndërveprojnë informacioni historik shkencor për procese e fenomene të ndryshme të rritjes e zhvillimit të qytetit nëpër shekuj e vite - me vështrimet sociologjike e ato abstraguese; portretet dhe parashtrimet e natyrës publicistike e të reportazhit me qasjen kritike estetike; kujtimet nga fëmijëria e rinia me narrativat me përthyerje mirëfilli romanore. Në gjithë këtë larushi qasjesh, mua më ka bërë përshtypje edhe dialogu i imagjinuar i autorit me falltarin e vjetër të mitit grek, Tireziun, ku tanimë autori përsiatet rreth kuptimit të qenies dhe ontologjisë së saj, transformimit dhe unicitetit të natyrës njerëzore në rrjedhën e pandalur të kohës, nga fëmijëria drejt plakjes, nga jeta drejt vdekjes, nga kujtesa te harresa. Dua të them se përsiatja, që vihet re gjithandej në nyjat dhe krerët e librit, e bën më grishës leximin, e shkrifëron vëmendjen e lexuesit, e vendos atë në një status bashkëbisedimi intim e në mirëbesim.

Në jo pak raste, autori mban një qëndrim të rreptë kritik e sarkastik, ku zemërimi i tij si një intelektual i mirënjohur, merr formën e sfidës qytetare dhe politike. Këtu mua më ka mbresuar posaçërisht shpalosja e anarkisë urbane e ndërtimeve pas vitit 1990 në Sarandë me dialogun që ai bën me arkitektin dhe artistin e njohur e rebel Maksi Velo për dëmin e pandreqshëm që i është bërë qytetit. Ky qëndrim rishfaqet po njësoj edhe në trajtesa të tilla, si ai i shkatërrimit dhe ndërtimit të vet qytetit e njeriut, turmës së verbër dhe "liderëve" populistë e sharlatanë, vizionit urban dhe rrumpallës, që ka sjellë makutëria e pushtetit dhe e parasë, marrëdhënia e brishtë midis të bukurës dhe të shëmtuarës, nevojës për gjelbërim e pyllëzim dhe betonizimit të mjediseve sociale. Pastaj më tutje trajton problemet me trajtimin e plazheve dhe brigjeve të detit, me infrastrukturën turistike, me hoteleritë, shërbimet, rritjen e cilësisë së tyre etj. "... *Dhe kur nga përleshja me "detin e egërsuar të Galilesë" kam ndjerë se po mbytesha*, - shkruan autori në ballafaqimin me këto dukuri destruktive, - *bash në zgripin e dështimit, humbjes a vdekjes, ja ku më ka vezulluar saora, sa një grimëz sekonde, ajo, Meka ime - vendlindja. Saranda. Eja, më thotë! Mos u mbyt në pikëllim! Hip mbi barkën time! Dhe unë shkoj, tashmë frelëshuar, për t'i shpëtuar dallgës së viteve, trishtimit të moshës sime, për të gjetur limanin, ku shpirti i munduar kërkon dikë që e pret diku, si nëna birin e larguar. Unë nuk mund ta ndalja dallgën vdektare të "detit të Galilesë". Por unë jam një djalë i atij deti, i atij bregu, i atij qyteti, Sarandës sime, ku krahët kam dëshir*ë t'i çlodh *pak. Çlodhi, pra! - më thotë qyteti, deti. Dhe unë i çlodh. A nuk ju thotë po njësoj deti edhe juve bashkëqytetarët e mi?! A nuk keni fluturuar dhe ju po njësoj si bleta, duke i sjellë qytetit nektarin e shumëdëshiruar?! A nuk kemi qenë të gjithë ne "bletët punëtore" të qytetit tonë?..."*

Në këtë libër të veçantë, që lëviz midis një libri studimor dhe romani, nuk kemi përjetime thjesht dhe vetëm personale për qytetin e magjishëm të rivierës shqiptare. Sigurisht, që ato ndihen përmes një ligjërimi gjithë pasion e të përshkuar edhe nga një "pyll" i dendur figurash stilistike farfuritëse, që doemos, i nxit natyrshëm vet bukuria e kësaj hapësire tipike mesdhetare. Ku ndeshen ditët më të shumta të vitit me diell, ku janë pranë e pranë dy nga metropolet mjaft të njohura të antikitetit: Butrinti dhe Foinike (kryeqendër e Kaonisë) që vazhdon të jetë ende fare pak e zbuluar gjer më sot. Me këtë qytet ngjitur buzë detit, që ngrihet mbi hapësira të gjera me mozaikë të mrekullueshëm florealë, me fragmente muresh qiklopike të kalasë brenda tij, me kisha shenjtorësh dhe sinagogë hebraike, qytet fare pranë qendrave të dy qytetërimeve të mëdha: helene dhe romake, janë të lidhura shumë ngjarje dhe fate historike, të së kaluarës dhe asaj të sotme.

Autori i librit, ka bërë një punë të madhe për të hulumtuar e për ta sjellë sa më të gjallë kronikën e këtij qyteti. Por ama, me synimin dhe merakun, për të selitur një kronikë sa më të gjallë, jo skeletike e të thatë, por me mish e me gjak. Kështu, ai qytet ndihet i afërt dhe komunikon me lexuesin. Si një qytet, që sjell historinë e kohërave, por edhe të sotmen. Prandaj ndeshet në libër në morinë e informacionit të gjerë edhe Naim Frashëri, që qëndroi aty disa vite, edhe Neço Muka me këngët e tij të valëve dhe me shfaqjet teatrore që organizonte në vitet '30, përcillet harmonia e njohur mes krahinave dhe etnive etj. Në këtë qytet, për natyrën e bukur dhe konfortin që ofron, sot janë jo të paktë qytetarët europianë e të vendve të tjera, që janë akomoduar këtu.

Libra si ky, sjellin nga ato vlera, që bëjnë pjesë në fondin e çmuar të Kujtesës. Ne si shoqëri nuk është se jemi aq të kujdesur për këtë kujtesë. Por viteve të fundit, kanë nisur të shtohen botime të këtij modeli. Kemi libra kushtuar familjeve të njohura me gjurmë në histori, libra e botime për fshatra, për figura apo institucione të mdryshme atdhetare, kulturore, fetare, që kanë patur e kanë luajtur rol në kohë të ndryshme. Kujtoj psh edhe një botim po të kohëve të fundit, me autor studiuesin e ri Thomas Frashëri, kushtuar historisë së Frashërit të Përmetit. Sigurisht, që vëllezërit Frashëri janë kurora e lavdisë kombëtare, por në librin e vëllimshëm të këtij autori për këtë fshat, shqyrtohet një pafundësi dokumentash e të dhënash të tjera, deri të kohëve bizantine e përtej bizantine.

Edhe në librin e J. Papagjonit, ndeshim një informacion të gjerë rreth Sarandës, nisur qysh nga legjenda e themelimit të qytetit me emrin e dikurshëm të lashtë Onhezëm, pastaj rritjen dhe zhvillimin e tij si një nga 12 portet e njohur në periudhën romake, shkatërrimin disa herë të qytetit të vjetër nga gotët, ostrogotët, saraçenët, osmanët, ringritjen e tij në periudhën e mesjetës me emrin "Ajios Saranda" (40 shenjtorët), më pas e quajtur nga pushtuesit osmanë "Sarandoz", nga monarku Zogu i Parë si "Zogaj", nga Musolini si "Porto Eda", gjersa mban sot emrin e vet SARANDA.

Libri është i vëllimshëm, me 560 faqe, i pajisur me fotografi të shumta, që kanë natyrë illustrative për të shpalosur bukuritë dhe imazhet marramendëse të qytetit, por edhe njerëz që i kanë

dhënë emër, fytyrë e lavdi atij. I natyrës spektrale siç është, lënda është derdhur dhe organizuar në 12 kapituj, të cilat e sjellin qytetin në dy kahet e tij, ato të zhvillimit historik, arkitekturor, urban, ekonomik, social, induastrial e bujqësor, shkolla dhe sportet, dija dhe mjekësia, turizmi dhe bizneset, artet dhe letërsia etj. Një gjë që më ka bërë përshtypje të mirë është përzierja, apo thënë më mirë, qasja humane qytetare në raport me kontributet e sipërshënuara, ku njerëz të shquar të qytetit si dhe ata të thjeshtët, të "padukshmit", vijnë përmes vlerësimeve dhe një vesku dashurie, shpesh edhe mallëngjimi, për të vdekurit që kanë mbetur në memorien e qytetit, qysh nga ato 25 fiset e para të fillimshkullit të XX-të, si themelues të qytetit dalë nga zjarret dhe harresa shekullore, arkitekti dhe urbanisti austriak me pseudonimin "Kaizeri" në vitin 1921, që nuk lejoi prishjen e projektit urban të Sarandës me shkallë e në formë amfiteatri, gjer te dhjetëra figura të njohura në lami të ndryshme e me kontribute të shquara, që janë dhënë në formë portretesh, historish interesante.

Unë kam punuar e jetuar një pjesë kohe të shkurtër në Sarandë dhe kujtoj mjaft figura, që edhe autori i portretizon; kujtoj mësuesit Xhorxhi Vasili, Vasil Partali, Bardhyl Xhama, Mira Birjani, Luan Ahmeti, Apostol Nika, Përparim Musai, Kristina Kallojeri, Vasil Llajo; kujtoj mjekët e palodhur Petro Sheka, Niko Lezo e Niko Shomo, Miço Xhaferri e Afërdita Gusho, Skënder Bajrami e Vasil Gjini; kujtoj sportistët e shquar Aleko Dajko e Idriz Muço, Vangjel Çakuli dhe Esat Mamaca, Suzana Mehmeti dhe Anthulla Ekonomidhi; kujtoj xha Gaqen (Lepuri) e avokat Pogaçen; kujtoj poetët Niko Kacalidha, Agim Mato, Enver Isufi, Sulejman Mato, Stefan Martiko, Irena Gjoni; kujtoj artistët e talentuar Theofil Haxhijani, Thoma Milaj e Thoma Gjoni, Taqo Lepuri, Leka Mosi, Illo Martiko e Jorgo Nano, Adem Daci e Myrteza Leka, Luiza Xhuvani e Karafil Shena etj; fotografët Pirro Mosi e Luan Qendro; kujtoj njerëzit e punës së ndershme si Petrit Idrizi, Panajot Lula, Mitat Hoxha; por kujtoj edhe disa portrete që autori i ka skicuar edhe me humor, edhe me mallëngjim e një farë përdëllimi prej sarandioti, siç që Petro ëndërrimtari, me tri ëndrrat e tij kozmike, më e njohura për të ndërtuar një urë nga Saranda në Korfuz, që sot, si për habinë tonë, ekziston një projekt urban evropian për ta bërë nëser një realitet "ëndrrën e çartur" të Petros. Dhe kështu, kapitull pas kapitulli e portret pas portreti, lexuesi në mbarim të librit "Fluturimi i bletës – Saranda", arrin të kuptojë se sa shumë histori mbetet për t`u zbuluar dhe për t`u interpretuar ende nga jeta e këtij qyteti. Botime të tilla, sipas meje, janë kontribute reale për të fiksuar historinë jo thjesht dhe vetëm të një qyteti dhe njerëzve të tij, por në një plan më të gjerë, historinë e vet popullit shqiptar në shekuj.

Urime Josif Papagjoni për botimin e këtij libri të vëllimshëm për vendlindjen, Sarandën, ku ti jetove e punove me përkushtim për shumë vite. Të ka kërkuar mjaft mund hulumtimi dhe shkrimi i librit, por besoj se patjetër, që ia ka vlejtur shumë për lexuesin e sotëm dhe të nesërm..

Frederik Rreshpja: Poetika e vetmisë dhe ankthit ekzistencial

(Vijon nga faqja 9)

Në këtë kontekst, *vetmia* (*loneliness*) duhet dalluar nga *të qëndruarit vetëm* (*solitude*). Të qëndrurit vetëm, qysh nga Aristoteli, Epiktepti, Petrarka, Montangie etj. është konsideruar si një nevojë e domosdoshme për të ndejtur me veten, për të reflektuar dhe meditуar, pra si një përvojë pozitive dhe e zgjedhur me kënaqsi nga individi.

Wordsworth në një nga poezitë e tij flet për "*lumturinë e vetmisë*" kur qëndronte vetëm, i shtrirë në kanape dhe i zhytur në meditim. Kurse Shopenhauer kalon në ekstrem me predikimet e tij për shoqërinë si të rrezikshme dhe të dëmshme për njerzit e talentuar. Duke i bërë elozhe vetmisë, Shopenhauer e konsideron atë si burim i lumturisë dhe si virtyt i shpirtrave fisnikë.[10]

Ndërkohë, ndryshe nga të qëndruarit vetëm, *vetmia* është një ndjenjë izolimi edhe kur njerzit e tjerë janë fizikisht të pranishëm. Vetmia kësisoj ka ngarkesë negative dhe shoqërohet me ndjesinë e shkëputjes së lidhjeve me njerzit dhe botën rrethuese.

Në kohën tonë të qëndruarit vetëm kosiderohet si një e drejtë bazike për privatësi. Por si rrjedhojë e proçeseve të atomizimit të shoqërisë, tëhuajëzimit, individualizmit dhe dinamikave të përjashtimit social, të qëndruarit vetëm, nga një e drejtë është kthyer në një problem shqetësues social, në një epidemi sociale të shek. 20-21-të. Sipas A.Giddens, izolimi ekzistencial është shpërfaqur në shoqërinë tonë moderne si reagim ndaj mungesës së busullës morale dhe relativizimit të vlerave.[11].

Vetmia në jetë për Rreshpjen nuk ishte zgjedhje e vullnetshme dhe as komoditet në funksion të realizimit të qënie së tij poetike, sikurse vepruan poetët romantikë të cilët qëndrimin në natyrë, në vende të shkreta e të largëta, e konsideronin si komoditet për zbulimin e hyjnores dhe reflektimin e thellë brënda vetes. Vetmia e Rreshpjes si person nuk ishte një momentum i reflektimit poetik apo "*metaforë e qënies poetike*"[12] por një kontinuitet, mënyrë ekzistimi dhe përjetimi ekzistencial i qënies së izoluar nga shoqëria, si rrjedhojë e shtysave të brëndshme shpirtërore, të kombinuara me rrethanat fatkeqe të jetës dhe dinamikat e tëhuajëzimit dhe përjashtimit / margjinalizimit social.

3. Poetika e vetmisë

Situatën e vetmisë, si përjetim dhe gjëndje emocionale (*trishtim, braktisje, dhimbje, pikëllim, pritje, mungesë*) Rreshpja e përcjell me tonalitetin e ngjyrave të cilat kalojnë nga e verdha depresive, në grinë e mërzisë, drejt toneve të errëta (muzgu, nata) si tregues të totalitetit të vetmisë.

Koha kalendarike në poezinë e Rreshpjes reduktohet në një stinë të vetme e cila sinjifikon kohën e brëndshme, mood-in e subjektit lirik, pra vjeshta e shirave, e rënies së gjetheve, ikjes së zogjve, shkretimit të peizazheve –të gjitha shenjëzojnë shtjellat e një shpirti të zhytur në vetmi, trishtim dhe melankoli. Hapësira e zbrazur e nga zërat e jetës, ku gjallojnë ciganët me *''kufomat e daulleve''*dhe arlekinët e trishtuar, peizazhet e shkretuara ku qyqja, shpendi metaforik i vetmisë, këndon (vajton) për ikjen e verës, ikja e shtergëve dhe klithmat e erës-të gjitha dëshmojnë për situatën depresive dhe gjëndjen shpirtërore të subjektit lirik, të kapluar nga ndjesia e humbjes, dhimbjes dhe vetmisë totale. Një vjeshtë e zymtë me të verdhën depresive të gjetheve dhe "*lotët e shirave*", fqinjëron me dimrin e ftohtë, me dëborën dhe peizazhet e hënëzuara, si shenjues të izolimit social dhe vetmisë në gradën zero.

Sipas studimeve psikosociale, vetmia ka një natyrë shumëdimensionale[13]. Vetmia, si situatë ekzistenciale dhe përjetim, përbën vatrën kryesore të magmës poetike të Rreshpjes dhe lejtmotivin kryesor i cili orkestrohet në variacione përmes nëntemave (*trishtimi, mungesa, pikëllimi, pritja, humbja, braktisja etj.*) që bashkëshoqërojnë gjendjet emocionale të subjektit lirik në situatën e krizës ekzistenciale.

Në poetikën e Rreshpjes vetmia shpërfaqet si vetmi sociale, vetmi emocionale dhe të dyja këto, si situata ekzistimi dhe përjetimi, ndërthuren me vatrën e vetmisë ekzistenciale.

a) *Vetmia sociale*

Vetmia sociale i referohet reduktimit ose mungesës së kontakteve/raporteve sociale me të tjerët. Individi ndjehet i izoluar dhe tëhuajzuar nga realiteti rrethues.

Në poetikën e Rreshpjes vetmia nuk shpërfaqet si "*metaforë e qenies poetike*" por përjetohet si një situatë e pakëndshme ekzistenciale, si gjëndje depresive dhe izolimi nga shoqëria. Subjekti lirik ngado që rrotullohet, kudo që shkon, e ndjen të pashqitshme vetminë dhe e përjeton atë si izolim, mungesë, braktisje, pikëllim dhe dhimbje.

Me habi dhe dhimbje Rreshpja pyet:

Nga doli kjo vetmi kështu? Më përpara nuk ishte/Tani ngre mure/ Dhe mbi to pikon loti i hënës. (Vetmi f. 271)

Në këto vargje,trishtimin e përjetuar prej izolimit social, autori e jashtëson përmes teknikës së objektivizimit.Vetmia, përveçse si ndjesi e brëndshme, konceptohet si forcë vepruese jashtë subjektit lirik dhe përmes kësaj teknike objektivizuese, përcillet ideja se vetmia është jo vetëm vetvëçim por edhe tëhuajëzim / alienim, si rrjedhojë e dinamikave dhe faktorëve përjashtues të shoqërisë.

Po me këtë mënyrë proçedimi, Rreshpja objektivizon dhe vizaton edhe trishtimin, duke e perceptuar si forcë shkatërruese të subjektit lirik në vetminë e tij: *Fshehur pas drurëve përgjon/ Vrasësi i vjetër, trishtimi..Eh, mundet që thika e trishtimit / Diku përdhe ka për të më lënë* (Shi hëne, f 145)

Muret e padukshme të ngitura mes subjektit lirik dhe të tjerëve, të sjellin në mëndje poezinë *Muret* të Robert Forst. Por nëse në poezinë e Frost muri ndarës mes njerzve është fizik, në poezinë e Rreshpjes muret e vetmisë janë të padukshëm, janë muret e izolimit social dhe indiferencës. Vetmia, nga simptomë e izolimit social të folësit në poezi, kthehet në epitomë e shoqërisë bashkëkohore, ku vetmia ka marrë përmasat e një epidemie sociale.

Subjekti lirik vetminë e përjeton si ngarkesë negative : *Vetmia mbi supin tim/ Rëndon e bëhet dru* (Oremus, f. 51) Mungesa e komunikimit dhe lidhjeve sociale me njerit e tjerë përcillet me vargjet: *Po mua vetmia më pret te porta/ Ulërin vetmia te porta (Kujtimi yt, f. 157)* Dhe *: Asnjeri s'më pret te porta, vetëm trishtimi /dhe trëndafilat tërë ankth (Shtegtar, f. 208)*

Dhimbjen prej vetmisë, poeti e përcjell përmes vajtimit të qyqes, e cila në poezinë popullore dhe folklor metaforizon vetminë : *Qan qyqja vjeshtën e botës / Po mua dimri i fjalëve më pret te porta. (Qyqja, f 293)* Ndërsa "*dimri i fjalëve*" nënkupton izolimin social dhe mungesën e komunikimit me njerzit e tjerë.

Ndjesinë e të qënit i vetëm dhe i padukshëm nga të tjerët, Rreshpja e përcjell me një nga metaforat më të gjetura në fondin e figurave të tij artistike:

Tani jam biri i ajrit/ si në ditën e parë të botës/Mallkuar në mënyrë biblike. (Djemtë e detit, f 189)

Sintagmna "*Jam biri i ajrit*" nënkupton një njeri të padukshëm nga të tjerët, një njeri të degdisur në margjinat e shoqërisë, njeriun inekzistent, "*të mallkuar në mënyrë biblike*" me vetmi. Vargu "*Si në ditën e parë të botës*" përcjell idenë e një bote të boshatisur nga njerzit. Vetmia e folësit të poezisë merr përmasa kozmike.

Nëse ditën, njeriu i vetmuar sodit nga larg rrjedhën e jetës dhe sado i izoluar, ndjen praninë e të tjerëve, në muzg, e sidomos natën, vetmia e tij bëhet totale dhe merr trajtat e vdekjes sociale. Pikërisht në muzg, kur dita jep shpirt dhe hijet afrohen, subjekti lirik, lutet me ankth dhe trishtim:

O ajër i mbrëmjes mbështillmë/Erdhi ora të vdes përsëri (Prelud, f 193)

Në kompozimet muzikore, preludi është një pjesë hyrëse e cila shërben si lejtmotiv dhe i paraprin pjesëve në vazhdim. Sintagma "*erdhi ora të vdes përsëri*" në kontekstin e poezisë së Rreshpjes funksionon si një notë e trishtë me tone funebre, e cila përsëritet e nuancuar në disa poezi-variacione, ku subjekti lirik përjeton dhimbjen e braktisjes sociale dhe ankthin e vetmisë ekzistenciale.

Nëse nga vargjet heqim bashkëtingëlloret, zanoret krijijnë një kolënë sonore si një rënkim vajtues, ngjashëm me atë të vajtocave në kësolle: oëieëë, eioëe, ëëi

Muzgu është atmosfera që mbështjell poezinë e Rreshpjes. Në muzg, kur vërshojnë hijet dhe bota zhytet në errësirë, poeti ndjen vetminë e tij të madhe. Nata është Hadesi i njeriut të vetmuar. Nata është morgu i tij social. Prandaj subjekti lirik përjeton vdekjen sociale të përsëritur në çdo natë të jetës së tij vetmitare.

Hëna, një nga figurat më të përdorura, falë fantazisë dhe figuracionit mbresëlënës, në poezinë e Rreshpjes fiton një semantikë të shumëfishtë, duke u kthyer në simbol dhe metaforë e gjëndjeve emocionale të përftuara nga vetmia. Mbi të gjitha hëna si trup qiellor i shkretë, kthehet në simbol të heshtjes absolute, të realitetit të shkretuar dhe boshatisur, pa zëra dhe gjurmë jete, personifikim i vetmisë së subjektit lirik dhe zhytjes së tij në natën e izolimit total:

Tani jam biri i hënës (Djemtë e detit, f.189)

Për të përforcuar ndjesinë e izolimit social, vetmia, nga një ndjesi abstrakte, objektivizohet dhe animohet si nje qenie konkrete:

Hënë s'ka /yje s'ka/ Vetmia shëtit me bijtë e saj.(Shtegtar, f. 208)

Në poezi të tjera, Hëna shpërfaqet si personifikim i dhimbjes së subjektit lirik të vetmuar:

Hëna ikën nëpër mjegull/Si varka e dhimbjes sime (Shtegtar, f. 208); Ah hëna që më vrau mua/Aty nën pemën e muzgut (E mira ime prej lotësh, f. 169)

Situata dramatizohet kur edhe vetë hëna bëhet pre e vetmisë*: Hëna e shqyer në dhëmbët e vetmisë/Çirret si egërsirë te porta* (Kujtimi yt, f. 157).

Subjekti lirik shpërfaqet me gjëndje shpirtërore të destabilizuar dhe të lë përshtypjen e një temperamenti lunatik. Nën ankthin e vetmisë, heroi lirik del natën e shëtit i vetmuar "*me qiririn e hënës në duar*". Diogjeni antikitetit shëtiste ditën me një qiri të ndezur në kërkim të së vërtetës. Po ky person lunatik, çfarë kërkon nëpër natë? Ndoshta fantazmat e shpirtrave të ikur. Ndoshta qenie të tjera njerzore. Ndoshta dikë të dashur,të pranishëm me mungesën përthithëse për qenien e tij të zhytur në natën e vetmisë tronditëse. I mbetur në vetmi, folësi i drejtohet asaj, të munguarës, fantazmën e të cilës e shikon ngado:

Tani shkoj i vetëm në hënë.
Askush s'do të na shohë dorëpërdorë
Dhe vetëm për një fjaë të pathënë (Ndjesë, f.199)

(Vijon në numrin e ardhshëm)

[10] Artur Shopenhauer: Këshilla për jetën, Botimet Ideart, Tiranë 2003, f. 126-127
[11] Antony Giddens: Modernity and self identity (1991)Cembrige Polity Press
[12] Riza Braholli: Poetika e refuzimit estetik (Zef Zorba dhe Frederik Rreshpja), Tiranë 2017
[13] Loneliness, its nature end forms: an existential perspective https://link.springer.com/content/pdf/10.1007/BF01278458.pdf

Fragment nga libri në proces
"Rileximi i Petro Markos"

Pikëtakimet e romanit "Hasta la vista" me "Porta e diellit" të Simonë Teri

Nga Behar Gjoka



Romani "Porta e diellit"i shkrimtares franceze, Simonë Teri, është botuar në Paris, në vitin 1939, pra kemi të bëjmë me një tekst letrar, të zhanrit më të gjatë të prozës, që vjen si një përgjigje e flakëpërflakshme ndaj heroizimit, të spanjollëve dhe vullnetarëve të ardhur nga dhjetëra vende në mbështetje të republikës, kundër monarkisë frankiste. Ka shumë mundësi që të jetë edhe ndër të para tekste letrare, që në harkun e dy viteve qëndresë, 1937-1939, që ka përcjellur menjëherë tmerrin dhe lavdinë e kësaj lufte. Romani "Porta e Diellit"[1], vjen në gjuhën shqipe dhe botohet në vitin 1972, dhe hapësira e atij teksti përbëhet nga 483 faqe, një tablo e plotë e kohës së asaj lufte. Në frontespic nuk është shënuar së nga cila gjuhë është përkthyer, sepse me sa duket nuk shënohje gjithnjë. Ndërkaq duke u mbështetur në faktin që autorja Simonë Teri është shkrimtare dhe gazetare franceze, si dhe nga fakti tjetër, që zonja Klio Evangjeli, zakonisht ka përkthyer nga frëngjishtja, arrijmë në përfundimin që libri mbi luftën e Spanjës është përkthyer nga gjuha frënge. Nga ana tjetër, Petro Marko, librin e parë të vetin, pra romanin me titullin domethënës, *Hasta la vista*,[2] që ka si motiv luftën e Spanjës e boton në vitin 1958.

Pra, për herozimin e luftës së Spanjës, kemi të shkruar dy romane, ndonëse në një distancë kohore të përfillshme, prej nëntëmbëdhjetë vitesh, ndërmjet dy teksteve, nga Franca dhe nga Shqipëria. Megjithatë, fakti që *Hasta la vista*,[3] që ka njohur disa botime para viteve '90, në Shqipëri dhe Kosovës, si dhe ka një numër faqesh teksti të shtuar, është ndër tekstet që ka vënë në qendër heroikën e luftës së Spanjës. Pra, gjithsesi nuk mund të përjashtojë të dhënat e kohës së luftës, të shkrimeve, informacioneve, poezive, hije ditari, ose edhe të ndonjë skicë-ideje mbi këtë libër, shumë më herët se sa koha e botimit të tekstit. Jemi, gjithnjë dhe vetëm në një hipotezë që do të kërkonte hulumtime të thelluara, në dorëshkrimet e mëparshme, në ditaret e autorit, për ta zbardhur këtë fakt, ndonëse e vërteta e faktike e botimit të romanit në vitin 1958, me disa gjurmë të modernitetit shkrimor, si frymë dhe tesktologji, si humanitet dhe lënia pezull e fatit të dy të rinjëve, Gorit dhe Anitës. Kjo shenjë është një e vërtetë thelbësore, që konfirmon kohën e botimit, si dëshmi e identifikimit të romanit të parë të autorit, që ka si epiqendër heroikën e njerëzimit përballë flamës së nazifashizmit, ose fundit të tmerrshëm, që u pasua nga tmerri pafund i socializmit dogmatik, në Shqipëri dhe në një pjesë të madhe të botës.

Lufta e Spanjës si lajtmotiv

Shenja e parë, në aspektin sipërfaqësor të prezantuar, në të dy romanet, por edhe në brendësinë tronditëse, të fatit të njeriut dhe njerëzimit, në prag të Luftës së Dytë Botërore. Kjo atmosferë e përndezur e luftës së Spanjës, është shqiptuar në të dy tekstet romanore, pra te "Porta e diellit", roman i Simonë Teri, botuar në Paris, për herë të parë në vitin 1939 dhe, të *Hasta la vista*, i Petro Markos, botuar në vitin 1958 në gjuhën shqipe. Pra, pavarësisht kohës së ndryshme të botimit të këtyre romaneve, thelbi dhe lidhja e tyre, ka të bëjë me temën e luftës, problematikën që paralajmëroi përplasjen e madhe, të fashizmit me njerëzimin, ku madje pas lufta solli në një pjesë të madhe të planetit, vendosjen e socializmit, si tmerri pafund, që tashmë në distancë kohore, prekim shkretëtirën që la pas sistemi monist, që e përndau njerëzimin mbi parimin e luftës së klasave, me pasoja fatale për njeriun dhe vlerat e humanizmit. Nëse titulli i romanit "Porta e diellit", shënon njërin nga sheshet qëndror të Madridit, "kështjellës" së qëndresës së repbulikanëve kundër monarkistëve, duke projektuar kështu epiqendrën e rezistencës së spanjollëve dhe vullnetarëve, në atë ngjarje epokale. Madridi në historinë e betejës, si dhe në faqet e romanit të S. Teri, bart shenjat e simbolit të qëndresës, të një modelit të pazakontë në fatin e qenies njerëazore në kohërat modern. Kurse te P. Marko, në titullin e romanit, është vënë një përshendetje dhe jo rastësisht, *Hasta la vista*, pra mirë u pafshim, si një klithëm njerëzore, për të mos e harruar kurrë rezistencën, për të mos e lënë në vetmi Spanjën dhe spanjollët e paepur, e sidomos me shpresën që dashuria e dy të rinjëve, Anitës dhe Gorit, nuk do të mbetet në udhëkryqin e fatit të mbrapshtë të luftës. Bota romanore, e të dy romaneve, në strukturim, në narrativë dhe në konfigurimin e personazheve/protagonistëve të klimës së luftës, është qarkëzuar në dy vitet e qëndresës legjendare, 1937-1939, duke u bërë kështu lajtmotivi qëndror, si dhe filli i strukturimit dhe niveleve që përçon optimizmin e luftëtarëve, por edhe fatalitetin e një fundi të pashmangshëm dhe të padëshiruar, duke mbetur kështu besnik i kohës reale, që në dy tekstet vjen i përthyer në imagjinatën e autorëve, pavarësisht njëri-tjetërit dhe kohës së ngjinjur në rrjedhje të shëmtuar të fatalitetit të qarkëzimit të njerëzimit, që herë pas herë kridhet në beteja shkatërrimtar të vetvetes.

Pikëpërkimet rastësore

Shenjëzimet e shkrimit letrar, janë të lidhura me jetën e secilit prej autorëve, që në romanet e shkruara prej tyre, në kohë të ndryshme, si dhe pavarësisht njëri-tjetrit, kanë vënë në qendër luftën e Spanjës, epopen e njerëzimit, të pjesës së parë të shekullit të XX. Në aspektet jetësore, të jetës së dy autorëve të këtyre romaneve, jemi në dy pikëpërkime, që nga rastësore, janë të shumta, që madje shndërrohen në një realitet faktik dhe historik:

E para, të dy autorët, pra si shkrimtarja franceze, Simonë Teri, ashtu edhe shkrimtari shqiptar, Petro Marko, kanë qenë pjesëmarrës në luftën e Spanjës, madje të mbërthyer në frontin e kësaj lufte, të ardhur aty si vullnetarë, në mbështetje të republikanëve, që ishte një lëvizje e majtë. Po ashtu, të dy autorët qëndrojnë në territorin e Spanjës në dy vitet e luftës së kohës, si pjesë e qëndresës legjendare, në mes republikanëve dhe monarkistëve, duke provuar vuajtje dhe sakrifica të panumërta, duke mbledhur nga hiri i kësaj lufte, botën e frymëzimit, e mbi të gjitha duke tejkaluar kronikën, por duke zbuluar para lexuesit, amën shpirtërore, madje vetë dashurinë, të përthyer në shumë pamje. Përjetimi, në bërthamën e rezistencës mbinjerëzore, pra aty në vatrën e frontit, ku zhvilloheshin luftimet e ashpra, është shtysa parake dhe tepër e rëndësishme, e realizimit të dy teksteve romanore, ku madje pikëpërkimet e ndërmjetshme janë jo më pak të rrokshme.

E dyta, që është edhe më domethënëse, por edhe më e faktuar, për kohën që ata kanë qëndruar në front, roli i tyre si gazetar me fushën e betejës, ka qenë tepër i pranishëm, ku Simonë Teri, ishte vullnetare dhe korrespodente e një reviste, e dërguar në front, për të përcjellur lajmet nga fushat e betejës. Pra, në rastin e autores franceze, realisht jemi në një dëshmi faktike, të misionit të saj, madje në vijën e frontit, si korrespondente e dërguar atje, me dijen dhe qëllimet e shpallura. Nga ana tjetër, Petro Marko, shkrimtari shqiptar, ishte bërë pjesë e vullnetarëve që do të shkonin në luftën e Spanjës, mbasi ishte bërë i njohur si gazetar rebel, si botues i revistës ABC, si dhe kishte botuar në gazetat dhe revistat e kohës, me dhjetra poezi dhe tregime të shkurtra, duke u bërë një figurë e njohur në Shqipëri. Po ashtu, shkrimtarin tonë, gjendur në vijën e frontit, e caktuan me detyra të rëndësishme, që të botonte gazetën e "Garibaldinëve" të ardhur nga gadishulli ilirik, por njëherit edhe të shkruante artikuj të ndryshëm për epopenë e luftës së Spanjës. Pra, fatet e dy autorëve, të dy shkrimtarëve nga vende të ndryshme, që i kishin kushtuar luftës së Spanjës romane, Simonë Teri, "Porta e dielli", kurse Petro Marko, me *Hasta la vista*, kanë disa pika të përbashkëta, në praninë e tyre në këtë luftë, por edhe si gazetar që përcollën rrjedhat e saj në shtypin e kohës.

Pikëpërkime te romanet

Me interes për letërsinë, pra në atdheun shpirtëror të qenies, është vendosja pranë e pranë, por edhe në një situim përballëvënie e të dy romaneve, përkatësissht të tekstit "Porta e diellit" të Simonë Teri, botuar në vitin 1939 dhe *Hasta la vista* i Petro Markos, të botuar në vitin 1958. Përqasja e këtyre teksteve, si atmosferë tërësore, në morinë e elementëve përbërës, të sendërtimit të botës romanore, të strukturimit dhe të mozaikut rrëfimor, gjithnjë si optikë krahasimore, do të kundrohet nga dy pika referimi:

A – Nga vështrimi i të dy teksteve, pra i romanit "Porta

1 Simonë Teri, *Porta e diellit*, Tiranë, Naim Frashëri, 1972, përkthyer nga Klio Evangjeli nga frëngjishtja.
2 Petro Marko, *Hasta la vista*, Naim Frashëri, 1958.
3 Katerina Goshi, Katologimi në botim, Tiranë, BK, 2006, ku jepet botimi i parë i romanit Hasta la vista, 1958, me 470 faqe, faqe 63, botimi i dytë 1966, me 556 faqe, faqe 64, botimi i tretë 1972, faqe 550, faqe 66, botim në Prishtinë, Rilindja, 1981, me 575 faqe. Nga botimi i parë në vtin 1958, me 470 faqe në botimet e tjera ka një numër faqe me të madhe, mbi 100 faqe tekst.

e diellit" dhe *Hasta la vista,* në vendosjen pranë e pranë, gjithnjë në kërkim të rezonimit të tyre, si piketa realiste dhe sendërgjim i shenjës estetike, që përçohet në secilën hapësirë tekstologjike. Kjo situatë e nevojshme, ndërkaq është e ndërvarur nga leximi dhe rileximi i pranshëm i të dy romaneve. Rrethana e solli, që fill pas rileximit të romanit *Hasta la vista* të P. Markos, lexova për herë të parë romanin "Porta e diellit", të shkrimtares franceze, Simonë Teri. Për të hedhur një vështrim, sado panoramik, përqasës dhe të ndërmjetshëm të të dy teksteve, rol parësor pati edhe fakti që botimi i autores frenceze, pra i romanit "Porta e diellit", në gjuhën shqipe realizohet në vitin 1972, ishte shoqëruar me një parthënie të zgjeruar me të dhëna të detajuara për autoren, si dhe më një analizë vlerave të shumëfishta që përçon ky roman, nga Petro Marko. Parathënia e shkrimtarit, është rast dhe tregues i aftësisë së shqyrtimit të tekstit letrar, nga ana e autorit tonë, gjë që ma shtoj kërshërinë ca më tepër, për t'i vështruar, fillimisht në përqasje të pranëvënë të dy romanet. Nga një vështrim, formal dhe përmbajtësor, në hapësirën e të dy teksteve, bie në sy:

- Të dy tekstet, romani "Porta e diellit", i S. Teri, dhe *Hasta la vista,* i P. Markos, kanë vënë në qendër temën e luftës së Spanjës, si një pasqyrë e tablosë realiste të kësaj ndodhie. Pa drojë, mund të theksohet se objekt i sendërgjimit të botës romanore, të realitetit letrar, është koha e zhvillimit të luftës së Spanjës, në harkun kohor 1937-1939, pra vetë betejat e ashpra të asaj lufte. Përputhshmëria rastësore, e objektit/temës qëndrore, që kanë si epiqendër të dy autorët, të shtjelluara në tekstin e secilit prej romaneve, lidhet me faktin që të dy janë pjesëmarrës aktiv në atë luftë dhe kanë pasqyruar aspekte të saj, edhe si publicist. Qenia e tyre, si dëshmitarë të një njëkohshëm, por edhe gazetar të asaj situate të pazakontë, pra në një kuptim më të ngushtë, kronikanë të asaj situate të përleshjeve, aq më tepër që ata janë protagonistë të ngjarjeve, i bie që përputhja, gjithnjë rastësore, të jetë sa logjike, po kaq edhe organike.

- Në të dy tekstet vihet re se është trajtuar tema e luftës, e cila befasisht vjen e shqiptuar duke e gërshetuar me linjën e dashurisë. Logjika e pranvënies së luftës me dashurinë, që në ato kontekste, të cilat duken përjashtuese dhe të pamundshme, në fakt është gjetje, është mesazh human se jeta vazhdon në të gjitha gjendjet, vështirësitë ku bie qenia njerëzore, në gropat dhe honet shkatërrimtare, siç janë luftërat, dashuria është ilaçi shpëtimtar i qenies dhe vijimësisë ekzistenciale të saj. Zhozeta nga njëra anë e medaljes, personazhi kryesor i romanit "Porta e diellit", pasi ka humbur dashurinë me Andre Larbonë, për shkak të ndryshimit të rrethanave shoqërore, që u përkasin si personazhe, për ta fshirë nga jeta, vendos të hidhet në frontin e luftës në Spanjë. Në hapat e parë, në udhëtimin drejt të panjohurës, sërish trokasin rektimat e dashurisë,



të cilat i sjellin në shteg aviatorin, Zhan Gireku, që shumë shpejt ia mori lufta. Në udhën e saj, si njeri dhe gazetare, në zjarrin e luftës shfaqet Pakoja, guximtar dhe orator, të cilit lufta ia ndërpreu jetën. Jeta, megjithatë nuk ka kuptim në vetmi, prandaj ndjenja për Ramonin, një luftëtar dhe komisar, e risolli në ekulibër jetën e protagonistes, teksa ikën për ca kohë në Francë, e rikthehet me e vendosur se më parë. Në faqet e romanit *Hasta la vista,* fekset linja e dashurisë së Gorit, epiqendrës së romanit, me spanjollen e bukur Anita, një dashuri që zbut vështirësitë e luftës, por mbarimi i saj, e la pezull dashurinë e dy të rinjëve, si një gjasë e pamundshme, si makth lumturie, që ka ngrirë në përshëndetjen e një dëshire humane, *Hasta la vista*, pra mirë u pafshim.

- Në sendërtimin e romaneve realiste, ashtu siç ngjet në fushën e betejës, duke rënë në disa raste, në një natyralizëm të pastër, si në romanin "Porta e diellit", të S. Teri, kurse të *Hasta la vista*, të P. Markos, mishërohet poetika realiste, në thelbin e zbulesës së realitetit konkret, ndonëse të përthyer në imagjinatën autoriale. Përballë një ngjarje reale, siç ishte lufta e Spanjës, si dhe duke qenë pjesëmarrës në frontin e betejës, që të dy autorët, e romaneve që kanë vënë në qendër luftën e Spanjës, kanë peshën e vetë parësore, kontekstet e betejës dhe të qenies së autorëve si pjesëmarrës, tanimë për të projektuar dhe realizuar një tablo realiste, të asaj ngjarje reale, që pati si protagonistë, vetë Simonë Teri dhe Petro Marko, si dy shkritmarët që kanë shkruar romane për atë periudhë, kur fashizmi dhe komunizmi, kishin nisur kacafytjen, për jeta a vdekje, duke shkaktuar ploja të paimagjunueshme në jetët njerëzore.

- Fataliteti, si një ndjesi që ndjek fatin e personazheve, e cila lidhet me rrethanat e luftës, me gjasë më fatin e mbrapshtë të luftës, ku jeta e njeriut është në rrezik në çdo hap. Prej kësaj atmosphere të përndezur, të një lufte tragjike, në mes republikanëve dhe monarkistëve, edhe ndjenja e dashurisë gjallon veçse në zgrip ekzistencial. Fati i hidhur i Zhozetës, që u nda nga i dashuri i parë, si dhe humbi dy të dashuritë e saj luftëtar të epopesë së Spanjës, si dhe lidhja me Ramonin që mbeti pezull, teksa lufta mbaroi, linja e dashurisë së tyre, në faqet e romanit, mbeti e papërfunduar. Fati i lidhjes së Gorit me Anitën, i dy protagonistëve të romanit *Hasta la vista,* të Petro Markos, është i ndërvarur sërish nga lufta, e fati i hidhur i luftës së humbur, solli largimin e dy persoanzheve, duke lënë të vjerrun dashurinë, vetëm në një shprehje, Mirë u pafshim (Hasta la vista), që është shumë e bukur, por edhe shumë e zakonshme, për ta mbajtur të ndezur zjarrin e dashurisë.

B – Një pikë reference, për të hetuar ndryshimet, mbase duhet thënë nuancat dalluese, në mes dy teksteve. Fushëpamja e këtillë, është jo më pak e vështirë se rrethana e parë, e kundrimit të pranshëm të dy romaneve. Në vështrimin përballëvënës, të të dy teksteve të romaneve, "Porta e diellit", të S. Teri dhe *Hasta la vista* të P. Markos, në mes të tjerash vihet re:

- Se në faqet e romanit "Porta e diellit", dashuria, ndjenja që pushton Zhozetën, fillimisht si lidhje e ndërprerë, prej rrethanave shoqërore, me Andre Larbonë, ajo në frontin e luftës rigjen dashurinë e saj, me Zhanin dhe Pakon, dhe rihumbjen e tyre sepse u vranë në fushën e betejës, si dhe në faqet e romanit shfaqet dashuria e mbetur pezull me Ramonin. Në romanin *Hasta la vista*, kemi vetëm një linjë të dashurisë, një pamje të saj, në mes Gorit dhe Anitës.

- Dashuria si ndjenjë e thellë e romanit "Porta e diellit", dëshpërimin e ndarjes e përjeton në Francë dhe gëzimin që sjellë kjo ndjesi e bukur për Zhanin, Pakon, Ramonin, zhvillohet në Spanjë, aty në mjedisin e luftës. Kurse te romani *Hasta la vista*, linja e dashurisë në mes Anitës dhe Gorit, zhvillohet vetëm në mjedisin e luftës dhe lufta e ndërpreu ëndrrën e bukur të dy të rinjëve, dhe mbetet pezull linja e dashurisë, në frazën Hasta la vista, pra mirë u pafshim.

- Një aspekt që përfaqëson një ndryshim thlebësor është fakti që në faqet e romanit "Porta e diellit", kemi të pranishëm vullnetarët që kanë ardhur për të mbrojtur republikën, por aty ka edhe brigand-vullnetarë që kanë ardhur të mbrojnë monarkinë e Frankos, që përfaqësohet nga linja e Andre Larbosë. Kurse në romanin *Hasta la vista*, kryesisht është paraqitur linja e rezistencës së vullnetarëve që kanë ardhur, me i dalë zot republikës.

- Nga ana strukturore, në romanin "Porta e diellit", materia e gjerë tekstologjike, është ndarë në trembëdhjetë kapituj, relativisht të gjatë, që janë shënuar me numra romak, nga I – XIII. Po ashtu, në romanin *Hasta la vista*, të Petro Markos, ka një strukturim të përafërtë, madje me njëzet kapituj të zgjeruar, dhe të ndarë me numra romak. Ndryshimi në këtë rast lidhet me numrin, ku romani i autores franceze ndahet në trembëdhjetë kapituj, kurse teksti i P. Markos në njëzet kapituj.

Botohet në rumanisht vëllimi poetik "Foresteria" i akademikut Kujtim M. Shala



Dy fjalë për vargjet

Nis sot rrugën drejt vetëdijës së lexuesit të vëmendshëm e të zgjedhur një poezi që duket e çuditshme dhe vështirë për t'u përshkuar, por e cila, me siguri, në intimitet, mund të përjetohet, sidomos në periudhën e ngarkuar që po kalojmë. Shkencëtar i njohur, akademik në një moshë mjaft të re, me një vepër studimore të pasur e të vlerësuar, Kujtim M. Shala është edhe një poet i veçantë i brezit të vet, njëri ndër të paktët që, teksa përpiqet të pushtojë shenja e kuptime të fshehta të ekzistencës, nuk e ka lënë veten të mposhtet nga hermetizmi që paraqitet si origjinalitet.

Shkruar në një shqipe me rrënjët në dialektin geg, - bartës i një muzikaliteti dhe lakonizmi të veçantë, - poezia e Shalës është e strukturuar më së miri, por jo para se të shpërngulet në letër. Duket se uni lirik shndërrohet me ritmin me të cilin frymëzimi bëhet varg, duke sygjeruar e ndonjëherë mbase duke përcaktuar një hierarki tejet të saktë temash, vargjesh, kuptimesh.

Ekzistenca, rruzullimi, dashuria, vdekja, lënda, fryma, jeta, aparencat dhe esencat, nata dhe dita, gruaja e dashur dhe hidhërimi i ndarjeve, gjithçkaja dhe asgjëja, prania dhe mungesa, si dhe mjaft të tjera, në praninë e një trysnie të tipit apokaliptik, gjithnjë në kufirin ku bota e tanishme shpërbëhet dhe një botë e re vetëm sa skicohet gjejnë tek Shala një zëdhënës të besueshëm. Një zëdhënës që ka bindjen se *Ma e fortë se vdekja* **(është veç)** *dashunia* dhe që shkruan për të mbështetur të paktën dashurinë ndaj poezisë.

Botuesi

Romani “Ngjizja e papërlyeme” i Agron Tufës

SKANER RRËQETHËS I SIGURIMIT TË SHTETIT KOMUNIST

Nga Kosta Nake

Kam përdorur epitetin “i shëndoshë” për këtë roman sepse kam parasysh 731 faqet e tij me një format mbi të zakonshmin dhe një shkrim të ngjeshur. Leximi më mori një javë të plotë dhe ishte i mundimshëm jo nga stili, por nga objekti i veprës plot ngjarje me peshë historike e filozofike, mbi të gjitha nga toni tërësisht i ndryshëm nga librat që kam lexuar deri tani. Po e zbut duke përdorur fjalën “përbuzje” në vend të “urrejtje” për mjetet dhe teknikat e zgjedhura për sjelljen e karaktereve të sigurimsave dhe bëmave të tyre. Mund ta quaj një doktrinë për të ndryshuar disa kalke historike dhe botëkuptimore që këto vite tranzicioni vetëm sa i kanë këqyrur nga jashtë qelqnajës së trashë mbrojtëse dhe shumë pak i kanë prekur.

PËRBUZJA

Sipas meje, është e para vepër letrare ku shoqëria shqiptare e viteve të diktaturës komuniste dhe organizimi shtetëror i është nënshtruar një përzgjedhjeje të vëmendshme se si propoganda e atëhershme i shikonte klasat e përmbysura dhe forcat politike kundërshtare: “Ata kishin me vete policinë, pushtetin, simpatinë e shoqërisë dhe, sigurisht, halabakët. (f.13) Na e nginjën trurin e njomë me parrulla, me idole, me gatishmëri, me shkencë e skolastikë, me materializëm dhe domosdoshmëri historike, me shkak-pasojë dhe besim në Njeriun e Ri... Tani në kokat tona ka vetëm shkretëtirë të paskjatë, xhungël mbijetese. (f.157) Në mur varej një portret i udhëheqësit buzëtrashë. (f.309) Për ushtarakët përdoren karakterizimet qafëgic, qafëderri, fytyrëbytha, thatan, turiqena, zemërbisha, lukuni qensh të unshëm, si gostia e një zogorie qensh mbi pirg kockash.”

Autori atakon drejtpërdrejt partinë që kishte marrë përsipër të luante rolin udhëheqës në gjithë jetën e vendit: “Partia është një sekt satanist, si çdo religjion e di për mrekulli se ç’është në gjendje të bëjë miti tmerronjës e lebetitës i frikës dhe demonizmit... Jo mirësia, jo ndriçimi, jo dashuria e përvujtnia, por ankthi, mizoria, ndëshkimi i përgjakur e absurd i nënshtron turmat.” (f.641) “Njerëzit duan të jetojnë, frika e ankthi i rraskapit, i sfilit. ... Çmenduria dhe egërsia vjen një çast dhe të lodhin.” (f.642)

Gjithë kjo ngarkesë negative shkarkohet mbi dy qëndrestarë: Martin Gega si mbrojtës i kauzës antikomuniste, Ljuba Borisovna si mbrojtëse e dashurisë së vërtetë.

KOMPOZICIONI

Rëfimit të autorit i bashkohen edhe rrëfimet e karaktereve duke shkrirë kufirin midis vetës së tretë me vetën e parë njëjës. Kompozicioni i përngjan një prizmi ku e njëjta ndodhi dhe i njëjti karakter shikohen dhe rishikohen nga sy dhe kënde të ndryshëm shikimi. Ai bëhet edhe objekt diskutimi në vepër: “Çështja e kompozicionit është tortura më e madhe për një shkrimtar dhe jo procesi i shkrimit... Kompozicioni është në thelb loja me kohën, sepse suksesi i një arkitekti të mirë është organizimi harmonik i hapësirës dhe triumfi mbi kohën: ja se çfarë e mban një rrëfim dhe çfarë i jep dramacitet fatit të protagonistëve në një histori.” (f.659)

Romani hapet me prologun që i ngjan një amaneti për të rrëfyer një tragjedi që nuk është thjesht fati i një familje, por pikënisje për ta ndarë me dhimbjen e të tjerëve. Kaq mjafton që autori të sjellë në përmasa të ndryshme pesë modele të grave ruse që e lidhën fatin e tyre me atë të burrave shqiptarë: Zinaida që bashkëpunon me pushtetin komunist dhe ruan pozitën e lartë në fushën e artit dramatik, Ljuba që përballet me dinjitet me përndjekjen nga Sigurimi i Shtetit, Olja që e largojnë djallëzisht nga Shqipëria, Elena që qëndron larg rrymave të rrezikshme të ekspozimit politik, Ljudmilla që bëhet viktimë e burgut në Qytetin Stalin.

Pjesa e parë e romanit “Ofelia s’del në skenë” (f.19) fillon me Ljubën që qëndron para pasqyrës: “gjinjtë e kërcyer, të fryrë e të fortë, qafa alabstër me vena të kaltra, supet të rrumbullta, e shkëlqare.” Bukuria fizike e saj do të jetë edhe karrem vuajtjeje sepse nga njëra anë do të lakmohet marrëzisht nga Viktori që është mik dhe armik i burrit të saj dhe nga ana tjetër do

të tentohet të depersonalizohet nga punonjësit e sigurimit. Duke e vendosur Ljuba Borisovnën në qendër të veprës autori hap dy shtigje për linjat e subjektit: Të zbulojë fantazmat dhe përbindshat që bashkëjetojnë me njeriun dhe i nxjerrin kthetrat dhe përgjakin shpirtrat edhe në rrethet e ngushta familjare dhe shoqërore siç ilustrohet me rrëfimin e Zinaidës për motrën e saj Ira dhe burrin e saj Misha, po ashtu marrëdhëniet e Ljubës me Lev Kashkinin, Viktor Sallakun dhe Martin Gegën. Kjo i shërben autorit si indicje për ta shtruar marrëdhënien seksuale në një rrafsh filozofik si raport mes vullnetit dhe dhunës, pranimit me dëshirë dhe detyrimit. (f.257)

Martin Gega, i diplomuar si inxhinier gjeolog në Bashkimin Sovjetik, nuk pranon të ndahet nga bashkëshortja ruse dhe kaq mjafton që Sigurimi i Shtetit të gjejë pretekste ose të sigurojë dëshmitarë ta burgosë dhe vrarë pa gjyq për veprimtari armiqësore. Kur Ljubës i ofrohet roli i Ofelisë nga tragjedia “Hamlet”, Martini ka katër muaj që ndodhet në burg. Regjisorja Zinaida Mihajllovna e këshillon që të dalë nga pozicioni i vështirë duke filluar me joshjen seksuale dhe kurvërimin selektiv. Pikërisht këtu fillon heqja e tabusë për foljen e aktit seksual, përdorimi pa pika, pa asteriks, madje duke u ndalur në trajtën veprore dhe vetevetore, duke e kthyer në një nga veçoritë e punës së Sigurimit të Shtetit për depersonalizimin e njerëzve. Kjo bën që ky libër duhet lexuar vetëm dhe jo me zë për ta dëgjuar të tjerët. Atmosfera e nderë që përfton veprimtaria subversive e Sigurimit të Shtetit ka antipodin zbutës erotik që kalon paralelisht fund e krye veprës.

NJË ROMAN BRENDA ROMANIT

Qëkur ishte student në Moskë, Martini kishte shkruar një roman dhe dorëshkrimi i tij kishte arritur edhe te duart e poetit Samuil Ismari. Ishte një sprovë e hedhjes në letër të jetës së vet të rinisë. I ati e pati dërguar Martinin 15-vjeçar të çonte me kalë trasta me ushqime në majë të Çoparit, te Logjet e Zanave ku ishte çeta antikomuniste e Jup Ndreut. Atje ra

në pritë dhe ndodhi një masakër. "Kjo që po na bajnë komunistat s'ka mal që e mban mbi kurriz.... Nuk po lëmë me na bo zap do morra të partishëm. Ky pushtet mbushë me xhahila dhe këlyshë të anmikut shekulluer." (f.292)

Pasqyrimi i asaj masakre dhe pakënaqësia që s'mund të fshihet, e kthente atë roman jo vetëm në një krijim të pabotueshëm, por edhe të rrezikshëm për fatin e vetë autorit. Shoku i tij student, Viktor Sallaku, ka një parahistori antagonizmi me Martinin që te prindërit: I ati i Viktorit është shpallur dëshmor edhe pse "është vrarë duke vjedhur bostan", kurse i ati i Martinit është pushkatuar pa gjyq dhe është klasifikuar si reaksionar. Ljuba u lidh së pari me Viktorin, pastaj iu dorëzua Martinit duke filluar një rivalitet dashuror që vjen duke u rritur, edhe pse Viktori krijoi një lidhje tjetër me Olja Pisarjevën. Këtyre dy shkaqeve u shtohet edhe termi "malok" që Viktori e përdor për Martinin duke përftuar racizëm brendashqiptar dhe patologji të urrejtjes. Kaq mjafton që Viktori ta bëjë Martinin pre të Sigurimit të Shtetit duke i zbuluar Nesho Dragoit se ai ka shkruar një roman të dyshimtë. Si rezultat Neshua i thotë Viktorit: "Martini ka karakter dhe bindje antipushtet. Ai nuk është njeriu ynë." (f.358)

TRAGJEDIA "HAMLET" NË NJË VËSHTRIM TË RI

Rishikimi i trashëgimisë letrare botërore siç ndodh në këtë vepër me tragjedinë 'Hamlet' (f.58-59), përbën një veçori të kësaj vepre që e ndeshim gjerësisht dhe mjeshtërisht në Veprën e Ismail Kadaresë. Sipas autorit, Klaudit nuk i duhej mbretëria e të vëllait, po mbretëresha Gertrudë, jo froni por shtrati. Nga ana tjetër edhe Gertruda mund të jetë joshur fillimisht nga Klaudi, pastaj ka zgjedhur fronin. Mos mbreti ishte i paaftë në shtrat? Pse u zgjodh helmi në vesh? Kujtohet paralelizmi me Egjistin e Klitemnestrën te Sofokliu, Paolon dhe Françeskën te "Komedia" e Dantes. Duket qartë se autori jo vetëm se e ka rilexuar tragjedinë e shqipëruar nga Noli, por ka parë edhe variantin rus të Pasternakut. Një detaj ilustrues: Noli përkthen "qyqe" kurse Pasternaku "kukuvajkë." Qyqja dhe kukuvajka bashkohen te vetmia, por qyqja këndon ditën dhe kukuvajka natën. Noli e quan Ofelinë "zonjë", kur ajo është "zonjushë", kurse Pastërnaku e quan "ëmbëloshe." Së fundi, autori ka vënë re se fjalët "mos të të rrejë mendja dhe dije mirë" nuk janë fare te përkthimi i Nolit. (f.245)

SHKRIMTARI SAMUIL ISMARI.

Pjesa e fundit e romanit "Ç'lajme na sjell, Hermes?" (f.577) i kushtohet shkrimtarit Samuil Ismari, por ai shfaqet gjatë gjithë romanit, duke filluar që në pjesën e parë. (f.33) Ka ndonjë detaj që na bën ta lidhim me një shkrimtar real, që është ende i gjallë: "Samuil Ismarit iu zmadhuan bebet e syve poshtë qelqeve të syzave optike." (f.239) Kur shkrimtari rrëmbehet nga policia, shtrohet pyetja: "Kush do t'i dilte krah? Prindërit atje, në qytetin e Jugut." (f.710)

Duket qartë në vepër se autori është reshtuar në anën e adhuruesve të këtij shkrimtari. Kur Martini e pati takuar Samuilin në Moskë, i patën thënë se "është ylli në ngjitje i letërsisë së re shqipe," kurse Martini i thotë Ljubës se "është një fenomen i letërsisë më të re." (f.98) Shumë besojnë se Ismari është i shenjuar me talent, andaj një palë mundohen t'ia hanë kokën dhe një palë tjetër ta mbrojnë. (f.345)

Madhështinë ia njohin edhe ata që nuk e duan ose janë dyshues: "Një qiellor me flatra, dhelpër e rafinuar (f.335) S'e dija që qenka karagjoz kaq i madh ky Samuil Ismari (f.336) Ai është një pusht karizmatik, sa çdo femër e bukur do të ëndërronte një histori dashurie me të, në mos më shumë, një flirt." (f.344) Samuili është i talentuar... më i talentuari, por ama edhe me prirjet më të rrezikshme. (f.466)

Shkrimtari Tufa nuk është kufizuar vetëm me vlerësimet, por është i pari që e fton për të qenë pjesë e subjektit të veprës. Përpjekjet e Sigurimit të Shtetit për të shtënë në dorë romanin e birit të reaksionarit, arrijnë deri te marrja forcërisht e shkrimtarit Ismari nga policia dhe agjentët e sigurimit. Edhe pse shkrimtari Samuil përballet me dinjitet me represionin, autori gjen rast të bëjë edhe deklarimin e vet: "Nuk ka asgjë heroike në përballimin e torturave dhe nuk mund t'ia kërkosh askujt një heroizëm të tillë." (f.589) Ka dhe një shpjegim për titullin e kësaj pjese: Hermes është hyu që zbret në ballkonin e Samuilit dhe sjell "kumtet e qiejve." (f.656 dhe f.716)

Shkrimtari Tufa e shfrytëzon këtë pjesë të fundit për të na çuar të shohim një galeri figurash nga Lidhja e Shkrimtarëve, disa prej të cilëve janë lehtësisht të identifikueshëm: Poeti hundëfajkua Dritan Agalliu – një yll fushor në ngjitje në qiellin e poezisë së angazhuar shqipe (f.583) me namin e Ezopit (f.588) që ia thotë për dolli. (f.590) Kryetari i lidhjes, shoku Shute. (f.693) Dafina Luçi – anëtare e detashmentit "Engjëjt e hekurt" (f.594), e re, tunduese, alturiste, gjithë sharm, stil dhe dell aventuresk. (f.595) Nasihat Toçaj – prozator me subjekte sigurimsash, ambicioz i madh, servil, mediokër. (f.594) Nesho Dragoi me romanin "Kukuvajkat" kushtuar mërgatës, Dario S. që humbi jetën në një aksident ajror, etj.

HISTORIA

Agron Tufa i pari autor që në rrafshin artistik bën një luftë fyt për fyt e dhëmb për dhëmb me sistemin e diktaturës komuniste duke u ndalur në pikat më të zeza të atij sistemi. Ai guxon të heqë nga lista e temave tabu edhe çështje shumë të ndjeshme që lidhen me historinë e re të Shqipërisë, duke filluar nga lufta çlirimtare kur deklaron: "Historia do të vazhdojë të mbetet një bijë bastarde e kohës, përderisa atë do të vazhdojnë ta shkruajnë fitimtarët, sepse pergamena ku e shkruajnë do të jetë po e njëjta: lëkura e të mundurve." (f.525)

Në gojën e Martinit ai vë akuzën: "Pushteti ynë politik ka ardhur në qeverisje duke kryer krime gjatë dhe pas luftës." (f.427) Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri u shfaqën dy palë me qasje të ndryshme ndaj pushtuesit, por të dyja palët kanë dhënë jetën për qëllimin më të epërm në emër të atdhedashurisë. Pse disa quhen "dëshmorë" dhe të tjerët "tradhëtarë"? Pse disave u ngrihen lapidarë e të tjerëve nuk u gjendet eshtrat? (f.554)

SHTATZANIA E LJUBËS

Shtatzania e Ljubës pasi Martini është asgjësuar dhe pa kontakt me ndonjë mashkull tjetër, i ka dhënë titullin krejt romanit. (f.624-25) A kishte aftësi koitale dorëshkrimi i Martinit që gëlltiti për të sjellë ngjizjen e papërlyeme? A është një mrekulli? "Asnjëra prej fjalëve nuk e shpreh gjendjen e saktë të një gruaje, së cilës ia kanë thithur me shiringë shpresën deri në pikën e fundit." (f.624) Autori ka krijuar një linjë speciale subjekti për këtë rrjedhë të pazakontë të fatit të saj tragjik. Si gjithçka tjetër në mjedisin shqiptar, dukuria bëhet pronë e thashethemnajës, ai kapërcen cakun e shqetësimit familjar, hyn te rrethi shoqëror, madje autori thërret në skenë mjekun Zef Sheldia si zëdhënës shkencor i kësaj ngjizjeje të papërlyeme dhe na fut në hullitë e shkencës dhe alkimisë dhe në labirinthet e partenogjenezës dhe telegonisë, e vendos nën lupën e orgazmës dhe regjistrimit të materialit trashëgimor.

MJEDISI RUS

Një përkthim i romanit në gjuhën ruse do të tërhiqte vëmendjen në Rusi, sepse shtohet një tjetër shkrimtar shqiptar që ka qëndruar disa vite në Moskë i cili sjell detaje me toponime që provojnë njohjen e kryeqytetit rus, sjell krahasime gjuhësore që e tregojnë si njohës të gjuhës ruse. Mbi të gjitha është vendosja e një gruaje ruse në qendër të veprës dhe ngritja e saj në piedestalin e heroinës që mund të rishtrijë strukturën metalike mbi urën e dëmtuar nga agresioni rus në Ukrainë.

Durrës, 15-16 maj 2023

PORTRETI I MOTRËS TONE

Tregim nga Resmi Osmani

Shtëpinë e Idromenove në Gjuhadoll, të Shkodrës, e kishte pllakosur zia. Siç dukej, vdekja e kishte mësuar rrugën për atje. Sefte, babai Arsen Idromeno-Pargalliu, më pas një ferishte, djali i Kolës që si kishte mbushur dy vjeç, dhe ja tani ajo kishte rrëmbyer jetën e Antonias, motrës Tone. Trupin e saj ja dorëzuan tokës së ftohtë në varrezat e Rrmajit, shpirtin qiellit në amëshim, kurse dhimbjen sfilitëse e dërrmuese që u helmonte qënien, e ndrynë thellë në zemër.

Si e donte zakoni, pas drekës së mortit në shtëpinë e kunatit Andrea Skanjeti, përcollën miqtë e dashamirët dhe Kola me t'ëmën , të shoqen Cinën, të shoqëruar nga Lec Gurashi, u kthyen në shtëpi. Ishin veshur me të zeza. Gjithëçka dukej e zymtë, ngjante sikur edhe nga muret e shtëpisë pikonte pikëllim e dhembje. Qetësia dhe heshtja e bënin edhe më shtypëse e të padurueshme përjetimin. As Cina as Leci, edhe ata të pikëlluar e të vrarë shpirtërisht, që e shihnin me vështrim gati mëshirues Kolën, nuk folën një fjalë. Heshtja, sido që shtypëse, fliste me shumë se çdo fjalë ngushëlluese, që do të thuhej për fashitjen e dhimbjes pashërim.

Kola ,me këmbët që i rëndonin si plumb, bëri përpara për në odën e mirë. Në ballë të vendit, portreti i motrës Tone, e vërente me atë vështrimin e mistershëm, mendueshëm, si të donte t'i thoshte: "Vëllau jem i dashtun, jam këtu, me ty, me ju." Kola, me duart që i dridheshin, dhe sytë e mjegulluar nga cipa e lotëve, duke ofsharë e psherëtirë e mori portretin në duar. Duke ecur si i përhumbur, e vendosi portretin në syprinën e tryezës veneciane me dru mogani. Mori shandanin e argjendtë dhe si në një rit të shënjtë u dha flakë qirinjve për t'i dhënë dritë shpirtit të saj, që ku ta dish, kishte zbritur nga qielli. I kërrusur nga pesha dërrmuese e dhimbjes, u ul në karrige, përball portretit. Rrinte i shtangur, dhe ashtu në përhumbje s'ia ndante vështrimin. Botë e padrejtë, botë mizore. "O zot! Si e more parakohe motrën Tone, ia le fëmijët bonjakë dhe mua të mjerë? Ajo e vështronte nga portreti sikur diç donte t'i thoshte. Por edhe ai donte t'i fliste, t'i kallxonte sa shumë e kishte dashur, sa e shtrenjtë kishte qenë për 'të e me ç'hidhërim të thellë ia kishte helmuar jetën, duke i hapur një plagë të pashërueshme, sa të ishte gjall.

Por fjalët e tilla të shpirtit të trazuar,vetëm mendoheshin, por nuk thuheshin. Kurse lotët e gjetën shtegun e syve të lirë dhe u derdhën vetiu. Ai qau. Lotët i shkonin çurg. E shoqja dhe Leci, që i rrinin pas krahëve, u tërhoqën ngadalë dhe e lanë të shfrente brengën që i mundonte zemër e shpirt. Bëri duart grusht, i vendosi njera mbi tjetrën, mbylli sytë dhe mbi to uli ballin.

Iu fanit me vegime e laryshi gjithë jeta e shkuar si të kishte ngjarë dje. Ai kishte lindur një vit pas së motrës. Ishin rritur si të ishin binjakë me dashurinë përgjëruese të nanës Roza dhe babë Arsenit. Baba, Arseni, qe ishte fillikat, i ardhur nga Parga e Çamërisë, u gëzohej fëmijëve dhe i donte si drita e syve , ishte trashëgimi që do të linte familja Idromeno, në Shkodrën që e priti si djalin e vet. Motër e vëlla, përherë bashkë, hodhën shtat e u rritën. Rendnin bashkë livadheve, fugonin pas fluturave, gjuheshin me shuka bore dimërit. Tonia gazmore, e dashur, kishte zë të ngrohtë, të thellë e tingëllues dhe këndonte si laureshë këngët e bukura të qytetit të saj. Nisën t'i ftonin në ahengje e dasma, Kola i binte mrekullisht violinës, si të cicëronin një tufë zogjsh, kurse Tona e bukur, njomzake këndonte si laureshë, aq sa i magjepste dhe u ngjallte gaz e hare gjindjes së atyshme. Së pari ata u ndanë kur ai shkoi për studime në Venedik. Ato tre vite, i mungoi shumë, por ajo i dërgonte letra plot dashuri e mall dhe i shkruante për jetën në familje dhe ngjarje të qytetit.

Kur ai u kthye në shtëpi, Tonia ishte fejuar me mësuesin, e ardhur në Shkodër nga Trento e Italisë, Andrea Skanjetin. Kola e njihte Andrean, i kishte dhënë mësime të italishtes. Kur u martuan, Andrea kërkoi që Tona të vishej allafranga. Paçka se pajën e kishte bërë me Kostume popullore të grave shkodrane, ajo pranoi. Por pëlqimi dhe pengu i saj ishin kostumet shkodrane, plot ngjyra dhe qëndizma me ibërshim, gajtanë dhe fije ari e argjendi, që grave ua vinin në dukje bukurinë dhe madhështinë.

Vitet iknin. Në janar të vitit 1883, Tonia lindi vajzën e dytë. Ishte zakon, që pas të dyzetave të lindjes, nusja të shkonte për te parë në derë të babës. Tona, me ferishten, një vajzë si ëngjëll i vogël dhe, e përcjellë nga i shoqi, erdhi në gjini. Me vete kishte sjellë një boçallëk me veshje popullore. Me 'to u vesh sa kohë qëndroi në derë të babës. Ajo , e qeshur, gazmore i dha dritë dhe gëzim shtëpisë. Në atë kohë, Kola dhe baba Arseni, po ngrinin në avlli prapa shtëpise studjon fotografike që e quajtën "Dritëshkronja e Kolës". Në atë vrull pune, Kolës i lindi dëshira që t'i bënte së motrës një portret, me veshje popullore, që asaj i pëlqenin aq shumë. Donte që të provonte veten,"Pa le se ç'piktor ishte!" Dhe çfarë dinte të bënte, por në se e arrinte, Tonen do ta kishte përherë në shtëpi. Ajo pranoi.

-Motër e dashtun,duhet me pozue dit të tana e me pas durim.A mundesh?

-Hiç mos kij dert.

Për të pozuar e pikturuar, Kola kishte nevojë të binte dritë e bollshme mbi modelin, zgjodhi njerën nga odat në katin e dytë me dritaret që shihnin nga jugu. Hoqi kurtinat prej tantelle nga të dy dritaret dhe hapi përanash perdet. Drita e artë u derdh ne odë. Tona, hyri e veshur si për të kremte, me kostumin popullor të grave shkodrane. E freskët, e qeshur dhe e bukur si një lule shumëngjyrshe pranvere. Kola e vuri të rrinte ulur në kolltuk, me shikim nga dera. Ajo hodhi mbi krye degreminë e bardhë të mëndafshtë dhe e la t'i derdhej si ujvarë në shpatulla e pëqi tërë pala të vogëla. Në krahët e zbuluar, polka kishte ngjyrë kërmëzi të thellë, ndërsa posht mëngëve dilte mëndafshi i bardhë me ca vijëzime të tymta i këmishës. Stolitë ishin të thjeshta, vathët që mezi dukeshin dhe një kryq i vogël në zinxhir të artë e të imtë. Ngjyrat bënin kontrast, por mbizotëronte e bardha e velit të mëndafshtë. Veshja i jepte solemnitet, madhështi, hijeshi dhe fisnikërinë e një zonje të madhe. Atypëraty, mendoi se sfondi duhej të ishte i errët që t'a bënte më të dukshëm dritësimin e figurës së portretit.

Kola hapi kavaletin, shtriu dhe karfosi në të pëlhurën, në një tabaka vuri tubetat e bojrave, furçat dhe paletën. Por si fillim ai nuk pikturoj. Bëri vizatimin e disa skicave në letër me karbon, fragmente të ndara të asaj që do të ishte e tëra: kokën, trupin, duart, palat e velit, pastaj si një e tërë në disa qëndrime. Tona rrinte e qetë, por pastaj nisi ta humbë durimin. I vëllai ia kishte ndaluar të fliste.

-Për sot mbaruam.

Tona i buzëqeshi ëmbël. E kishte lënë të lirë tamam në kohë se e bija kishte nisur të ksinjej.

Kola iu kthye skicave mendueshëm duke i përsjellë në duar dhe duke i vrejtur me kujdes. Si duhet t'a pikturonte motrën? Ai solli ndërmend ikonat dhe afresket bizantine të kishave, të ngurta, të zymta nga të cilat buronte shënjtëri, përdëllim , mëshirë dhe dhimbje. Jo. Tona ishte ndryshe: motër e dashur, e qeshur, që e donte dhe gëzonte jetën, ishte nënë që kishte sjellë në jetë dy fëmijë. Solli ndërmend pikturat e mrekullueshme të salloneve dhe galerive të Venecies, të Rafaelit, Donatelos, Lindjen e Venusit, e sa e sa të tjera, ku bukuria femërore ishte ngritur në kult, gati në kufijtë e mitikes dhe mistikes, por edhe reale ,të vërteta, tokësore si Mona Liza, ku shpërfaqej misteri i botës së brendshme. Psherëtiu: ata ishin të pa arritshëm,por ai kishte ç'të mësonte prej tyre. Sidoqoftë, motra Tone duhet të ishte e vërtetë, ashtu si ajo ishte në jetë, por edhe disi ndryshe. Duke qënë vetvetja, njëhershe ajo duhet të ishte një grua shqiptare, e bukur dhe krenare, qëndrestare dhe heroinë, si mbretëresha Teuta, Nora e Kelmendit, si gratë e Zalongut të Sulit.

Kola e kuptoi se, sido që këtë e dinin vetëm njerëzit e shtëpisë, i kishte hyrë me dëshirë një pune të vështirë. Atë e pushtuan emocione dhe gjendja shpirtërore me ndjeshmëri të skajshme. Mos vallë ky ishte ai që krijuesit e quajnë frymëzim? I bënte vetes pyetjen e mundimshme: a do t'ia arrinte vallë? I futi skicat në dosje dhe doli për një kafe dhe, mbase haste Nikolla Gurashin(Lecin) , me të cilin e lidhte miqësi e ngushtë që, të ndante me të shqetësimet dhe emocionet e punës së nisur.

Të nesërmen, qëlloi ditë e kthiellët, por e freskët, natën kishte rënë brymë. Dielli ndrinte dhe në studion e stisur për këtë rast, derdhej lumi i dritës së artë që paralajmëronte pranverën. Tona u ul në kolltuk, po në atë qëndrim të një dite më parë. Kola, i veshur me përparsen bojqielli të punës, renditi furçat mbi tryezë, shtrydhi tubetat e bojrave mbi paletë dhe nisi nga puna. Sefte me kryet. Punonte shpejt. Hodhi konturet, velin e bardhë që mbulonte kryet deri te supet, pastaj nisi nën ballin e bukur, vetullat e holla që u bënin hije syve, pastaj pikturimi i syve. U ndal gjatë. Sytë janë porta e shpirtit. Sytë flasin dhe, sytë e Tonës, rrezatojnë dritën e shpirt të bukur, të dashur e të ndjeshëm, për atë çka është dhe për atë që ëndërron të jetë. Por shpesh ata janë edhe zhbirues. Ai shikimi pak anash, enigmatik e i tretur në pafundësi , si të hetonte diçka vegimtare, diçka si në pritje të pranverës që po trokiste. Ishte i duhuri. Për pak Kola u ndal. Duhet të lante furçat. Tona u shtriq, u ngrit dhe filloi të sillej nëpër studio që të shpinte gjymtyrët. Me zë të ulët por gurgullues e tingëllues si një zile argjendi, nisi të këndonte këmngën "Kajrafilat që ka Shkodra". Më pas me nënqeshje çapkëne e si me shpoti ajo e pyeti.

-E ke takue Agustinën?

-Jo.E pse duhet me e takue?

-Leni ato me motrën.S'ka uzdajë me ma kallzue.

Kaq mjaftonte. Nuk e ngau më tej.E dinte që i vëllai kishte shtënë merak në Cinën. Ajo ishte vajzë e bukur, e mençur dhe nga shtëpi e mirë. Edhe Kolës i kishte ardhur koha për martesë.

I vëllai i tha të pozonte, dhe ajo mori sërish atë qëndrimin që ai i kishte thënë se duhet të mbante.

Kola punoi deri afër dreke. Nga kavaleti e vërente, portreti i së motrës, ende i papërfunduar, kishte edhe shumë punë për të bërë, por tashmë ai e kishte arritur ngjashmërinë. Portreti ishte pjesa më e vështirë e pikturimit.Të tjerat ishin më të lehta.

Ditët në vijim ai u mor me duart dhe veshjen. Kur ishte në Akademi dhe mësuesi u jipte duar për të vizatuar , kishte dëgjuar se piktori Fransisko Goja u kushtonte vëmendje të veçantë duarve. Në tabllonë e famshme "Famklja e Karlosit" për 14 portret kishte pikturuar vetëm katër duar! Duart e Tones, të bukura ,me pak stoli, ai i vendosi që ato të rrëfenin elegancë. Dorën e majtë, me dy gishta e bëri të kapte velin, për të mbuluar një çip të fytyrës, por edhe për të zbuluar

ëmbëlsinë e bukurisë në sfondin e bardhësisë së mëndafshit, e për t'a bërë më enigmatike një far droje e misteri të pa shfaqur, përballë atyre që më pas do ta sodisnin e që do të donin ta zhbironin e hamendësonin të fshehtën e saj. Dora tjetër, e stolisur me unaza, e pëthyer në bërryl, me gishta pak të përthyer, tërheq pak velin që të lenë të duket veshi me vathin dhe gusha farfuritëse. Sërish u ndal në fytyrë, ca penelata në hundë dhe në gojën e vogël dhe buzët e bukura, rrumbullakësia e mjekrës, pakëz e dalë përpara shprehte forcë vullneti e karakteri.

Pikturimi i veshjes i mori më shumë kohë sesa e kishte menduar. Jo ngaqë Tona e kishte merak, por veshja ishte pjesë e sqimës dhe rrëfente shtresën shoqërore se kujt i përkiste. U ndal në çdo palë të velit, me hijedritat, si një valëzim që rrëfente lëvizjen e brëndshme dhe një far padurimi, i dha pak nuance të mezidukshme jargavani velit për të zbehur bardhësinë dhe të kafejta mëngëve të kërmëzta të polkës dhe një të përhinjtë si të tymtë vijëzimeve të kemishës prej byrynxhiku që delnin nën mëngët e polkes.Me majën e nje peneli të hollë bëri të dukej zinxhiri i hollë i artë dhe kryqi.

Portreti thuajse ishte i përfunduar. I erdhi radha sfondit. E mendoi se duhet të ishte i errët, në kontrast me dritësimin e figurës, për ta bërë më të dukshme. Dalëngadal, pa ngutje, përgatiti ngjyrën, e zbuti disi të zezën me pak të bardhë për të mos qenë shumë e errët dhe lyeu me 'të pjesën e pikturës jashtë portretit. U ndal gjatë dhe po e vërente me kujdes si të mos ishte puna e tij por e dikujt tjetër dhe ai mund t'i bënte vërejtje. E ndjente se diçka i mungonte, ishte një gjë fare e vogël, por e nevojshme nga e cila portreti do të përfitonte shumë bukuri e vërtetësi, por ai s'po e gjente dot. Nata që erdhi, ia shfaqi me një ëndërr të çuditshme . Ishte në Pargë të Çamërisë, në buzëdet.Çudi! Ai s'kishte qenë kurrë aty, por ia kishte rrëfyer baba Arseni me përmallim, kur fliste per vendlindjen e tij, Pargën, buzë Jonit. Drita e veçantë e artë përzier me të kaltrën e qiellit, që dukej si e derdhur nga dielli , buronte së thelli e refkehtohej nga deti dhe, u jipte atë shkëlqimin e nurshëm e të butë gjithë qytetit dhe kurorave të ullinjve dhe portokajve. Ai e sodiste i mahnitur. Të nesërmen ai e dinte se ç'duhej të bënte. Por kjo s'mjaftonte. Ishte dhe një tjetër dritë, ajo e brëndshmja që buronte nga shpirti dhe fekste nga sytë dhe çdo pore e fytyrës e që i jipte embelsi bukuri e dashamirësi pamjes dhe qëndrimit. Për dritësimin e parë, mendoi që t'a zbuste me ca nuance të argjendta ndriçimin e fortë. U desh pak punë e kohë dhe drita fitoi atë ngrohtësi e butësi që ai deshi t'i jepte. Për të dytën, i duhej që Tona të pozonte. Ajo kishte shkuar të mendte të bijën. E thirri dhe ajo nuk mënoi të vinte. I tha të ulej në qëndrimin e zakonshëm. Ajo u bind pa fjalë.

-Motër, të lutem, mos u vrenjt, çliroje fytyrën dhe më jep një buzëqeshje.

-Qeshje apo buzëqeshje?-dhe ajo u ngërdhesh.Pamja e fytyrës u tjetërsua.

-Mos ! – i tha.

-Ishte shaka- pastaj buzëqeshi, ashtu si dinte ajo, një buzëqeshje e lehtë, e mezidukshme, që i hijeshoi pamjen, teksa nga sytë e bukur buroi ajo drita plot mirësi e dashuri.

Kola e falnderoi dhe e lejoi të largojhej. Mund të punonte pa 'të. Me ngut, që të mos i ikte nga sytë ajo pamje e së motrës, ai hodhi penelatat e duhura. Portreti fitoi cilësi të re. U bë më njerëzor, ëndërrues, më i dashur, më i afërt, ajo ishte motra Tone, por edhe disi e veçantë, me fisnikëri , bujari, krenari e dinjitet. Grua e vërtetë shqiptare.

E mbuloi portretin dhe e la të thahej. Duhej te gjente një suazë të punuar bukur, që të vinte në dukje vlerat e portretit.

Ndjehej i çliruar, por i lodhur, disi bosh, si të kishte zbrazur mbi atë portret gjithë shpirtin, energjinë, dijet dhe talentin e vet. Kishte punuar papra shtatë dit. Aq sa punoi Zoti për të krijuar botën! U ul në divan që të prehej.Për të, ky ishte një provim. E kishte fituar vallë?

Të nesërmen, familjarët, Nikolla Gurashi, kunati Andrea Skanjeti dhe miq e mikesha, u ftuan të shihnin portretin. Kur ai e zbuloi, u dëgjua një "ah"që shprehte habi dhe admirim.

- Sa bukur!

-Mrekulli!

-Tona dukesh si mbretneshë!

-Të lumshin duart Kol, që e ke qendis aq bukur motrën Tone!

Shihnin herë portretin, Herë Tonën. Ajo u ndje në zor dhe purpuri i mbuloi fytyrën e bukur.

Andrea Skanjeti nuk po bëzante. Po pamja e gëzuar e fytyrës rrëfente se portreti i kishte pëlqyer.

-Bukur Kol, por më mbetesh borxh. Dua një portret të Tones me veshje allafranga.

Kola ia premtoj.

Tona nuk mund ta dinte që i vëllai e kishte përjetësuar në atë portret që do të mbetej dhe admirohej nga brezat, si "Mona Liza"shqiptare, kurse Kola nuk e dinte që kishte krijuar të parën pikturë të artit pamor realist në Shqipëri.

Në këndin e djathtë të portretit, shkroi: Kol Idromeno,23 shkurt 1883.

Tiranë-Shkodër, nëntor 2020- maj 2023

Frymëdyzim

Nga Edison Çeraj

1.

Mund të thuhet se kemi trashëguar dy botëkuptime bazë – që e kundërshtojnë njëri-tjetrin – për sa i takon motivimit që e shtyn nji autor drejt krijimit, apo drejt asaj gjendje që njihet si "frymëzim".

Botëkuptimi i parë është ai religjioz, që na thotë se frymëzimi vjen prej Zotit (në kulturat pagane flitet për muza). Ndërsa i dyti, botëkuptimi materialist, na thotë se vepra e artit është bijë e kohës dhe hapësirës ku jeton autori, e gjendjes socio-ekonomike dhe e klasës apo kastës ku ban pjesë, domethanë e rrethanave në përgjithësi.

Pra, simbas botëkuptimit të parë, shkëndija vjen nga Qielli dhe shndërrohet në motivim; kurse simbas të dytit, janë faktorët e jashtëm ata që e motivojnë autorin.

Në fakt, secili ka diçka për me na thanë dhe lanë, dhe për rrjedhojë nuk kemi pse t'i qasemi sipas logjikës "o njëri, o tjetri". Në pamje të parë, natyrisht që këto dy botëkuptime e përjashtojnë njëri-tjetrin, sepse për botëkuptimin materialist nuk ka as Zot e as muza; është vetëm materia dhe natyra në përgjithësi. Ndërsa botëkuptimi religjioz ka prirjen t'i neglizhojë faktorët e jashtëm, në disa raste edhe t'i përjashtojë si të parandësishëm.

Teoria dhe teologjia mund t'i qërojnë dhe ndajnë gjanat, por në jetën e jetuar ato ndërthuren, marrin e japin me njëra-tjetrën, sepse shpirtërorja dhe materialja nuk ndahen dot, ashtu siç nuk ndahet uji i detit nga kripa.

2.

Duke kaluar në nji rrafsh tjetër, mund të numërohen tri gjendje krijuese:

i. ajo gjendje kur "detyrohesh" me punu si rrjedhojë e presionit të jashtëm: "duhet me punu", "shumë pak punë/vepra ke", "ke kohë pa ba diçka" etj., domethanë krijimtaria si profesion, si angazhim konstant. Në këtë rast krijimet dalin skematike, me puls të shuar. "Mediokriteti pandeh se artisti mund të krijojë rregullisht, si nëpunësi. Që këtej rrjedh fatkeqësia." (Balzac)

ii. Kjo është ajo gjendje kur ndikohesh nga nji autor, dhe për pasojë e gjen veten të motivuar për me kriju, mirëpo veprat që dalin nga kjo gjendje bartin ma shumë gjurmë të tjetrit. Kështu, në këtë rast ka ma shumë "përkthim" se krijim.

iii. Kurse gjendja e tretë është ajo gjendje kur e gjen veten duke kriju pa nji shtysë konkrete të jashtme, thjesht ashtu të vjen, përtej të gjithave. Veprat që dalin nga kjo gjendje kanë gjurmën tënde, dhe si të tilla nuk i ndërlidh dot me veprën e dikujt tjetër, pavarësisht se munden me të kujtu këtë apo atë.

Fundja, nga hiçi (*ex nihilo*) nuk krijon askush.

Edhe për këto tri gjendje vlen me thanë se nuk janë "të ndara me thikë", sepse kanë pikëtakimet dhe gërshetimet e tyre teksa nji autor është i zhytur në procesin e krijimit. Ajo që ka nji randësi të veçantë është se vepra duhet me bindë fillimisht autorin, se përndryshe nuk i bind e nuk u thotë gja as të tjerëve.

3.

Thuhet se Gauguin-i mori arratinë drejt ishujve të Polinezisë në kërkim të ngjyrave. Por, ai thjesht kishte nevojë për qetësi, për mëvetësi metafizike, për me i ikë rrjedhës, për me u shkëputë prej zhurmës akustike e pamore të metropolit parisien të kohës, sepse ngjyrat ishin brenda tij, ai vetëm sa hoqi pengesën që i mbante të kyçura. Pra, ngjyrat brenda tij (shpirtërorja) nga njëra anë, dhe ndërrimi i rrethanave (materialja) nga ana tjetër.

Shtegtimi i tij, si i shumë të tjerëve, ishte sa shpirtëror, po aq edhe fizik.

Shtegtimi shpirtëror nuk jep dot fryte, nuk ia shohim dot gjurmët nëse nuk shoqërohet prej shtegtimit fizik.

Pikërisht përmes këtyre gjurmëve hyn në botë dhe bahet kujtesë.

Persiatje mbi romanin "Asnjëherë të martën",
i Bashkim Hoxhës, botoi Onufri

VDEKJA VJEN PËRTEJ SË MARTËS

Nga Agim Bajrami

Për të nisur leximin e librave të Bashkim Hoxhës, një lexues ka njëmijë e një arsye, por arsyeja më e fortë është se librat e këtij autori janë si një skenë teatri, ku personazhet luajnë dramën dhe tragjikomedinë e tyre, me një sinqeritet deri në vetëmohim dhe për më tepër, pa kërkuar prej askujt duartrokitje.

Në këtë kontekst nuk bën përjashtim as libri i tij i fundit "Asnjëherë të martën", roman që e pasuron edhe me shumë opusin e tij letrar me temat e nxehta të bashkëkohësisë. Edhe pse në pamje të parë të krijohet ndjesia se kemi të bëjmë me një histori policeske, me vrasës dhe të vrarë, e vërteta është ndryshe. Është një vepër, ku personazhet janë modeluar në bazë të raportit kohë hapësirë, po ku nocionet formale të kortezisë, ka kohë që që janë prishur, ose janë kthyer në të kundërtën e tyre. Është ky realitet, që i jep veprës së këtij autori një shpërfaqje përtej të zakonshmes. Është ky shkaku, që kufijtë mes narrativës së jashtme të shkrimtarit dhe narrativës së brendshme të personazheve, të jenë të padukshëm, ose në rastin më të keq krejt formalë, duke dalë kësisoj nga stereotipat dhe formatet tradicionalë te diskursit.

Bashkim Hoxha jo pa qëllim zgjedh kohëra tranzite dhe situata gjer në kufijtë e absurdit. Ai e di, se prej tyre mund të nxjerrësh krijesa hibride dhe material po aq interesant. Shumica e heronjve të tij sikur kanë dalë nga një album të sëmurësh depresivë. Edhe pse shpesh herë shfaqen para nesh me pamje të zakonshme, ose me kostume të shtrenjtë filozofësh provincialë, brendia e tyre e padukshme, le vend për t'u mëshiruar. Shumica e tyre janë të implikuar në vrasje, ose veprimtari kriminale, dhe janë të dënuar të ndiqen nga mbrapa nga turma e hijeve të viktimave të tyre. Edhe pse bëjnë gjithçka për të shpëtuar, dalja e tyre nga metafora e fatalitetit është e pamundur.

Jo më kot fatthënat që kundrojnë dhe parashikojnë jetët e tyre në këtë vepër, kanë zakonisht fytyra të ngrysura dhe shohin çdo natë ëndrra horror. Nga ana tjetër Bashkim Hoxha, nuk e kundron personazhin e tij vetëm si viktimë rrethanash shoqërore, por edhe një si viktimizues të pamëshirshëm të saj. Në sinkron me këtë, ai pikturon edhe ambientet urbane, ku rriten dhe zhvillohen ata. Ndofta është ky çelësi magjik me të cilin ai arrin të motivojë ngjitjet e përkohshme dhe rrëzimet e tij. Denis P (alias Vladi) në fillim ishte një njeri i rregullt, gjersa një ditë të bukur, kthehet në një vrasës profesionist të rrezikshëm. Mendimi i parë që mund që të vijë në këtë rast, është se brenda tij mund të ketë ngjarë ndonjë shkarje, apo shok i rëndë psikologjik, pasi në jetë ndodhin shpesh trauma të tilla. Por mbasi bëhesh vetëm pak kohë bashkudhëtar i ambienteve të frikshëm ku është rritur dhe formuar ai, bindesh për të kundërtën. Janë koha dhe aksesorët e saj të përbindshëm shkaktarët kryesorë të këtij transformimi. Jo më kot gjatë gjithë aktit të leximit, lexuesi ndjen një mungesë të vazhdueshme ajri dhe një ankth që të vret pak nga pak. Pikërisht ky ka qenë edhe qëllimi parësor i autorit. Depërtimi në substratin e së keqes dhe trajtimi sa më i thellë artistik i saj.

"Vdekja si fillim, vdekja si fund"

Ashtu siç e thamë që në krye, ky roman fillon me një deklaratë të pazakontë, për një vrasje të pritshme

"- Të martën e kam pushim, nuk bëj vrasje. Të mërkurën po. Pastaj do iki." Edhe pse ngjan se Denis P, i ka shpëtuar pa dashje kjo gjë, një deklaratë e tillë shërben si një mjet artistik mjaft i gjetur nga ana e autorit, për t'i dhënë veprës së tij që në krye, një fillim intensiv. Detaje të tillë, që autori i përdor herë pas herë si pjesë e teknikës së tij narrative, janë të aftë ta gjallërojnë dhe ta bëjnë më lëvizshëm dhe më dinamik rrjedhën romaneske. Protogonisti dhe hija e tij fizike, ecin krah për krah njëri-tjetrit, për një kohë të gjatë, por që nuk e pyesin njëri-tjetrin se ku do mbërrijnë, pasi ata e kanë të qartë destinin e tyre fatal. Vizatimi i një peizazhi të tillë gri shoqërohet patjetër me një muzikë të trishtë të tipit funebër dhe aq më shumë kur plotësimit të peisazhit, i shërben edhe dalja herë pas here në skenë e simbolikës së Shën Kozmait, shenjtit me një kokë të prerë në duar. Si një vepër me pohime të fuqishme, të tillë detaje e përforcojnë më shumë faktin se ne të gjithë udhëtojmë gjatë gjithë jetës sonë, me vdekjet dhe kafkat tona në duar, pavarësisht lumturive dhe humbamendjeve tona të përkohshme. Synimi i autorit, për të treguar se ç'pjesë te vyera shpirtërore humb individi, kur bëhet pjesë e së keqes, jepet nëpërmjet kurbave të herëpashershme të një jete njerëzore, gjithnjë e në rënie, çka një lexues i mirë, mund t'i ndjekë vazhdimisht hap pas hapi.

Ajo çka të bie në sy në shumë romane të këtij autori, është autenticiteti i rrëfimit. Shumica e heronjve të tij, kanë një dëshirë të lindur për ta marrë vetë përsipër narrativën e veprimeve të tyre, duke u rreshtuar kështu në një vijë paralele me autorin e veprës, në një duet interesant.

Nëse do të hidhnim një paralele me këngët polifonike të jugut, ne këtë roman kemi të bëjmë më dy lloj narratorësh. Narratori A (ose marresi), që është shkrimtari, dhe narratori B, (ose kthyesi që i takon të jetë Vladi). Zhvillimi i veprës varet natyrisht nga harmonizimi i zërave të tyre, pa i interferuar dhe pa i hyrë njëri-tjetrit në pjesë. Në kontrast me tonet e buta dhe të qetë të narratorit A, tonet e larta dhe ndonjëherë të pakontrolluara të narratorit B, janë kaq të nevojshëm.

Së pari i shërbejnë autorit, për të prishur linearitetin e narrativës, por më së shumti i shërbejnë narratorit B që ka një etje të tmerrshme për të rrëfyer historitë e trazuara të jetës së tij të trazuar dhe për t'u lehtësuar disi. Duke i mbledhur në një shumësinë e ngjarjeve dhe historive, pohimi baze i të dy narratorëve është se:

"- Në kohëra të çmendura, askush s'habitet më me habinë."

Duke qenë një autor që e njeh gjer në detaje periudhën e tranzicionit të pamëshirshëm shqiptar, dramat dhe tragjeditë që ka prodhuar dhe vazhdon të prodhojë ai, autori i mëshon fort idesë, se kur njerëzit mësohen me të keqen për një kohë të gjatë, shndërrohen padashje edhe vetë në mbrojtës dhe kalcifikues të saj

Personazhi kryesor i romanit, ka kohë që vuan nga halucinacionet. Që mbas vrasjes së parë, Vladi nisi të bëhej i verbër si plumbi, sepse historitë e tij të mëparshme ia vodhi mjegulla.

"Nuk ka kohë të shohësh qiellin, nëse vret një njeri", thotë ai me trishtim përpara aktit të vetëvrasjes.

Diskordancat e dukshme mes kohës së reflektimit dhe kohës së rrëfimit janë të shpjegueshme:

"Me sa duket, kolona zanore e kujtimeve, mund të jetë e trishtuar", thotë ai.

Ose: "Në luftë shkohet për të vrarë, nuk shkohet për vallzim".

Intriga e thyerjes së Vladit kalon nëpër një trajektore të gjatë dhe të ndërlikuar katharsisi. Një proces i tillë, që ndeshet kaq shpesh edhe në shumë vepra të letërsive të mëdha, në romanin "Asnjëherë të martën" ka një specifikë të veçantë. Përshtypja ime është se ai u shpall që në momentin kur kuptoi kotësinë dhe fatalitetin e qenies së tij, në këtë ambient pa rrugëdalje. Rendja nëpër natë, në kërkim të Marinës të "dashurës" së tij mbas grindjes për abortin e foshnjës, vrarja e ndërgjegjes dhe dëshira e çuditshme që e pushtoi për ta pasur atë pranë bashkë me fëmijën, humbja e saj së bashku me trashëgimtarin e mundshëm dhe më në fund vetëvrasja.

Edhe pse mund të ngjajë paksa e çuditshme për dikë veprimi fatal, unë mendoj se autori ka vepruar drejtë. Një individ si Vladi, që hyn aksidentalisht në një rrugë të shtrembër, dikur do kërkonte për të dalë prej andej, duke marrë mbi vete edhe kostot. Shfaqja e herëpashershme e imazhit të nënës birësuese dhe asaj të vërtetë kanë lozur rolin e tyre. Në kuptimin metaforik, Denis P ndihej kaq i vetmuar larg tyre ndaj, dhe shkoi për t'i takuar.

Bashkimi të intrigon që në titujt e veçantë, që iu vendos librave të tij. Janë ata që të orientojnë për të hyrë sa më shpejt nga porta kryesore e veprës dhe jo nga dritarja. Relacionet e këndshme mes elementit publicistik dhe atij romanesk, i kanë sjellë risi dhe veçanti të spikatura veprës së tij. Kjo gjë duhet thënë edhe për mënyrën e thurjes së subjekteve dhe tipologjinë e larmishme të personazheve, njëri me interesant se tjetri, si dhe kurthet e shumta artistike, nëpër të cilat ngecin ata.

Është ndofta kjo një arsye me shumë, që fiksioni të ushqehet nga realiteti dhe dallimet mes tyre, të jenë kaq pak të dallueshëm. Në këtë vepër spikat tendenca e autorit për ta shqyrtuar heroin e tij nëpër disa faza vëzhgimi, si dhe një rikthim më këmbëngulës "drejt së brendshmes" së tij ekzistenciale. Ndaj nuk është rastësi që mbasi ke kthyer edhe faqen e fundit të "Asnjëherë të martën", të të mbetet në duar skeleti i kartontë i një individi pa të nesërme dhe pyetja, se deri në ç'shkallë mund ta katandisë atë perversiteti dhe imoraliteti i një shoqërie pa moral.

TAKOHEMI NË ËNDËRR

Poezi nga Arben Velo

Mars

Nga zbriti si gropë zanoresh, ky qiell
pasthirrmat tona në sekonda shirash i dha
Ca shkrepje zakonesh, me re mbështjellë
kërkojne mbretëri, aty ku njerez nuk ka.

Bashtingellore të mia pse blegërini atje
si dhi që shtegtojnë për bisqe të njoma?
Livadhet u grisën nga shputat e dreqërve
dhe mungesa e shuajve të këpucëve tona.

Vetmia zbret në njerëz, pallatet zënë falen
në drita kthejnë qirintë e shiut të beftë
Në pasqyra uji, vetëtima mallesh
ndërtojnë e shkatërrojnë varrin e vet..!

Gjendje qytetase

Një djalë u nis sot për në qiej
jetëshkurtër, iku majë gishtave.
Unë ngela ballë filxhanit të kafesë
në qytetin mbytur gjer në fyt
me fjalë dhe me shpresë..

Një burrë frymon
ankth brenda meje,
mijëra vjet para se Eva t'ia merrte mendtë
I zhveshur nga ëndrrat
Adam i gdhendur
brenda filxhanit të fatit të vet.

Takohemi në ëndërr

Sa bukur do të ishte të takoheshim
brenda një ëndrre...
Të grindeshim me vetminë
që ende ska ardhur,
si një tren në stacionin e agut.
të përcillnim hiçin në muzgje,
duke vallëzuar si dy pulëbardha
mbi ujin e kripur.
ta ndryshonim botën e ëndrrave
e kthyer në avullore të ndryshkur
ngarkuar me lumturinë tonë
me lodrat e urisë
si copa buke
për fëmijët ende të palindur
Të mbillnim bar të ri, lumenj të egër, gëmusha
një hënë që të zgjatej si gjirafat
mbi fushat e dëshpëruara nga vetmia
Bashkë ti kërkonim falje dhimbjes
kur do të vij, se dijmë
me ikjet që na ndajnë përgjysmë.
Do të ishte bukur!
Paçka, mund të kthehemi
emra pa mbiemra
në listën e borxheve
të shitesit të kujtimeve..!

Bekim shkurti

Për mua një fushë, është një fushë
çdo muaj ka mall për fshatarin
Mëllenjat, me veladon priftërinjsh
Ua nisa, që të bekojnë ugarin....

Shkurt...

Nuk po më lë të qetë kujtimi yt
i ngecur mes dy brinjëve.
(Më kot po pret ta zbuloj
veshur me bluzë të bardhë
Rosaku i zi i radiografive)

Më dridhen duart duke të kërkuar
Ty dhe hijen tënde të zbardhur
(Sa i jep frymë ajrit tim
në këtë Shkurt të shkurtër
sa gogësitja e erës...)

.. Sa nis të plugoj lotin e fshehtë
Thyhet parmenda e zemrës

Pak fjalë për të premten time

Erdhi e premtja, unë zbrita nga zemra
në sheshin ku pëlcet qyteti
në një biçikletë shpikur me dy sytë e Asaj
pedalon para meje mëngjesi.

Një gjysh që shkoq vesën, dërsin edhe barin
me agimin në një garë është vënë
(Kush zbut egërsinë e biçikletës për nipin
si zile biçiklete, fiton një miniHënë.)

Ca romë fishkëllejnë një tymnajë kënge
(e festuan Shën Gjergjin e tyre)
Nga pema e mendjes dikush flatron
të kërcej valle me yjet.

Më kryqëzohet hija mbi lumin Gjanicë
(shpinën time ka shtrat të saj)
E Premtja tringëllon Hënë, si zile biçiklete
-"Ej hapu- më thotë, -zbrit nga sytë e saj...

Lajm mesdite

Te kioska e rrjepur nga boja e heshtjes
ndaloj, dua të blej një gazetë
rreshtuar pozojnë gergujt e zinj të lajmeve,
veç shitësi me sy po i vret.

Një burrë mban në kokë kapelën e kashtës
tymon i mpakur cigare
Nga goja e tij, si nga një pus I tharë
dalin shtëllunga prej hallesh

Nuk është dordolec, të tremb sorrat e hijeve
kërkon një punë, është njëri
Për gergujt e zinj të lajmeve të ditës
pranon dhe si dordolec, të rri

Nga kioska e rrjepur nga boja e heshtjes
po iki, sdua të blej gazetë
fluturojnë gerguj lajmesh, mbi kapelën e kashtës
Ai tymon shpirtin dhe me sy i vret....!

Dy fjalë për perëndimin

Një dele krrutë e perëndimit
m'i hëngri akaciet e dritës
me thuprat e hijeve, romët e munguar
shqetësimin ma thurin kanistër...

I kthej valët e Vjosës në krrabë
(Vjosën që rrjedh brenda shpirtit)
Asnjëherë për be, nuk munda ta kap
Delen krrutë të perëndimit...!

Fshat ..

Paska ikur nga kjo botë xha Skëndua
natën që erdhën xixëllonjat në fshat.
me dritën e tyre, burrat, ndezën cigaret
zanoret e kujës ndezën gratë.

Unë, nuk e dija, i shihja sipër shtëpive
me dritë të shterur pikë- pikë,
Dhe sdi pse më ngjanin si sy njerëzish
çastin kur japin shpirt.

Nga shtatë, takova gjashtë pleq
(gjashtë psherëtima në fshat kanë mbetur)
E shtata mungon, ishte qeshja e tij
(mërzitë kthente, në kafe të pjekur.)

Sot kur mësova vdekjen e tij
pashë ankth në çeljen e kumbullës.
Kuptova pse xixëllonjat krrusin barkun e dritës
(kërkojnë gjurmë nga e qeshura e tij rrugës.)

Zogjtë japin meshë për një fshat!
Në fshatin tim dallëndyshet
për ikjet e njerëzve japin meshë
si ikonastas kanë llullat e gjyshërve
atje i kanë ngritur foletë

Nëpër rrugët e lagjes, harabelat
si besimtarë që shkojnë në xhami
nga qiejt, sikur falin namazin
(të mbushen ato me fëmijë)

Përbri vetmi trëndafilash
nxitoj me kapelë mbi kokë
(kaq kohë pa më parë, nuk më njohu
një drethkël, si kyç mbi një portë)

Parmakët e një deriçke të ndryshkur
përhitur me ca hije mbi shpinë
(janë hijet e të zotërve larguar
I kanë lënë si fjalëkalim)

Mundohem të jem haker pranvere
fjalë kalimet e hijeve të di
Çdo ditë, pas meshës së zogjve
Hardhitë çelin password të ri.

Trill qytetas

Ky qytet ka femrat më të bukura ne botë
Ato flokët krehin mbi një lum të palumtur..
Më kot presin meshkujt si anije
të mbushen me të qeshura të palindura....
Femrat shkruajnë me krëhër
letra për dashuritë e mërguara.!
.
Kur lumi kthehet në pasqyrë
e vërshon nga gjokset e femrave,
Meshkuj ngrejnë velat
nisen në lundrim...
Pa e ditur në ç'mole do të ankorohen.!

Si ta përkthej gjuhën e barit

Dhe mendjen e vras, si të flas me barin
të komunikoj, e mik ta bëj sot
Ti flas, si më ha pranvera për së gjalli
e Unë pasthirrma shpirti, s'përkthej dot.

Ti them për njerëz, shurdhuar nga jehona
e mërisë të kthyer në stinë të pestë.
Ja, paturpësia, ëndërron të bëhet Cezar
e maskuar e veshur, si dashuria vetë.

Si ta përkthej gjuhën e këtij bari prilli,
në gjuhën e vesës që harabeli rrufit?
I them: "mos e vrit mendjen për ne njerëzit
bari s'mund të vishet si murg me mërzitë"!

I LUMTUR SE TË DOJA

Isha i lumtur se të doja më shumë se të gjithë ata që të donin.
Dashuria për ty- a thua pse- ishte e pamundur të mbahej e fshehur.
Në qytetin që e përpija me dhjetë hapa, më përpinte kjo dashuri, harku më sipër të gjitha dashurive tjera për ty-
Edhe fenomenet më sipër natyrës së verbër i kish nën vete.
Ishe mosëndërr, dashuria ime të bëri ëndërr, të bëri ëndërruese.
Ishe e paëndërrt, dashuria ime të bëri të ëndërrueshme.
Dashuria për ty ishte vesë, brymë - nuk njom, ishte shi - nuk lag, ishte borë - nuk zbardh, ishte breshër- nuk resh.
Isha i lumtur se të doja më shumë dhe më pafshehur se të gjithë ata që të donin.

IA SHOHIM ËNDRRËN

Ia shohim ëndrrën,
Ia shohim ëndrrat
Njëri-tjetrit.

Mezi presim të dalim saj
Dhe t'ia japim munxën:
Ta pashë ëndrrën!

Vdesim për t'ia parë ëndrrën,
Ëndrrat njëri tjetrit,
Njëri-tjetrës
Njëra- tjetrit.

Ta pafsha ëndrrën. Mos vdeksha
pa ta parë ëndrrën. Mos vdeksh
pa t'u parë ëndrra, pa ta parë
unë ëndrrën!

Ta pashë ëndrrën.
Nga do t'ia mbash
Tash
Pasi unë ta kam parë ëndrrën?

BUKURINË E SAJ

Një çast të vetëm
Nuk e përballoja dot bukurinë e saj.

Një çast të vetëm.

Pyesja veten
Si do ta përballoja
Gjithë jetën.

SYSHIU JE, SYBORA IME SYQIELL

Syshiu je, sybora ime syqiell.

Shterron një krua më në jug të jugut
Për të buruar më në veri të veriut.
Në gurgullimën e tij më veriore
Të vetmen e pashterrur,
Që s'ka shuar kurrë etje,
E kemi shtëpinë tonë.

Arkitekturë e kolme
Fantazie të pacensurueshme.

Të pavarur nga shkaqet jemi,
Të privuar nga pasojat.

Symepasymosmeupa je, syreja ime syremerbreshër e rrufé.

Është një femër bilbili që këndon për t'i rritur vezët
Në një cep të hapësirës.
Është një femër korbi që këndon për t'i rritur vezët
Në cepin tjetër të hapësirës.

Baraslarguar këngës së femrës së bilbilit dhe krrokut të femrës së korbit
E kemi shtëpinë tonë.
Dritare mbi dritare
Dritare krah dritaresh.

Parqe koralesh
Në rrjeta të ngatërruara rrymash të rrëmujshme.

Cezurë dhe cezurë dhe cezurë

Poeti i njohur Skënder Buçpapaj lindi 70 vjet më parë, më 22 maj 1953 në fshatin Tplâ të Tropojës.

POEZI NGA SKËNDER BUÇPAPAJ

Pas cezure, pas cezure, pas cezure.

Të panënshtrueshëm ndaj gravitacionit,
Të pabindur ndaj fushave magnetike jemi.

Sydoremifasolsido, symelodiozja ime je,
sydosilasolfamiredo.

Është një rreze agu të palindur dhe një rreze perëndimi të paperëndueshëm
Që diku priten mes tyre
Dhe krijojnë këndë të kundërta, të gjera, të ngushta.
Aty ku takohen mos me u nda këndgjerët dhe këndngushtët,
E kemi shtëpinë tonë
Me ngrohje mbiyjëse,
Me ftohje nënyjëse.

Dhe hiatuse dhe hiatuse dhe hiatuse
Pas hiatusesh, pas hiatusesh, pas hiatusesh.

Jemi të pankontrolluar nga revolucionet.
Jemi të pakontrollueshëm nga evolucionet.

Sythëna, sy pathëna ime, syçkamethënëçkamosmethënë çkamelënëpathënëçkamosmelënëpathënë.



TË NXORA NGA ËNDRRA

Të kisha në ëndërr,
E butë si në fshikëz mëndafshi ishe, e pëllumbtë si kullë fildishi.
Të nxora nga përjetësia e përkohshme të të sjell në përkohësinë e pavdekësisë.
Të nxora nga ëndrra ime, se të desha për vete,
E largët e lagët,
Larvë e zbehtë që zhbëheshe në pikëtakimin e parë me jetën.
Të kisha në ëndërr, të nxora nga ëndrra.
Le pas mbresë të mosqenies.
Le pas amë shkumësh shkimur muzgjesh.

Të kisha në ëndërr. Nuk më kishe në ëndërr.

ÇFARË NUK ËSHTË UNË, ËSHTË TI

Shikimi yt
I sapoçelur nga një vezë qyqeje
Të klloçitur në një fole pëllumbash.

Salamandër
E saposhkrepur fieraje,
Dalldisje e larave të verdha në të zezat,
E larave të zeza në të verdhat.
Hazdisje e arit të kulluar në qelibar të zi
E qlibarit të zi në ar të kulluar.
Fantazi muzikore
E shkruar palexueshëm,
E kënduar padëgjueshëm.

Çfarë nuk është ti, është unë.

Rreth i jashtësuar në katrorin tim - ti.
Katror i brendësuar në rrethin tënd - unë.

Kub i strehuar në sferën tënde - unë.
Sferë strehuese në kubin tim- ti.

Kryqi i Krishtit
A është nga i njëjti dru i Varkës së Noes.

Varka e Noes
A dha dru për kryqëzimin e Krishtit.

Je urë
Imagjinata e ujërave të rrëzon nën lum.
Jam lum
Imagjinata e ujërave më përmbys mbi urë.

Çfarë është ti, është unë.

Me seksin tim
Mat metër për metër
Planetet, largësitë e larmishme mes planeteve
Kurrë të matura.

Çfarë është unë, është ti.

TI DEL ME U PA

Ti del me u pa.
Kur ti del me u pa,
Të gjitha pasqyrat
Dalin me të pa.

Kur ti del me u pa,
Ti del me u pa.
Si të gjitha pasqyrat
Dal dhe unë me të pa.

Ti del me u pa
Ti mos dil me u pa.
Ndër të gjitha pasqyrat
Nuk po kam ku me t'pa.

JE E BUKUR SI SHUARJA E DRITËS

Je e bukur
Si shuarja e bukur
E dritës.

Si shuarja e bukur e dritës
Për të parë sa më thellë e më qartë
Gjithçka që nuk shihet pa terr.

Kur sipër teje janë gjinjtë e tu
E sipër tyre jam unë,
Gjinjë e tu bëjnë elektrifikimin përfundimtar të Gjithësisë,
Shlyejnë përjetësisht
Njollën e tillë të quajtur natë,
Njollat e tilla të quajtura netë.

Je e bukur
Je më e bukur
Se shuarja më e bukur
E dritës.

Se shuarja më e bukur e dritës
Që terri të mos lërë asgjë pa prekur
Në trupin tim dhe trupin tënd.

Kur poshtë teje janë gjinjtë e tu
Dhe unë jam i papushuar, i ritmuar sipër teje,
Gjinjtë e tu që përplasin njëri tjetrin,
Mbizanojnë të gjitha kambanoret dhe ezanet e të gjitha orëve,
I shpëtojnë nga binjakët, trinjakët, shumënjakët e ligj
Shpirtërat e njerëzimit.

Je e bukur,
Je më e bukur
Se shuarja më e bukur
E të gjitha shuarjeve më të bukura
Të dritës,

Kur terri
Është më i tejpashëm
Se çdo antonim i mundshëm i tij.

Sheshazi botës jemi
Brenda guaskës flori të territ
Dy perla që bëjnë dashuri.
Më lehtë e kemi t'i shkëmbejmë trupat tanë
Se frymët tona
Mes shuarjes së zezë
Të dritës së bardhë
Dhe shprepjes së bardhë
Të territ të zi.

Je e bukur e bukur,
Je më e bukur, më e bukur,
Je shumë, je shumë më e bukur
Se shuarja më e bukur
E dritës.

MANI I OBORRIT TIM

(Këngë me lahutë dhe orkestër)

1.
Mani i oborrit tim
Është bërë krrokamë
Në oborrin e huaj.

Krrokon
Mbi kulmin e huaj.

2.
Gjethet e tij
Shtegtues në prag dimrash,
Kthehen pas fund dimrash.

3.
Frutat e tij të bardhë
Në lejla.
Zogjtë që hanin frutat e tij
Cicëronin ëmbël në lejla.

Zog as njeri nuk kanë lënë
Pa ua njomur gojën

Frutat
Yjës.

4.
Zogjtë e tij
Nuk shtegtonin kurrë.

5.
Këmisha e shtatë e natës.
Nata e shtatë e javës.
Lëkura e shtatë e bollës.

6.
E shoh e jam në ëndërr.
S'e shoh e jam në zhgjëndërr.

7.
Unë nuk jam brenda trungut të manit
Të oborrit tim.
Janë brenda tij vitet e mia.
Kubaturat e mendjes. Qerthujt e shpirtit. Kacekët e frymës.
Tastat dhe tastaturat e shqisave.
Fyejt e skeletit. Enët e mëdha. Enët e vogla të gjakut.
Lëfytet e limfës.
Kordat e nervave.
Orkestra e qenies.
Motosharra, me zë të brendshëm rropullor,
Lexon solfezhin e rrënqethshëm të rënkimeve.

8.
Më sheh e s'është në jetë.
S'më sheh e s'është në vdekje.

9.
Trungjet nuk janë burra për t'u përleshur.
Degët nuk janë shqelma për të bërë gropa në gjokse.
Rrembat nuk janë duar për të kapur me thonj gryka fytnash.

Gjethet janë në mërgim.

Zogjtë
Përtej eterit.

Gjindja
Asgjallë.

10.
Hija e tij e hënadielltë
E diellahëntë.

Dielli e lëshonte mbi fushë të Tplanit,
Hëna e lëshonte mbi kullën time,
Harmoni kozmike.

11.
Vetëm kur e lënë ballin pa kokërdhokët e syve
Dhe vetëm pasi ia përcjellin barkut nga balli,
Ata mund të kthehen te oborri i tyre
Me manin tim
Të bërë krrokamë.

12.
Krrokamë e parreshtur
Në oborrin e huaj.
Kobon
Mbi kulmin e huaj.

Ninullon
Vaje.

13.
Çjerrjet e tyre të fytit,
Kërramzat e tyre të gjokseve,
Gurmazjet e tyre të angrrave
Ua mbyt
Krrokama e parreshtur.

14.
Etja e tyre është e untë,
Uria e tyre është e etshme.
Qorrverbtas
Hanë etjen e tyre.
Pijnë urinë e tyre.

15.
Zogjtë
Në kllapi të thellë.

Gjindja
Asvdekur.

Dielli nuk i lëshon më hijet e manit tim
Mbi fushën e Tplanit.
Hëna nuk i lëshon më hijet e manit tim
Mbi kullën time.

Ngërç kozmik.

16.
Pasynëballët
Përdorin hyrjedaljet e rrashtave të tyre
Për në oborr dhe kthim.

17.
Më prek e jam andej bote.
S'e prek e jam këndej bote.

18.
Krrokama e parreshtur
Nuk jep fruta të ngrënshëm.
Jep fruta ngrënës.

Ngrënës shqisash,
Ngrënës të brendshmesh
Pasynëballësh.

Frutat e krrokamës së parreshtur kanë shije të helmët
Në të zezë.

19.
E ndiej e jam në gjumë të përjetshëm.
S'e ndiej e jam në zgjim të përjetshëm.

20.
Vaj
Ninulle.

21.
Krrokama e parreshtur nuk lëshon dot hije
Mbi natën e pazbardhshme vorbëverbëse
Të pasynëballëve.

Intervistë me poetin shqiptar Rudolf Marku në shtypin grek, me rastin e botimit të përmbledhjes së tij më të fundit poetike "Rathët e Brendashkruar" në Greqi (përkthyer nga Petros Tserkezis, botim Bakhikon).

RUDOLF MARKU: FËMINIJA KA NJË NDIKIM TË MADH TE SHKRIMTARI I ARDHSHËM

Intervistë dhënë gazetares Angeliki Dimopoulou, Athinë

Rudolf Marku është poet, romancier, përkthyes dhe eseist shqiptar. Ka botuar njëmbëdhjetë libra me poezi dhe pesë romane. Ai ka përkthyer,krahas autorësh të tjerë,dhe Sappho, Catullus, Ovid, T.S. Eliot, Ezra Pound, Constantinos Cavafy, W.H. Auden, G. Ungaretti, Ch. Baudelaire dhe J.Laforgue, në gjuhën shqipe. Përmbledhja e tij ndër më të fundit me poezi, 'Rrathët e Brendashkruar', është njohur si një nga koleksionet më të rëndësishme të botuara ndonjëherë në gjuhën shqipe dhe tashmë është e disponueshme në gjuhën greke, përkthyer nga Petros Tserkezis, nga botimet Bakhikon. Rudolf Marku flet, në intervistën e mëposhtme, për Poezinë, vehten dhe gjithashtu për shpirtin e poezisë.



A.D: *Përmbledhja juaj poetike "Rrathë të brendashkruar" u botua së fundmi në greqisht nga botimet Bakchikon. Si ndiheni tani, që mundët t'ia komunikoni poezinë tuaj lexuesve grekë?*

R.M: Botimi në gjuhën greke është një ëndërr, që e presin të realizohet, të gjithë shkrimtarët e botës. Është si ëndrra e kthimit në shtëpinë e prindërve, pa marrë parasysh se në cilin cep të botës jeton, sepse të gjithë shkrimtarët e kësaj bote janë, në një mënyrë apo tjetër, fëmijë të Homerit, Eskilit, Sofokliut, fëmijë të miteve të Argonautëve dhe të Odiseut. Nuk është rastësi që një nga poetët më të njohur të Rilindjes Shqiptare, Naim Frasheri, i dha fund karrierës së tij poetike duke përkthyer Iliadën! Një shkrimtar romak si Ovidi, në fakt, është një rast tipik i një poeti me "origjinë" nga mitet greke, siç janë mijëra shkrimtarë të tjerë të kësaj bote. Prandaj e ndjej se është një privilegj i madh që një nga librat e mi me poezi u përkthye, u botua dhe u prit shumë mirë në Greqi.

A.D: *Ka gjithmonë ngjashmëri mes shkrimtarëve që nuk i kanë njohur kurrë veprat e njëri-tjetrit. Kësisoj, libri sjell në mendje një urë poetike të kohës që lidh "njerëzit" nga e kaluara e tyre më e lashtë me të ardhmen e tyre më të largët. Si krijues, çfarë po përpiqeshit t'u komunikonit lexuesve ndërkohë që po "ndërtonit" këtë koleksion?*

R.M: Çdo vepër letrare është kujtesa se të gjithë njerëzit e jetojnë jetën e tyre të udhëhequr nga *Spiritus Mundi.* Duke parë poezinë shqipe, vë re se si poeti i parë i gjuhës sonë, Pjeter Budi, ka, në një poezi të veten, ngjashmëri të papritura me poetin francez Francois Villon, pa i njohur ndonjëherë veprat e tij. Ka gjithmonë ngjashmëri mes shkrimtarëve që nuk i kanë njohur kurrë veprat e njëri-tjetrit. Një poet i madh dikur këmbënguli se ai ishte i ndikuar kryesisht nga librat ende të pashkruar të autorve të tjerë! Në letërsinë e të gjitha vendeve mund të gjesh ndikime të pavetëdijshme nga letërsia botërore që nuk i ke lexuar kurrë më parë. Në poezitë e tij të njohura, Pjetër Bogdani, shkrimtari i dytë më i vjetër në gjuhën shqipe, shkroi për Sibilat një shekull pas krijimit të afreskeve të Mikelanxhelos me Sibilat në Kapelën Sistine (Cappella Sistina, Vatican City) të Shën Pjetrit, Romë. Poezia mëson kujtesën: Homeri, Safoja, Katuli, Shekspiri dhe Servantesi janë bashkëkohësit tanë.

A.D: *Ky libër i veçantë është njohur si një nga përmbledhjet më të rëndësishme poetike të botuara në gjuhën shqipe. Si ndiheni kur e dëgjoni këtë?*

R.M: Letërsia shqipe ka një traditë të vjetër në poezi. Ashtu si letërsia greke. Kur dëgjoj njerëz që flasin për Greqinë, mendja më shkon menjëherë te Safoja, Teokriti, Kavafi, Seferis, Eliti, Ritsos,Palamas, Engonopoulos, Sikelianos... Përveç Ismail Kadaresë, një shkrimtar tashmë me staturë botërore, i nominuar prej shumë vitesh rradhazi për Çmimin Nobël, Poezia shqipe ka një numër jo fort të paktë poetësh, fatkeqësisht të panjohur në botë, poezia e të cilëve, po të njihesh, do ta nderonte kulturën dhe identitetin shpirtëror të vendit të tyre.

A.D: *Pjesën krijuese të jetës dhe punës tuaj ia keni kushtuar fjalëve. Dëshironi të ndani me ne se kur dhe si e gjetët rrugën tuaj në poezi dhe shkrim?*

R.M: Poezia vjen te krijuesi i saj në mënyra të ndryshme. Për mua kjo erdhi përmes leximit që nga fëmijëria ime e hershme dhe përmes historisë. Qyteti provincial ku kam lindur, Lezha, është një qytet shumë i vjetër, plot rrënoja të qytetërimeve të lashta, ilire, greke, romake. Me monedhat e Pirros së Epirit, unë dhe miqtë e mi blemë një herë akullore nga i vetmi shitës ambulant në qytet! Monedhat arkeologjike ishin ende të vlefshme si monedhë në fëmijërinë tonë! Varri i heroit tonë Kombëtar, Skënderbeu, ishte vetëm 300 metra larg shtëpisë së prindërve të mi. Kur ishim të vegjël luanim me shpata dhe perkrenare romake! E gjithë kjo krijonte një atmosferë surreale, magjike dhe tragjike, më afër poezisë dhe letërsisë së rëndësishme! Mendoj se fëmijëria ka një ndikim të madh te shkrimtarët e ardhshëm! Unë si shqiptar kam lindur nga malet dhe nga bregdeti, ndaj poezia ime thërret nymfat dhe ujqërit. Gjatë jetës sime jam përballur shumë herë me Scylla-n e cenzurës dhe Charybdis të banalitetit. Jo një përvojë e keqe për një njeri që ëndërron të bëhet poet!

A.D.: *Historia juaj personale sigurisht u ndikua nga historia e vendit tuaj teksa u shpalos krahas saj. Cilat ishin përvojat që formuan dhe ndikuan thellë në poezinë tuaj?*

R.M: Edhe pse borxhi i parë i poetit duhet të jetë ai i imagjinatës së tij, do të ishte çnjerëzore nëse poeti nuk do t'u përgjigjej ngjarjeve tragjike të kohës së vet, duke përdorur një zë dashamirës, por jo sentimental. Shqipëria është një vend ende në udhëkryq të historisë dhe mendoj se poezia e saj duhet të ketë qartësi dhe ndershmëri.

A.D: '*Rrathët e brendashkruar", dhe dymbëdhjetë përmbledhje me poezi, gjashtë romane, përkthimi i poetëve të mëdhenj të botës në një Antologji të poezisë botërore përkthyer dhe hartuar prej teje, një libër me ese... Çfarë ju mban në lëvizje krijuese?*

R.M: Është një pyetje shumë e vështirë. Gjatë jetës kam patur raste kur nuk mund të shkruaja asnjë varg. Kanë qenë ndoshta kohë dëshpëruese, të tilla ku vazhdimisht shkrimtari grumbullon kohë krijuese për të ardhmen. Më pëlqen të mendoj se asgjë nuk shkon kot. Asgjë nuk humbet, madje as në varr, siç thotë njëri ndër poetët më të mëdhenj të Amerikës së shekullit të XIX-të.

A.D: *Çfarë është poezia për ju personalisht?*

R.M: Nëse një poezi nuk ta ka gjakosur shpirtin gjatë leximit të saj, nuk e ke përjetuar poezinë, këmbëngulte Edgar Allan Poe.

A.D: *Si e shihni rolin e poezisë sot? Çfarë mendoni se mund të na ofrojë ajo?*

R.M: Mendoj se nuk kemi gabuar kurrë më shumë se tani, kur ne, teksa Hekubat moderne parashikojnë vdekjen e poezisë, për shkak të zhvillimit të teknologjisë, mediave sociale, Facebook-ut, Instagramit etj., u besojmë atyre. Unë ndoshta i përkas shkollës së vjetër kokëforte, që beson se, për sa kohë të jetë shpirti i njeriut, poezia do të vazhdojë të shkruhet dhe të lexohet. Në fund të fundit, nuk është djalli ai që e shpiku shpirtin!

Perktheu nga greqishtja: B. Xh.

PSE E SULMOJNË MONA LIZËN

Nga Salvador Dalí, Mars 1963

Ishte e pashmangshme që Salvador Dalí të zbulonte publikisht se pse *Mona Liza* — një "portret i thjeshtë" i pikturuar nga një prej artistëve më të ndërlikuar dhe më të dykuptimshëm — ka pasur një fuqi, unike në të gjithë historinë e artit, për të provokuar sulme nga më të dhunshmet dhe më të ndryshmet.

Mona Liza ka kaluar dy lloj sulmesh kryesore mbi praninë e saj arketipike.

1. Sulmi ultra-intelektual, i kryer nga lëvizja Dada. Marcel Duchamp, në 1919, vizaton mustaqe mbi një fotografi të *Mona Lizës*, dhe në fund shkruan inicialet e famshme "L.H.O.O.Q." (*Elle a chaud au cul.)*

2. Sulmi i llojit naiv apo primitiv, kryer nga bolivianë pakashumë anonim. Ai konsiston ose në hedhjen e një guraleci drejt pikturës ose në vjedhjen e saj të përkohshme.

I pari është një rast sulmi nga një artist kundër një kryevepre që mishëron maksimumin e idealizimit artistik. Shpjegohet nga një vështrim i Frojdit, përkufizimi sublim i të cilit për Heroin është: "Njeriu që revoltohet kundër autoritetit të babait dhe më në fund e tejkalon." Ky përcaktim është antiteza e Dada, e cila përfaqëson një kulminacion të anti-heroikes, një qasje anti-Niçe ndaj jetës. Dada kërkon zonën anale, erogjene të *Mona Lizës*, dhe ndërkohë që e pranon "agjitacionin termik" të Mamasë si Vepër-Arti, rebelohet kundër idealizimit të saj duke e maskulinizuar. Dada i pikturon mustaqet e babait mbi *Mona Lizën* për të kërkuar ndihmë në denigrimin e Artit. Me këtë gjest, aspektet anti-artistike, anti-heroike, anti-glorifikuese dhe anti-sublime të Dada, u mishëruan.

Për të shpjeguar "sulmet naive" kundrejt *Mona Lizës*, duke mbajtur në mend zbulimin e libidos së Leonardos nga Frojdi dhe fantazitë erotike të nënvetëdijshme për mamanë e tij, na duhet gjenia e Michelangelo Antonioni (unik në historinë e kinemasë) për të filmuar sekuencën në vijim: Një bir i thjeshtë naiv, në nënvetëdije i dashuruar me mamanë e tij, i tërbuar nga kompleksi i Edipit, viziton një muze. Për këtë bir naiv, pakashumë bolivian, muzetë barazohen me shtëpitë publike, dhomat publike — me fjalë të tjera, bordello, dhe ngjashmëria përforcohet nga moria e ekspozitave erotike që gjen aty: nudo, statuja të paturpshme, Rubensi. Në mes të gjithë kësaj shthurjeje trupore dhe libidinale, biri Edipian trulloset teksa gjen një portret të mamasë së tij, të shpërfytyruar nga idealizmi maksimal femëror. Mamaja e tij, aty! Dhe më e keqja, mamaja e tij i buzëqesh në mënyrë dykuptimshme, e cila, në rrethanat e tij, mund të duket vetëm e dyshimtë dhe skandaloze. Sulmi është përgjigjja e tij e vetme ndaj një buzëqeshjeje të tillë — ose mund ta vjedhë pikturën për ta fshehur me devotshmëri nga skandali dhe turpi i ekspozimit në një shtëpi publike.

Çdokush i cili mund të më japë shpjegime të tjera për sulmet që ka vuajtur *Mona Liza* duhet të më hedhë gurin e parë; do ta kap dhe do të vazhdoj me detyrën time të ndërtimit të së vërtetës.

Përktheu Enxhi Hudhri



The smile of the *Mona Lisa* (detail photograph from the Louvre Laboratory).

By Salvador Dali

Why they attack the Mona Lisa

The mysterious attraction of Leonardo's masterpiece for aggressions of all kinds is explained for the first time—with an assist from Sigmund Freud

L.H.O.O.Q.

Duchamp's *L.H.O.O.Q.*: the intellectual's attack on idealized femininity.

It was inevitable that Salvador Dali should reveal publicly why the *Mona Lisa*—a "simple portrait" painted by the most complicated and ambiguous of all artists—has had a power, unique in all art history, to provoke the most violent and different kinds of aggressions.

The *Mona Lisa* has undergone two main species of typical attacks upon her archetypal presence:

1. The ultra-intellectual aggression, perpetrated by the Dada movement. Marcel Duchamp, in 1919, draws a mustache and goatee on a photograph of the *Mona Lisa*, and at the bottom he letters the famous inscription "L.H.O.O.Q." *(Elle a chaud au cul).*

2. The primitive or naïve type of aggression, perpetrated by anonymous more-or-less Bolivians. It consists either of throwing a pebble at the picture or temporarily stealing it.

The first is a case of aggression by an artist against a masterpiece that embodies the maximum artistic idealization. It is explained by an insight of Freud whose sublime definition of the Hero is: "The man who revolts against the authority of the father and finally overcomes it." This definition is the antithesis of Dada which represented a culmination of the anti-heroic, anti-Nietzschean attitude to life. Dada seeks the anal, erogenous zone of the *Mona Lisa*, and while accepting the "thermic agitation" of the Mother as a Work-of-Art, rebels against its idealization by masculinizing it. Dada paints the mustaches of the father on the *Mona Lisa* to enlist his aid in the denigration of the Art. In this gesture, the anti-artistic, anti-heroic, anti-glorification [Continued on page 63]

36

FRANCESCO PETRARCA

Nga "Këngëtorja"

I përktheu nga origjinali: Klara Kodra

IA MERRTE FLLADI ...

Ia merrte flladi flokët si flori
Dhe ia mbështillte me të ëmbla nyje.
E hirshmja dritë në ata sy si yje
Shkëlqente; dritë që u zbeh tani.

Ngjyra e fytyrës shprehte dhëmshuri
A ish ashtu a më ngjante mua vallë? –
Po krimbi i dashurisë zemrën e gjallë
Ma breu e u ndeza flakë për çudi.

S'ish prej njeriu ecja e saj e rrallë,
Po prej engjëlli; e fjalët plot ëmbëlsi
Kumbonin sikur s'ishin zë njerëzor.

Frymë qiellore qe ajo; diell i gjallë
Kur e pashë dikur; në s'është tani,
Ndonëse i zbutur, prapë shpon harku mizor.

MË VJEN NDËRMEND

Më vjen ndërmend, madje kurrë s'është larguar
Ajo që as Leteja[1] zemrës s'ma ka ndarë,
Si e pashë në vrullin e rinisë së parë,
Kur zemra e saj me zjarr pat flakëruar.

E shoh përballë, të përvujtë e të menduar,
Fisnike e me një bukuri të rrallë
Aq sa thërras: "Ajo është! Është gjallë!"
Dhe të ëmblën fjalë ia lyp për të dëgjuar.

Herë përgjigjet, herë nuk bën zë.
Si njeri që gabon dhe e kap të vërtetën,
I them vetes sime: "E ke gabim.

Më njëmijë e treqind e dyzetetetë
Më gjashtë të prillit, natën, n'orën një,
Ai shpirt i lumtur iku fluturim".

[1] Lumi i harresës në mitologjinë greke.

Salla Albania në Panairin e Librit në Torino,
i cili hapi dyert për lexuesit më 18.05.2023.